



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 606 Akti

Nr. 773 Vendimi
Tiranë, më 7.6.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 5.6.2024, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Juljan Haxhiu**, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.12.2020, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Xhensila Pine dhe Alma Faskaj. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 22.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese znj. Alma Faskaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu.

5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 dhe në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK; Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

11. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin² e mbajtur për subjektin e rivlerësimit në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, me konstatimin për përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 15.5.2024 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kritere për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 15.5.2024 mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 17.5.2024, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve në datën 30.5.2024, dorëzuar në protokollin e Komisionit, si dhe në rrugë elektronike, me *email*.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve të vëna në dispozicion, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me *email*, në datën 31.5.2024.

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë nr. *** prot., datë 18.10.2018.

² Raporti mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017.

³ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.9.2022.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 5.6.2024, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

17.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, mori gjithë kohën e kërkuar për të shprehur e parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

18. Z. Juljan Haxhiu ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

18.1 Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

19. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19.1 Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

19.2 Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

19.3 Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

19.4 Ndërsa në kreun VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

19.5 Por, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017⁴ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces

⁴“41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i

të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuara në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

21.1 Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni nisi shqyrtimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion, që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu.

21.2 Në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* (shtojca ***), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

22. Pasuria e llojit apartament banimi, me sipërfaqe 89.82 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, blerë në vitin 2013, me vlerë 6,200,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar: (i) shumën prej 1,312,000 lekësh nga kursimet personale; (ii) shumën prej 4,888,000 lekësh të përfituar nga kredia e marrë në BKT.

Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

22.1 Pasuria e llojit garazh, me sipërfaqe 18,77 m², blerë në vitin 2013, me vlerë 500,000 lekë. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar kursimet personale.

23. Deklarimi i këtyre pasurive në vite

Komisioni konstaton se: (i) Në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë (në vijim DIPP) të vitit 2006, në seksionin e deklaratimit të interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme (në dukje deklarim shtesë i bërë në datën 15.6.2007), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 96 m², ndodhur në lagjen “***”, Tiranë, me vlerë 45,000 euro, në proces ndërtimi, porositur nga babai, G.H. Për këtë pasuri gjithashtu deklaroi se zotëron 1,900,000 lekë, marrë me kredi tek Alpha Bank; (ii) Në DIPP 2013, subjekti ka deklaruar pasuritë objekt vlerësimi me të njëjtat të dhëna dhe burime të krijimit, sikurse i ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*.

24. Konstatimet e ILDKPKI-së lidhur me këto pasuri: Konfirmohet deklarimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, me përgjigjet e ardhura nga ZVRPP, DPPP dhe BKT.

25. Hetimi i kryer/verifikimet e bëra nga Komisioni lidhur me këto pasuri: Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje për mënyrën e fitimit të këtyre pasurive dhe mbi pagesat e kryera në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes së tyre⁵, Komisioni konstaton se:

26. Në datën 30.7.2004, babai i subjektit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes⁶ me shoqërinë “S” sh.p.k., nëpërmjet së cilës ka porositur një apartament banimi me sipërfaqe 90 m² në objektin që do ndërtonte kjo shoqëri, ndërtesën 7-8 kate me dy kate parkim nën tokë, pranë shkollës “***”, Tiranë, për çmimin 45,000 euro. Në këtë kontratë, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) pjesa e parë 26,500 euro është likuiduar para lidhjes së kontratës; (ii) pjesa tjetër 18,500 euro do të likuidohet me mbarimin e pallatit.

26.1 Gjatë hetimit administrativ⁷, subjekti ka shpjeguar se nga tërësia e kësaj kontrate është e qartë se ajo është një kontratë paraprake, pa objekt të përcaktuar qartë, pasi shoqëria ndërtuese në momentin e nënshkrimit të kontratës ka qenë ende në procesin e aplikimit për leje ndërtimi⁸, prandaj si ndërtesa, ashtu edhe vetë apartamenti konkret nuk janë identifikuar në mënyrë të qartë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se origjina e shkakut ligjor të kësaj kontrate ka qenë nevoja e shoqërisë “S” sh.p.k. për likuiditet dhe se, për shkak të

⁵ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI; (ii) dokumentacioni, pjesë e hetimit të dosjes së ILDKPKI-së; (iii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti me sqarimet e dhëna prej tij drejtuar ILDKPKI-së, datë 21.1.2015, përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 25.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.10.2023); (iv) shkresa e ASHK – Drejtoria Vendore Tirana Veri nr. *** prot., datë 16.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.11.2023); (v) shkresa e OTP Bank sh.a. (shoqëria përthithëse e Alpha Bank) nr. *** prot., datë 31.1.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 31.1.2024); (vi) dokumentacioni i dërguar me shkresën “Kthim përgjigje” nga noteri publik, znj. E.K, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.3.2024; (vii) dokumentacioni i dërguar me shkresën “Kthim përgjigje” nga noteri publik, znj. E.K, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 27.3.2024; (viii) dokumentacioni i depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

⁶ Kontratë sipërmarrjeje për ndërtim apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.7.2004, redaktuar nga noteri publik, z. R.K.

⁷ Në përgjigjet e pyetësorit nr. *** dhe nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

⁸ Ka referuar se leja e sheshit të ndërtimit është marrë nga shoqëria “S” sh.p.k. me vendimin nr. *** të KRRT-së, datë 26.10.2004 “Për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij”.

marrëdhënies së ngushtë personale e profesionale mes babait të tij G.H dhe A.S, ortakut të vetëm të shoqërisë “S” sh.p.k., ky i fundit i propozoi lidhjen e kësaj marrëveshjeje, pasi ishte në nevojë të ngutshme për likuiditet.

26.2 Në lidhje me likuidimin e çmimit të përcaktuar në këtë kontratë porosie, subjekti ka deklaruar se shuma 26,500 euro është paguar me para në dorë në kohën e lidhjes së kontratës (në vitin 2004, data e panjohur), me burim të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të familjes në Krujë në shumën prej 1,500,000 lekë dhe kursimet e tjera familjare (përfshirë edhe të ardhurat nga puna e tij) të mbajtura si para në dorë ose në llogari bankare, në shumën prej 1,900,000 lekësh.

26.3 Pra, referuar këtij deklarami, duket se pagesa e këstit të parë për porositjen e apartamentit prej babait të tij te shoqëria “S” sh.p.k. ka pasur si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Krujë, si dhe kursimet e familjes së subjektit (ku përfshihen edhe kursimet nga paga e tij të administruara nga prindërit).

27. Bazuar në deklaramet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së kursimit të familjes Haxhiu deri në datën 31.12.2003, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 1

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1994 - 2003	Vlerat në Lek
A) Pasuri	2 700 292
Autoveturë *** (targa ***), blerë nga subjekti datë 29.11.2003	250 000
Gjendje në llogari bankare të familjarëve Haxhiu (rrjedhëse dhe/apo depozita)	2 450 292
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	2 700 292
D) Të ardhura	6 462 327
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit	1 034 402
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit Shkolla e Magjistraturës	600 890
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Universitetin L	156 000
Të ardhurat nga interesat e depozitës në Alpha Bank në emër të subjektit	48 117
Të ardhurat nga shitja e apartamentit në Krujë, shitur në datën 18.6.2001 ⁹	1 500 000
Të ardhurat nga paga e babait G.H	1 465 119
Të ardhurat nga paga/vendimi gjyqësor, nëna M.H	1 589 399
Të ardhurat nga interesat e depozitës ProCredit Bank në emër të G.H	68 400
E) Shpenzime	2 449 021
Shpenzime jetike	2 449 021
Balanca e fondeve (D-C-E)	1 313 014

28. Bazuar në analizën e mësipërme, deklaramet e bëra nga subjekti dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes Haxhiu për kryerjen në datën 30.7.2004 të pagesës së këstit të parë shoqërisë “S” sh.p.k. për porositjen e pasurisë së llojit apartament banimi, të pasqyruar në tabelën si vijon:

⁹ Kontratë shitblerjeje apartamenti banimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.6.2001, redaktuar nga noteri publik, z. P.H.

Tabela nr. 2

Analiza financiare për periudhën nga data 1.1.2004 deri në datën 30.7.2004	Vlerat në Lek
A) Pasuri	1 458 880
Apartament me sip. 89,82 m ² (96 m ²), ndodhur në lagjen “****”, Tiranë ¹⁰	3 358 610
Ndryshim likuiditeti	-1 899 730
B) Detyrime	0
C) Pasuri neto (A-B)	1 458 880
D) Të ardhura	2 347 203
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit	495 016
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Universitetin L	89 250
Të ardhurat nga interesat e depozitës në Alpha Bank në emër të subjektit	6 445
Të ardhurat nga paga e babait, G.H	203 450
Të ardhurat nga paga/vendimi gjyqësor, M.H	166 360
Të ardhurat nga interesat e depozitës ProCredit Bank në emër të G.H	73 668
Të ardhurat nga mundësia e kursimit të familjes së subjektit deri në datën 31.12.2003	1 313 014
E) Shpenzime	298 862
Shpenzime jetike	219 016
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	79 846
Balanca e fondeve (D-C-E)	589 460

29. Sa më sipër, Komisioni konstaton se familja Haxhiu ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 30.7.2004 për shlyerjen e këstit të parë për porositjen e apartamentit tek shoqëria “S” sh.p.k.

30. Në vijim, subjekti ka deklaruar se me marrjen e lejes së ndërtimit dhe pas miratimit të planimetrisë së ndërtesës dhe apartamenteve, babai i tij G.H dhe shoqëria “S” sh.p.k. në datën 3.2.200 kanë lidhur një kontratë porosie, në të cilën identifikohet sendi i cili do ndërtohej për porositësin.

31. Rezulton se në datën 3.2.2005 babai i subjektit ka nënshkruar kontratën e porosisë¹¹ me shoqërinë “S” sh.p.k., nëpërmjet së cilës ka porositur: (1) pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 96.5 m²; (2) një garazh për parkim makinash, me çmimin total 58,250 euro.

31.1 Në këtë kontratë, plani/mënyra i/e pagesave është përcaktuar si vijon: (i) kësti i parë 26,500 euro është likuiduar para lidhjes së kësaj kontrate; (ii) kësti i dytë 20,000 euro do të paguhet me mbarimin e karabinasë; (iii) kësti i tretë 11,750 euro do të likuidohet me lidhjen e kontratës së shitjes së apartamentit dhe dorëzimit të çelësave në dorë.

31.2 Në deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ¹², subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo kontratë përfaqëson një plotësim shtesë ndaj kontratës së vitit 2004, pra se ajo nuk është një kontratë e re për një apartament të ri, duke referuar se në këtë dokument saktësohet se apartamenti objekt kontrate ndodhet në katin e dytë teknik të një objekti që po ndërtohet pranë shkollës “****”, nr. rendor *** dhe ka një sipërfaqe prej 96.5 m². Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në porosi është shtuar edhe një garazh për parkim makinash. Për shkak të shtesave, vlera e kontratës është caktuar 58,250 euro.

31.3 Në lidhje me pagesat e kryera në funksion të kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar se shuma 26,500 euro është paguar para lidhjes së saj, duke referuar pagesën e

¹⁰ Pasqyruar vlera ekuivalente e shumës 26,500 euro, konvertuar me kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë të datës 30.7.2004.

¹¹ Kontratë porosie, konfirmuar me vërtetimin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.2.2005, redaktuar nga noteri publik, z. R.K.

¹² Në përgjigjet e pyetësorit nr. *** dhe nr. ***, të dërguar nga Komisioni.

kryer sipas kontratës/marrëveshjes paraprake të vitit 2004, të nënshkruar mes babait të tij dhe shoqërisë “S” sh.p.k., evidentuar si më sipër.

31.4 Subjekti ka deklaruar se në vitin 2006, me afrimin e përfundimit të karabinasë dhe, për rrjedhojë, afatit të pagesës së kështit të dytë, së bashku me familjen vendosi të marrë një kredi për pagesën e kështit të dytë. Ka parashtruar se kontrata e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., është lidhur në datën 19.6.2006, me limit kredie 1,900,000 lekë, me afat 7 vjet, me qëllim blerje apartamenti banimi, me kredimarrës subjektin Juljan Haxhiu, dorëzanës z. G.H dhe znj. M.H dhe se kolateral për këtë kredi është vendosur apartamenti pronë e prindërve, ndodhur në bulevardin “****”, me sipërfaqe 133 m², pronësia mbi të cilin ishte fituar në vitin 2000 nga babai i tij.

31.4.1. Pas verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit, Komisioni konstaton se apartamenti në pronësi të prindërve i vendosur si kolateral për marrjen e kredisë rezulton t’i jetë kaluar në pronësi pa kundërshtëpërblim nga shoqëria “S” sh.p.k. në muajin nëntor të vitit 2000¹³, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit sapo kishte nisur studimet në Shkollën e Magjistraturës.

31.5 Në vijim, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se me disbursimin e kredisë në datën 20.7.2006 është kaluar në favor të shoqërisë “S” shuma 1,900,000 lekë si ekuivalente e vlerës 15,535 euro, ndërsa pjesa e mbetur e kështit të dytë është derdhur në një datë të mëvonshme të panjohur (gjatë vitit 2006) në vlerën prej 4,465 euro ose 546,069 lekë, të cilat e kanë pasur burimin nga kursimet familjare. Referon se për këtë pagesë nuk disponon faturë, mandat apo ndonjë dokument tjetër ligjor, porse pagesa e saj me para në dorë është pranuar nga pala tjetër kontraktore dhe nuk ka kontestime prej saj. Ka parashtruar se, për shkak të arsyeve të panjohura për ta, apartamenti i sipërpërmendur nuk është regjistruar në regjistrat kadastralë deri në fund të vitit 2012 dhe se, për këtë arsye, kontrata e shitjes nuk është lidhur dhe pagesa e kështit të fundit nuk është kryer.

31.6 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti është bërë i banueshëm në vitin 2007, vit në të cilin ka filluar bashkëjetesën me bashkëshorten B.H, duke konfirmuar se është marrë në dorëzim në gjendjen e mbaruar nga shoqëria e ndërtimit dhe në të nuk janë bërë punime shtesë.

31.7 Gjithashtu, ka sqaruar se me marrjen e kredisë bankare në vitin 2006, për të paguar kështin e dytë, ai si subjekt i deklarimit të pasurisë kishte marrë rol në vënien e kësaj pasurie, për rrjedhojë e ka deklaruar atë në deklarimin vjetor të vitit 2006, me këtë shënim “*apartament banimi, sip. 96 m², lagjja “****”, Tiranë, 45,000 euro, në proces ndërtimi, porositur nga babai G.H, dhe se zotëron 1,900,000 lekë marrë kredi në Alpha Bank*”. Referon se ky deklarim ka lidhje si me kontratën e vitit 2004, ashtu dhe me atë të vitit 2005, duke qenë se ato kanë të bëjnë me të njëjtin objekt, por deklarimi është drejtpërdrejt e specifikisht i lidhur me kontratën e vitit 2005, në bazë të së cilës është marrë kredia bankare.

31.8 Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit në OTP Bank (banka që ka përthithur/blerë Alpha Bank)¹⁴, konfirmohet se në datën 20.7.2006 disbursohet kredia në shumën prej 1,900,000 lekësh¹⁵ dhe se po në të njëjtën datë këto fonde transferohen me

¹³ Referuar dokumentit akt noterial për heqje dorë nga apartament banimi/kontratë për kalim pronësie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. V.S.

¹⁴ Shkresa e OTP Bank sh.a., nr. *** prot., datë 31.1.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 31.1.2024); (vi) dokumentacioni i dërguar me shkresën “Kthim përgjigje” nga noteri publik, znj. E.K, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.3.2024;

¹⁵ Kontratë kredie bankare me Alpha Bank, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.6.2006, redaktuar nga noteri publik, znj. A.M.

përshkrimin “Kalim nga Juljan Haxhiu dhe G.H. Pagese e këstit të fundit për blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë (ekuivalenti 15,535 Eur)”.

31.9 Po ashtu, Komisioni konstaton se sipas dokumentit “Urdhër Kalim” të Alpha Bank të datës 20.7.2006, subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kalimin e shumës prej 1,900,000 lekë (ekuivalenti i shumës prej 15,535 euro) në favor të shoqërisë “S” sh.p.k., me përshkrimin “Kalim nga Juljan Haxhiu dhe G.H. Pagesë e këstit të fundit për blerje apartamenti sipas kontratës së porosisë (ekuivalenti 15,535 Eur).”

31.10 Komisioni vëren se dokumenti “Urdhër Kalim” i datës 20.7.2006 dhe përshkrimi i bërë më lëvizjen e llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank (sot OTP) referojnë kalimin e shumës prej 1,900,000 lekësh në favor të shoqërisë “S” sh.p.k. si pagesë të këstit të fundit për blerjen e apartamentit sipas kontratës së porosisë, porse nuk referohet pagesë përfundimtare edhe për blerjen e garazhit.

31.11 Në këto rrethana, si dhe nisur nga shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në përfundimin se përgjatë vitit 2006 është kryer në total pagesa prej 20,000 euro në favor të shoqërisë “S” sh.p.k. për porositjen e apartamentit dhe garazhit me burim: (i) të ardhurat e përfituara nga kredia bankare e marrë prej vetë subjektit në Alpha Bank; (ii) kursimet familjare.

32. Bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet e dhëna prej tij gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumentacioni i administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes Haxhiu për kryerjen deri në datën 31.12.2006 të pagesës së këstit të dytë në favor të shoqërisë “S” sh.p.k. për porositjen e dy pasurive të paluajtshme të llojit apartament banimi dhe garazh, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 3

Analiza e treguesve financiarë për vitin 2006	Vlerat në Lek
A) Pasuri	2 342 831
Apartament me sip. 89,82 m ² (96 m ²), ndodhur në lagjen “***”, Tiranë”, paguar 20,000 euro	2 474 060
Ndryshim likuiditeti	-131 229
B) Detyrime	1 900 000
Kredia e disbursuar në datën 20.7.2006 Alpha Bank (1,900,000 lekë)	1 900 000
C) Pasuri neto (A-B)	442 831
D) Të ardhura	1 658 454
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit si gjyqtar	859 087
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Universitetin L	159 840
Të ardhurat nga interesat e depozitës Alpha Bank, në emër të Juljan Haxhiu	5 081
Të ardhurat nga paga e babait, G.H	258 638
Të ardhurat nga paga nëna e subjektit, M.H	365 229
Të ardhurat nga interesat e depozitës ProCredit Bank, në emër të G.H	10 579
E) Shpenzime	727 933
Shpenzime jetike	438 228
Shpenzime për pagesën e kredisë në Alpha Bank (1,900,000 lekë)	107 367
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë ProCredit Bank	26 472
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	155 866
Balanca e fondeve (D-C-E)	487 689

33. Sa më sipër, Komisioni konstaton se familja Haxhiu ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e bërë përgjatë vitit 2006 për shlyerjen e këstit të dytë për porositjen e apartamentit dhe garazhit tek shoqëria “S” sh.p.k.

34. Në datën 30.1.2013, babai i subjektit G.H dhe shoqëria “S” sh.p.k. zgjidhin kontratën e datës 3.2.2005 për porositjen e apartamentit me sipërfaqe 96.5 m² dhe postit të parkimit, ku babai i subjektit shfaqej si palë porositëse dhe shoqëria “S” sh.p.k. si palë ndërtuese – sipërmarrëse, pa pasur asnjë pretendim ndaj njëra-tjetrës¹⁶. Referuar këtij dokumenti, me zgjidhjen e kontratës, sipërmarrësi i ka kthyer palës porositëse vlerën e paguar dhe pala e dytë i ka dorëzuar në gjendje të lirë dy ambientet e përshkruara më lart.

34.1 Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mbas zgjidhjes së kësaj kontrate, babait të tij nuk i është kthyer shuma e plotë e paguar në funksion të kontratës së porosisë së vitit 2005, por vetëm shuma prej 5,200,000 lekë. Pra, ka pretenduar se shoqëria “S” sh.p.k., i ka ngelur si detyrim babait të tij shumën prej rreth 640,000 lekë, e cila përfaqëson diferencën mes vlerës së paguar më parë në total prej 46,500 euro (paguar në vitet 2004 dhe 2006, konvertuar në vlerën prej 5,840,000 lekë) me shumën e referuar si të kthyer në momentin e zgjidhjes së kontratës, prej 5,200,000 lekë.

35. Në datën 31.1.2013, subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e palës blerëse) dhe shoqëria “S” sh.p.k. (në cilësinë e palës shitëse) kanë nënshkruar kontratën e shitblerjes me rezervë (pasuri e paluajtshme)¹⁷, me objekt pasuritë e paluajtshme të llojit: (1) “apartament” me sipërfaqe 89.92 m², të ndodhur në katin e dytë teknik të një godine banimi 7 kate mbi tokë dhe 2 kate nën tokë¹⁸, nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, adresa e pasurisë: rruga “****”, Tiranë; (2) “garazh” me sipërfaqe 18.77 m², nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, adresa e pasurisë: rruga “****”, Tiranë, për çmimin total prej 6,000,000 lekësh.

35.1 Në nenin 4 të kësaj kontrate me titull “Mënyra e pagesës dhe rezerva” përcaktohet se blerësi ka paguar jashtë zyrës noteriale shumën prej 1,000,000 lekësh, ndërsa pjesën tjetër prej 5,000,000 lekësh do ta paguajë pas lëvrimit të kontratës së kredisë me Bankën Kombëtare Tregtare – *Të dyja palët janë dakord që të plotësojnë kushtin (rezervën në bazë të nenit 746 e vijues të Kodit Civil) e kësaj kontrate, që titulli i pronësisë të kalojë nga shitësi tek blerësi, pasi ky i fundit të likuidojë shumën e mbetur nga çmimi total.* Gjithashtu, palët kanë deklaruar se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me çmimin dhe mënyrën e pagesës.

35.2 Në vijim, nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar ndër vite në ILDKPKI, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) deri në vitin 2012 nuk kanë deklaruar shtesa dhe/apo gjendje likuiditetesh *cash*. Po ashtu, për periudhën nga data 1.1.2013 – 31.1.2013 nuk rezultojnë pakësime të llogarive bankare sipas gjendjeve të tyre të evidentuara në datën 31.12.2012.

35.3 Ndërsa pas verifikimit të të ardhurave të përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij për muajin janar të vitit 2013 konstatohet se ato nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e kryera për këtë muaj dhe pagesën e kështit të parë për blerjen e pasurive objekt vlerësimi, në shumën 1,000,000 lekë.

36. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në datën 31.1.2013 për likuidimin e kështit të parë të blerjes së dy pasurive objekt vlerësimi.

¹⁶ Dokumenti noterial “Zgjidhje kontrate” nr.*** rep., nr. *** kol., datë 30.1.2013, redaktuar nga noteri publik, z. R.K.

¹⁷ Kontratë shitblerjeje me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

¹⁸ Godina 7 kate mbi dhe 2 kate nën tokë, e cila ndodhet përballë shkollës “****”, e ndërtuar nga shoqëria “S” sh.p.k. sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 26.10.2004, të KRRT-së Bashkia Tiranë.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

37. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në janar të vitit 2013, kur është lidhur kontrata për blerjen e apartamentit, ata (subjekti dhe personi i lidhur) nuk e kishin gjendjen prej 1,000,000 lekësh për pagesën e këstit të parë. Porse, për ta bërë këtë pagesë, kanë marrë shumën e nevojshme nga familjarët e tyre të afërt dhe ua kanë kthyer atyre përgjatë muajve në vijim, brenda vitit 2013.

37.1 Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar: (i) deklaratën noteriale të nënës së bashkëshortes, datë 28.5.2024¹⁹; (ii) deklaratën noteriale të vëllait të bashkëshortes, datë 29.5.2024²⁰; (iii) deklaratën noteriale të motrës së tij, datë 28.5.2024²¹ – nga të cilët referon se ka marrë hua vetëm sa për të bërë pagesën e këstit të parë, e përkatësisht shumat 300,000 lekë, 270,000 lekë dhe 250,000 lekë. Për pjesën tjetër të shumës deklaron se është plotësuar me vlerat monetare, të cilat ata i dispononin për kryerjen e shpenzimeve të nevojshme familjare.

37.2 Në vijim, subjekti parashtron se në kushtet kur këto para janë marrë nga njerëzit e afërt asnjëra nga palët nuk e ka konsideruar këtë marrëdhënie si një kontratë klasike huaje, duke mos u kërkuar dhe parë e nevojshme që të kryhen formalitete shkresore, aq më tepër që vlerat monetare kanë qenë relativisht të vogla dhe se ata specifikisht i kanë kërkuar t'i ndihmojnë me çfarë kishin të disponueshme në mënyrë të menjëhershme, por pa prekur kursimet, nëse kishin të tilla. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se të gjithë personat e afërm, të cilëve u kanë marrë hua, kanë pasur të ardhura të ligjshme që u krijonin mundësinë për të disponuar në gjendje *cash* vlera në nivele të tilla, duke evidentuar se prindërit e bashkëshortes së tij kanë qenë në marrëdhënie punësimi në institucione shtetërore²², vëllai i bashkëshortes së tij ushtron aktivitet biznesi që nga viti 2009²³ dhe se motra e tij ka qenë e punësuar që nga viti 2006²⁴.

37.3 Subjekti ka argumentuar se, duke qenë se këto hua të vogla janë marrë e shlyer brenda të njëjtit vit kalendarik, nuk kanë qenë të formalizuara në formë shkresore, bazoheshin në marrëdhënie të ngushta familjare, ka vlerësuar se nuk ka pasur detyrimin për t'i deklaruar në deklaratën periodike vjetore të pasurisë dhe interesave private. Referon se, bazuar në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve vendorë dhe të disa nëpunësve publikë”, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës “...*detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose valutë të huaj*”.

37.4 Për rrjedhojë, subjekti pretendon se ka pasur detyrim për deklarim vetëm nëse detyrimi financiar ekziston në datën 31, të vitit përkatës, duke parashtruar se në kushtet kur i kanë kthyer këto shuma brenda vitit dhe detyrimet nuk kanë ekzistuar në datën 31.12.2013, nuk ka ekzistuar as detyrimi për t'i deklaruar. Nga ana tjetër, për sa kohë kjo

¹⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. O.D.

²⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.5.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. M.SH.

²¹ Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. O.D.

²² Sikurse rezulton në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit.

²³ Sikurse pasqyrohet nga ekstrakti historik i regjistrimit tregtar të QKB-së, depozituar si provë nga subjekti.

²⁴ Sikurse pasqyrohet në vërtetimet e ISSH-së, depozituar nga subjekti pas rezultateve të hetimit administrativ.

vlerë është shlyer gjatë vitit me të ardhura nga pagat (në formën e kursimeve personale nga pagat e marra), deklarimi i këtyre të fundit si burim i pagimit të kësaj shume nuk është i pasaktë.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

38. Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoji atë në seancë dëgjimore, Komisioni konstaton se, vetëm gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se si burim për kryerjen e pagesës prej 1,000,000 lekë në datën 31.1.2013, për blerjen e apartamentit nga shoqëria “S” sh.p.k., kanë shërbyer edhe tre hua të marra nga nëna e bashkëshortes, vëllai i bashkëshortes dhe motra e tij, për të cilat referon se i ka shlyer brenda vitit.

38.1 Komisioni vlerëson se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, e cila është një deklaratë specifike e plotësuar kryesisht bazuar dhe në përputhje me parashikimet e bëra në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor që krahas deklaratimit të pasurisë (në këtë rast të apartamentit në Tiranë) të deklaronte dhe të provonte me dokumentacion justifikues ligjor edhe burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për likuidimin e kësteve për shlyerjen e çmimit të blerjes së saj. Bazuar në pikën 7 të udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së nr. 4095, datë 10.10.2016 “Për mënyrën e deklaratimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrim që për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., të deklaronte burimin në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacion ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të secilës pasuri në momentin e krijimit të tyre.

38.2 Gjithashtu, trupi gjykues, në vijim të arsyetimit të tij çmon se, megjithëse subjekti pretendon se këto hua janë shlyer brenda vitit dhe për këtë shkak nuk ka pasur detyrimin t’i deklaronte, ai gjithsesi në rubrikën e deklaratimit të pasurive të DIPP 2013 ka pasur detyrimin t’i deklaronte si burim për pagesën e kryer në datën 31.1.2013 në favor të shoqërisë “S” sh.p.k., pra të referonte burimin konkret të kryerjes së kësaj pagese. Për më tepër, vlerësohet se edhe këto marrëdhënie huaje, pavarësisht se pretendohen si të mbyllura brenda vitit, do duhej të deklaroheshin/raportoheshin nga subjekti i rivlerësimit, kjo edhe në kuptim të verifikimeve që mund të bëheshin nga ILDKPKI-ja, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

39. Komisioni çmon se bazuar në përfundimin e arritur më sipër, se subjekti kishte pasur detyrimin për t’i deklaruar huat e sipërcituara në DIPP 2013, kjo rrethanë duhet të vlerësohet në tërësinë e veprimeve dhe deklarimeve të subjektit dhe nuk qëndron si një shkak i vetëm e autonom për penalizimin e tij. Së pari, huat janë në shuma relativisht modeste e të deklaruara si të marra nga persona të afërm të familjes së tij dhe të bashkëshortes, një nga të cilët (nëna e bashkëshortes) është deklaruar në vazhdimësi si person i lidhur në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të depozituara ndër vite në ILDKPKI. Së dyti, marrëdhëniet familjare mes subjektit e huadhënësve në këtë moment, bazuar edhe në prezantimin e tyre në vazhdimësi gjatë hetimit administrativ, janë të tilla që nuk i krijojnë Komisionit dyshime për fakte apo rrethana të tjera, të ndryshme nga ato të deklaruara. Së treti, vlera e huave të deklaruara, mënyra e marrjes dhe koha e shlyerjes së tyre do të ishin faktorë me rëndësi në vlerësimin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave të huadhënësve të pretenduar, të cilët e kanë konfirmuar këtë marrëdhënie, në rast se

Komisioni do të kishte vlerësuar ta bënte këtë analizë, bazuar edhe në standardin e vendosur nga Kolegji, sipas të cilit analiza dhe vlerësimi i pasurive të personave që kanë dhënë hua duhet të bëhet në kufijtë e pasurisë së dhuruar apo dhënë hua dhe sipas një vlerësimi logjik e të arsyeshëm²⁵. Së katërti, interpretimi i bërë nga subjekti në lidhje me mungesën e detyrimit për të deklaruar huat bazohet në një analizë ligjore të bërë prej tij, nuk është haptazi abuziv dhe, për më tepër, ka gjetur përkrahje edhe në jurisprudencën e institucioneve të rivlerësimit në raste analoge²⁶.

39.1 Pavarësisht se Komisioni në këtë rast arrin në një përfundim të ndryshëm nga ai i subjektit të rivlerësimit në lidhje me detyrimin për deklarimin e huave, trupi gjykues vlerëson se kjo rrethanë në vetvete nuk është e mjaftueshme për penalizimin e subjektit. Megjithatë, në analizën financiare këto vlera nuk do të reflektohen si të ardhura/burim për kryerjen e pagesës nga subjekti në datën 31.1.2013 për likuidimin e çmimit të apartamentit në Tiranë.

40. Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit, dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë për kryerjen e pagesës në datën 31.1.2013, në shumën prej 1,000,000 lekësh, për likuidimin e kështit të parë për blerjen e apartamentit në Tiranë, të pasqyruar si më poshtë:

Tabela nr. 4

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2013 – 31.1.2013	Vlerat në Lek
A) Pasuri	1 278 576
Apartament me sip. 89,82 m ² (neto), ndodhur në lagjen “****”, Tiranë	500 000
Garazh 18,77 m ² , ndodhur në lagjen ***, Tiranë.	500 000
Ndryshim likuiditeti	278 576
B) Detyrime	-
C) Pasuri neto (A-B)	1 278 576
D) Të ardhura	504 037
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit	101 361
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Universitetin L	14 300
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes B.H	388 376
E) Shpenzime	306 906
Shpenzime jetike	23 955
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 4 të disbursuar në datën 12.2.2009, Alpha Bank (2,000,000 lekë)	31 691
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 5 të disbursuar në datën 14.7.2010, Alpha Bank (5,800,000 lekë)	58 309
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë BKT Bank	40 122
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	152 829
Balanca e fondeve (D-C-E)	(- 1 081 445)

41. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për pagimin në datën 31.1.2013 të shumës prej 1,000,000 lekësh për likuidimin e çmimit të blerjes së apartamentit nga shoqëria “S” sh.p.k., sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, porse në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit²⁷ nga trupi gjykues u konkludua se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë

²⁵ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 2/2023 (JR).

²⁶ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Komisioni në vendimin nr. 554/2022.

²⁷ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 38/2021 (JR).

për t'u konsideruar si një rezultat i vetëm, i cili do e çonte subjektin në konkluzionin për deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

41.1 Në vijim të arsyetimit, trupi gjykues sjell në vëmendje këtu se blerja e apartamentit në fjalë do t'i nënshtrohet sërish vlerësimit të mundësisë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për blerjen e tij, për sa kohë rezulton se është revokuar kontrata në të cilën parashikohet kryerja e pagesës objekt analize.

42. Në vijim, parë nga një këndvështrim objektiv e proporcional, trupi gjykues çmon se rezultati i kësaj analize financiare nuk mund të qëndrojë në këtë moment si shkak i vetëm e i mjaftueshëm për aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa kohë nuk mund të përjashtohet kategorikisht përdorimi i përkohshëm nga subjekti i vlerave të huave të deklaruara, si dhe fakti se subjekti mund të ketë qenë në kushtet e një interpretimi të gabuar të detyrimit për deklaram, bazuar në kuptimin që ai i ka dhënë ligjit të zbatueshëm, Komisioni çmon se rezultatet e kësaj analize financiare duhet të çmohen në tërësinë e vlerësimit të pasurisë së subjektit.

43. Në datën 4.4.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria "S" sh.p.k. revokojnë²⁸ kontratën e shitblerjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.1.2013. Referuar këtij dokumenti noterial, palët me vullnet të lirë e të plotë, nën përgjegjësinë e tyre ligjore dhe me marrëveshje bien dakord dhe vendosin të revokojnë kontratën e mësipërme. Palët me nënshkrimin e aktit noterial "Revokim kontrate" deklarojnë: "Pala blerëse, z. Juljan Haxhiu, kthen në favor të palës shitëse, shoqërisë "S" sh.p.k., apartamentin dhe garazhin e makinës objekt të kontratës së shitblerjes me rezervë, ndërsa pala shitëse kthen në favor të palës blerëse shumën e likuiduar nga blerësi, kthim i cili është bërë jashtë zyrës noteriale me marrëveshje të të dyja palëve. Pas kësaj procedure, palët rikthehen në gjendjen e mëparshme, duke mos pasur asnjë pretendim apo detyrim ndaj njëra-tjetrës".

44. Në datën 5.4.2013, subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e palës blerëse) dhe shoqëria "S" sh.p.k. (në cilësinë e palës shitëse) nënshkruajnë kontratën e shitblerjes me rezervë²⁹, me objekt pasurinë e llojit "apartament" me sipërfaqe 89.82 m², ndodhur në katin e dytë teknik të një godine banimi 7 kate mbi tokë dhe 2 kate nën tokë³⁰ me të dhënat si vijon: nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, me adresë rruga "****", Tiranë, për çmimin 6,200,000 lekë.

44.1 Referuar kësaj kontrate, plani i pagesave është përcaktuar si vijon: (i) Blerësi ka paguar jashtë zyrës noteriale në dorë shumën prej 1,200,000 lekësh; (ii) pjesën tjetër prej 5,000,000 lekësh do ta paguajë pas lëvrimit të kontratës së kredisë me Bankën Kombëtare Tregtare. Të dyja palët janë dakord që të plotësojnë kushtin (rezervën në bazë të nenit 746 e vijues të Kodit Civil) e kësaj kontrate që titulli i pronësisë të kalojë nga shitësi tek blerësi, pasi ky i fundit të likuadojë shumën e mbetur nga çmimi total. Gjithashtu, palët kanë deklaram se nuk kanë asnjë pretendim në lidhje me çmimin dhe mënyrën e pagesës.

²⁸ Dokumenti "Revokim i kontratës së shitblerjes me rezervë nr. *** rep., Nr. *** kol., datë 31.1.2013" nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2013.

²⁹ Kontratë shitblerjeje me rezervë (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

³⁰ Godina 7 kate mbi dhe 2 kate nën tokë, e cila ndodhet përballë shkollës "****", e ndërtuar nga shoqëria "S" sh.p.k., sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 26.10.2004, të KRRT Bashkia Tiranë.

45. Po në datën 5.4.2013, subjekti i rivlerësimit (në cilësinë e palës blerëse) dhe shoqëria "S" sh.p.k. (në cilësinë e palës shitëse) nënshkruajnë kontratën e shitblerjes³¹ me objekt pasurinë e llojit "garazh" me sipërfaqe 18.77 m², nr. pasurie ***, zona kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, me adresë rruga "****", Tiranë, për çmimin 500,000 lekë. Bazuar në këtë kontratë, në datën 13.6.2013 kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në regjistrat hipotekorë³².

46. Në datën 17.6.2013, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria "S" sh.p.k. nënshkruajnë një deklaratë noteriale³³, në referim të së cilës, ndër të tjera, administratori i shoqërisë deklaron se është dakord që apartamenti të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë në emër të blerësit Juljan Haxhiu, para se blerësi të paguajë këstin e kredisë, duke mos pasur asnjë pretendim lidhur me kushtin e nënshkruar nga të dyja palët në kontratën e shitjes. Pra, ai është dakord që kësti i kredisë që do të merret në bankë të paguhet në favor të shoqërisë "S" sh.p.k., pas kalimit të titullit të pronësisë në emër të blerësit Juljan Haxhiu. Deklaruesi Juljan Haxhiu deklaron se është dakord që prona "apartament" të kalojë në emër të tij duke u regjistruar në ZVRPP Tiranë dhe, pas këtij veprimi, të bëhet edhe kalimi i kështit të kredisë për të cilën ai ka aplikuar në Bankën Kombëtare Tregtare, duke garantuar shoqërinë për pagesën me kredi të kështit të fundit, i cili përbën edhe rezervën e kontratës.

46.1 Pas nënshkrimit të kësaj deklarate rezulton se në datën 18.6.2013 kjo pasuri është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit në regjistrat hipotekorë³⁴, datë në të cilën është lëshuar edhe certifikata e pronësisë³⁵.

47. Referuar deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ³⁶, si dhe bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni arrin në përfundimin se pasuritë objekt vlerësimi (apartamenti dhe garazhi) janë të njëjtat pasuri të porositura më parë nga babai i tij në vitin 2005, duke evidentuar këtu se për apartamentin ka pasur një marrëveshje paraprake porosie që në vitin 2004, para marrjes së lejes së ndërtimit nga shoqëria "S" sh.p.k. Pra, duket se apartamenti i porositur nga babai i subjektit në vitin 2004 e në vijim, në vitin 2005, është i njëjti apartament i cili është blerë nga subjekti në vitin 2013.

Verifikimi/Analiza i/e kryer nga Komisioni mbi transaksionet e realizuara në funksion të përfundimit të këtyre pasurive, vlerës totale të paguar, si dhe për ligjshmërinë e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për shlyerjen përfundimtare të çmimit të blerjes së tyre

48. Sikurse u evidentua edhe më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe babai i tij deri në fund të vitit 2006 kishin paguar për blerjen e këtyre dy pasurive (apartamentit + garazhit) vlerën 46,500 euro, me burim të ardhurat e përfutuara nga shitja e apartamentit në Krujë dhe kursimet familjare. Ndërkohë, sipas kontratës së porosisë së vitit 2005, kësti i fundit prej 11,750 euro do të likuidohej me lidhjen e kontratës së shitjes së apartamentit dhe dorëzimit të çelësave në dorë.

³¹ Kontratë shitblerjeje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

³² Referojuni dokumentit "Kartela e pasurisë së paluajtshme" për pasurinë e llojit garazh, pjesë e dokumentacionit të dërguar me shkresën e ASHK Tiranë Veri nr. *** prot., datë 16.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.11.2023).

³³ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.6.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

³⁴ Referojuni dokumentit "Kartela e pasurisë së paluajtshme" për pasurinë e llojit apartament, pjesë e dokumentacionit të dërguar me shkresën e ASHK-së Tiranë Veri nr. *** prot., datë 16.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.11.2023).

³⁵ Dokumenti "Certifikatë për vërtetim pronësie" me nr. serial ***, datë lëshimi 18.6.2013.

³⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. *** të dërguar nga Komisioni.

48.1 Pra, duket se detyrimi i babait të subjektit për të paguar këstin e fundit të blerjes së kësaj pasurie lidhej me plotësimin në mënyrë kumulative të dy kushteve: (i) dorëzimin e apartamentit; (ii) nënshkrimin e kontratës së shitjes së apartamentit.

48.2 Komisioni vëren se vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e ka marrë në dorëzim këtë pasuri të përfunduar në vitin 2007, vit në të cilin referon se ka nisur bashkëjetesën me bashkëshorten B.H, duke banuar pikërisht në këtë apartament.

48.3 Ndërsa, sa i përket kushtit të dytë, subjekti ka deklaruar se për shkaqe të panjohura për ta, apartamenti nuk është regjistruar në regjistrat kadastralë deri në fund të vitit 2012, dhe se për këtë arsye nuk është lidhur kontrata e shitjes dhe nuk është kryer pagesa e këstit të fundit.

49. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga ASHK – Drejtoria Vendore Tiranë Veri, Komisioni konstaton se në datën 6.12.2012 apartamenti i sipërcituar është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të shoqërisë “S” sh.p.k.

50. Rezulton se pasi babai i subjektit ka zgjidhur kontratën e porosisë së dy pasurive (apartament dhe garazh, datë 30.1.2013) dhe është kthyer në gjendjen e mëparshme në raport me marrëdhënien e tij me shoqërinë “S” sh.p.k. (duke supozuar se babait të subjektit iu kthye shuma 46,500 euro), vetë subjekti një ditë më pas ka nënshkruar një kontratë shitblerjeje me rezervë për këto dy pasuri, në total në shumën prej 6,000,000 lekësh.

50.1 Në vijim rezulton se pasi në datën 4.4.2013 subjekti ka revokuar kontratën e shitjes me rezervë për dy pasuritë objekt vlerësimi, një ditë më pas, në datën 5.4.2013, ka nënshkruar kontratën përfundimtare për shitblerjen e garazhit në shumën prej 500,000 lekësh dhe kontratën e shitjes me rezervë për apartamentin, në shumën prej 6,200,000 lekësh. Pra, duket se vlera totale e këtyre pasurive sipas kontratave të muajit prill 2013 (vlera këto të deklaruara në DIPP 2013 dhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*) është në shumën prej 6,700,000 lekësh.

50.2 Ndërkohë, siç u evidentua më sipër, vetëm në përgjigje të pyetësorit nr. *** subjekti ka pretenduar se babait të tij nuk i është kthyer shuma e plotë prej 46,500 euro, pas zgjidhjes së kontratës së porosisë së vitit 2005. Gjithsesi, subjekti pretendon se shuma e ngelur e pakthyer në vlerën rreth 640,000 lekësh është përdorur në funksion të blerjes prej tij në vitin 2013 të apartamentit dhe garazhit nga shoqëria “S” sh.p.k., në dukje duke referuar se në këtë situatë çmimi total i blerjes së tyre ka qenë rreth 7,340,000 lekë.

51. Por, Komisioni konstaton se shuma prej 640,000 lekësh – pjesë e detyrimit të supozuar si të mbetur nga shoqëria “S” sh.p.k. për babain e subjektit, nuk është deklaruar nga subjekti në DIPP 2013 dhe as në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* si burim krijimi i pasurive objekt vlerësimi. Për më tepër, kjo vlerë nuk është pasqyruar si shtesë në çmimin total të deklaruar nga subjekti si të paguar për blerjen e këtyre dy pasurive.

52. Sa më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra nga subjekti dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni paraprakisht vlerësoi se për efekt analize – në dukje pas zgjidhjes së kontratës së porosisë së vitit 2005, babait të subjektit i është kthyer shuma e plotë e referuar si e paguar në funksion të kësaj kontrate përgjatë viteve 2004 dhe 2006, në total në vlerën 46,500 euro.

53. Për pagesën e çmimit të shitblerjes së këtyre dy pasurive subjekti referon se ka shërbyer kredia e marrë në BKT në shumën prej 4,888,000 lekësh dhe pjesa tjetër nga kursimet familjare.

Kredia e marrë nga subjekti i rivlerësimit në Bankën Kombëtare Tregtare

54. Banka Kombëtare Tregtare (BKT)³⁷ konfirmon se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, znj. B.H, në datën 25.9.2013 kanë nënshkruar kontratë kredie bankare³⁸ me këtë bankë për përfitimin e shumë prej 4,960,000 lekësh. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit administrativ lidhur me këtë kredi, rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka aplikuar dhe përfituar këtë kredi me kushte lehtësuese, bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, i ndryshuar.

54.1 Rezulton se me VKM nr. 1714, datë 29.12.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në vendimin nr. 600, datë 12.9.2007 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, në rrethin e personave, subjekteve përfituese janë shtuar edhe gjykatësit e gjykatave të apelit dhe të rretheve gjyqësore.

54.2 Si rrjedhim, Komisioni konstaton se në vitin 2012 subjekti i rivlerësimit, për shkak të funksionit që kryente, bënte pjesë në rrethin e personave të cilëve u lindte e drejta për të përfituar kredi me kushte lehtësuese sipas parashikimeve të bëra në VKM-në 600, datë 12.9.2007.

54.3 Në pikën 2 të VKM-së 600, datë 12.9.2007, përcaktohet se *“të gjitha subjekteve të parashikuara në këtë vendim, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës apo të funksionit shtetëror, kur kanë nevojë për strehim a sipërfaqe banimi shtesë, u lind e drejta të kërkojnë trajtim, me kredi, në kushte lehtësuese, nga shteti, për blerje banese apo sipërfaqe shtesë banimi, në vendin e ushtrimit të detyrës”*, që sipas këtij vendimi nënkupton territorin e rrethit ku ndodhet selia administrative e organit, ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën.

54.4 Nga të dhënat e administruara në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit në momentin e aplikimit për kredi ka qenë me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

54.5 Gjithashtu, në pikën 6 të VKM-së 600, datë 12.9.2007, krahas kriterëve të tjera ndaluese, është parashikuar se *“u lind e drejta për të përfituar kredi lehtësuese subjekteve të cilat në vendin e ushtrimit të detyrës nuk kanë në pronësi të tyre, bashkëshortit/es apo çdo pasardhësi, paraardhësi a personi tjetër në ngarkim pasuri të luajtshme për strehim, me sipërfaqe banimi sipas kuotave të përcaktuara në pikën 5 të këtij vendimi”*, kusht i cili (si detyrim parësor) duket se përmbushet nga subjekti i rivlerësimit në momentin e aplikimit për marrjen e kësaj kredie.

54.6 Në vijim të verifikimit të dokumentacionit – pjesë e dosjes së kredisë, duket se aplikimi i parë për kredi lehtësuese është bërë nga subjekti në fillim të vitit 2012. Evidentohet shkresa e kryetarit të Gjykatës së Lartë³⁹, datë 8.2.2012, me anë të së cilës përcillet në Këshillin e Ministrave kërkesa për trajtimin me kredi të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Juljan Haxhiu, si subjekt përfitues.

54.7 Me anë të deklaratës noteriale të datës 26.1.2012⁴⁰ (pjesë e dosjes së kredisë), subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur (bashkëshortja) deklarojnë se plotësojnë kushtet e parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve publikë”.

³⁷ Shkresat e BKT: (i) nr. *** prot., datë 19.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.2.2021); (ii) nr. *** prot., datë 19.2.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.12.2023).

³⁸ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.9.2013, redaktuar nga noteri publik, znj. F.K.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 8.2.2012.

⁴⁰ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.1.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. M.XH.

55. Gjithsesi, Komisioni konstaton se në periudhë të afërt me aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, e më konkretisht në datën 11.1.2012, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. B.H, i ka dhuruar babait të saj⁴¹ banesën që ajo kishte në pronësi, apartamentin me sipërfaqe prej 91 m², të ndodhur në Tiranë. Nga verifikimi i kryer rezultoi se kjo pasuri ishte blerë⁴² nga personi i lidhur rreth 3 vjet e 6 muaj para fillimit të bashkëjetesës (sipas deklaramit) dhe rreth 4 vjet e 10 muaj para lidhjes së martesës ligjore.

55.1 Rezultoi se kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur që mbart detyrimin për deklaram – të vitit 2008, në seksionin e deklaramit të pasurive, me të dhënat si vijon: *“Apartament banimi 91 m², i ndodhur në Rrugën ***, pallati ***, shkalla ***, kati ***, ap. ***, Tiranë, regjistruar me nr. *** pasurie, në zonën kadastrale ***, blerë me kontratën e shitblerjes datë 23.1.2004. Një pjesë e vlerës (1,500,000 lekë) është paguar nga prindërit (nga shitja e një apartamenti në Gjirokastër), kurse pjesa tjetër është paguar me kredinë në shumën 30,000 USD, të marrë në Alpha Bank. Aktualisht, në të banojmë prindërit (e saj). Vlera totale e pasurisë 4,500,000 lekë. Zotëron 100% pjesë takuese⁴³”.*

56. Konfirmohet se nëpërmjet kontratës së kredisë⁴⁴ të shërbyer me llogari rrjedhëse nr. ***, datë 1.3.2004, personi i lidhur ka përfutur kredinë nga Alpha Bank në shumën prej 30,000 USD, vlerë e cila pas disbursimit (datë 30.3.2004) nëpërmjet transfertës duket se ka kaluar në llogarinë e palës shitëse të pasurisë, me përshkrimin *“Kalim nga B.J tek I.P dhe G.J.P sipas kontratës së shitjes nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 23.1.2004, për blerje apartamenti”*. Rezultoi se kredia e marrë nga personi i lidhur në Alpha Bank pas kryerjes edhe të disa shlyerjeve të parakohshme (në vitin 2005 dhe 2011) është mbyllur plotësisht në datën 27.12.2011.

57. Në vijim të verifikimit të dokumentacionit të kredisë me kushte lehtësuese të përfutur nga subjekti në BKT, në dosje gjenden gjithashtu dokumentet: (i) shkresa e Kryetarit të Gjykatës së Lartë⁴⁵ e datës 20.12.2012, me anë të së cilës përcillet në Këshillin e Ministrave kërkesa për trajtimin me kredi të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Juljan Haxhiu, si subjekt përfutues; (ii) Vërtetim negativ i lëshuar nga ZVRPP Tiranë⁴⁶, datë 26.2.2013, nëpërmjet të cilit nga verifikimi i bërë në sistemin digjital të pasurive konfirmohet se nuk figuron pasuri e regjistruar në emër të shtetasve Juljan Haxhiu dhe B.H.

58. Komisioni konstaton se shuma prej 4,960,000 lekësh, pjesë e fondeve të kredisë me kushte lehtësuese, është disbursuar në llogarinë e subjektit në BKT në datën 7.10.2013. Në vijim rezultoi se në datën 8.10.2013 vlera prej 4,888,000 lekësh – pjesë e këtyre fondeve, është transferuar me përshkrimin *“Juljan Haxhiu kalim shume kësti i fundit për blerje apartamenti në favor të S sh.p.k. sipas kontratës së shitblerjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2013.”*

59. Nga sa u pasqyrua më sipër, duket se në tërësi transaksionet e kryera nga subjekti në lidhje me dy pasuritë objekt vlerësimi janë bërë me qëllim përfutimin e kredisë me kushte lehtësuese në BKT. Kështu, duket se në kushtet kur kishte aplikuar për kredi të butë

⁴¹ Kontratë dhurimi pasuri e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2012, redaktuar nga noteri publik, znj. M.T.

⁴² Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2004, redaktuar nga noteri publik, znj. M.SH.

⁴³ Kjo pasuri është deklaruar nga personi i lidhur edhe në Deklaramitën e personit që mbart detyrim për deklaram pasurie të vitit 2003 (dorëzuar në ILDKPKI në datën 9.3.2004) dhe në DIPP-në e vitit 2004, në cilësinë e subjektit që mbartte detyrimin për deklaramin e pasurive – në atë periudhë me funksion gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Librazhd (larguar nga ky funksion në tetor të vitit 2004).

⁴⁴ Kontratë kredie bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.3.2004.

⁴⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 20.12.2012.

⁴⁶ Dokumenti “Vërtetim” nr. *** prot., datë 26.2.2013.

subjekti ka revokuar kontratën e parë të shitjes me rezervë të nënshkruar me shoqërinë “S” sh.p.k., pasi këto lloj kredish nuk financojnë blerjen e posteve të parkimit (garazheve), por janë të destinuara vetëm për qëllim strehimi. Në këto rrethana, duket se subjekti ka revokuar kontratën e shitblerjes me rezervë të datës 31.1.2013 dhe ka bërë dy kontrata më vete për apartamentin dhe garazhin, në datën 5.4.2013. Kontrata e shitblerjes me rezervë të apartamentit e datës 5.4.2013 është pjesë e dosjes së kredisë dhe mbi bazën e çmimit të përcaktuar në këtë kontratë duket se është disbursuar vlera e kredisë në favor të subjektit (supozohet 80% e çmimit total të apartamentit – sipas politikave të njohura të kohës të bankave tregtare që operojnë në Republikën e Shqipërisë).

60. Duket se qëllimi final i marrjes së kësaj kredie ka qenë shlyerja e kredisë së marrë më parë nga subjekti, bashkëshortja dhe babai i tij, për financimin e blerjes së apartamentit të blerë nga e motra, J.H. Sjellim në vëmendje këtu se subjekti kishte rreth gjashtë vjet që e përdorte apartamentin e porositur nga shoqëria “S” sh.p.k., për të cilin rezultojnë se ishte kryer pjesa më e madhe e pagesës totale në shlyerjen e dy kësteve të para (paguar rreth 80 % e totalit të çmimit të përcaktuar në vitin 2005). Në këtë kuptim, duket se kontratat e lidhura nga subjekti me shoqërinë “S” sh.p.k., në vitin 2013, janë në vazhden e marrëdhënies së krijuar me këtë shoqëri që në vitin 2005.

61. Për sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit ka kryer veprime dhe transaksione fiktive – duke vepruar në kundërshtim me rregullat e etikës, me qëllim përmbushjen e kushteve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese.

62. Gjithashtu, bazuar në analizën e mësipërme, deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes së subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e çmimit të plotë të vlerësuar për pagesën e kryer në favor të shoqërisë “S” sh.p.k., për porositjen e pasurive të llojit apartament banimi dhe garazh, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së dy pasurive objekt vlerësimi (apartamentit dhe garazhit), shtesat e likuiditeteve *cash* dhe në llogari bankare, si dhe mbulimin/kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitin 2013. Evidentohet balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 1.3 milionë lekësh.

63. Me dërgimin e rezultateve të hetimit administrativ në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi konstatimet e mësipërme.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

64. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklaratimeve të bëra në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se veprimet e kryera nuk kanë qenë fiktive, nuk kanë pasur si qëllim përmbushjen e kushteve për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe nuk cenojnë rregullat e etikës, duke argumentuar se asnjë nga veprimet e tij nuk është kryer pa qëllim për të sjellë pasoja juridike, madje kanë sjellë plotësisht e vazhdojnë të sjellin edhe sot pasoja juridike.

65. Në vijim, subjekti referon se bazuar në VKM-në nr. 600, datë 12.9.2007 “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, i ndryshuar, plotësimi prej tij dhe bashkëshortes i kushteve dhe kritereve për të përfituar kredi me kushte lehtësuese nuk ishte formal, por thelbësor, ashtu siç është pasqyruar në deklaratën e dorëzuar me përgjegjësi të plotë prej tyre në datën 26.1.2012.

66. Në lidhje me rrethanën e konstatuar nga Komisioni se në periudhë të afërt me aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, e më konkretisht në datën 11.1.2012, bashkëshortja B.H i ka dhuruar babait të saj banesën që ajo kishte në pronësi, apartamentin me sipërfaqe prej 91 m² të ndodhur në Tiranë, subjekti shpjegon se për nga shkaku ligjor dhe përmbajtja ky

transaksion nuk është bërë për të plotësuar kushtet për kredi lehtësuese, pasi argumenton se ato kushte plotësoheshin thelbësisht edhe nëse apartamenti nuk do të ishte dhuruar.

66.1 Në lidhje me këtë apartament, ai sqaron se është blerë nga familja e bashkëshortes në janar të vitit 2004, duke evidentuar se në atë periudhë kjo familje ka jetuar në Gjirokastër, porse bashkëshortja e tij dhe vëllai i saj jetonin në Tiranë (ajo e punësuar dhe vëllai student) dhe ishte bërë e qartë se nuk do të ktheheshin më në qytetin e lindjes. Për këtë arsye, deklaroi se prindërit e bashkëshortes vendosën gjithashtu të zhvendosen në Tiranë. Në vijim, parashtron se duke qenë se kostoja e blerjes së një apartamenti nuk mbulohej nga shitja e apartamentit në Gjirokastër, nevojitej marrja e një kredie dhe se për lehtësi veprimi të familjes të gjitha veprimet u kryen nga bashkëshortja e tij, megjithëse apartamenti u ble për familjen dhe në të ka banuar dhe vazhdon të banojë familja e saj.

66.2 Për rrethanat e mësipërme – të cilat subjekti i referon si të evidentuara edhe në kontratën përkatëse të dhurimit⁴⁷, me shlyerjen përfundimtare të kredisë bashkëshortja ia ka dhuruar apartamentin babait të saj.

66.3 Gjithashtu, subjekti sqaron se nga marrja e kredisë deri në shlyerjen përfundimtare të saj, pagesat për këstet dhe shlyerjet e parakohshme janë bërë me kontribute të të gjithë anëtarëve të familjes dhe se, pas fillimit të bashkëjetesës dhe martesës, bashkëshortja ka vazhduar të ndihmojë familjen e saj, por në asnjë rast këstet e kredisë nuk janë paguar vetëm prej saj.

66.4 Më specifikisht, subjekti ka deklaruar se në këtë apartament ka banuar fillimisht bashkëshortja dhe vëllai i saj dhe, pas shitjes së apartamentit në Gjirokastër, aty ka banuar e gjithë familja. Në vijim, pas largimit të bashkëshortes e fillimit të bashkëjetesës së tyre, aty kanë banuar prindërit e saj dhe i vëllai. Ndërsa, pas martesës së vëllait të bashkëshortes në vitin 2016 dhe largimit të tij, aty kanë vazhduar të jetojnë prindërit. Evidenton faktin se me ndarjen nga jeta të babait të bashkëshortes në vitin 2021 apartamenti i është nënshtruar regjimit të trashëgimisë ligjore, duke u ndarë në pjesë të barabarta mes bashkëshortes së tij, nënës dhe vëllait të saj⁴⁸. Referon se në këtë apartament vazhdon të banojë nëna e bashkëshortes, siç provohet edhe nga kopjet e librezave të ujit, energjisë elektrike dhe telefonit (depozituar si prova të reja me dërgimin e prapësimeve), të cilat tregojnë se këto shërbime janë në emër të shtetases S.J.

66.5 Për sa më sipër, subjekti parashtron se pavarësisht se i regjistruar formalisht në emër të bashkëshortes, apartamenti objekt shqyrtimi nuk ka qenë asnjëherë pronë e saj vetjake dhe se kontributin më të madh në vënien e tij e ka pasur babai i saj, kaluar disa herë kontributin e pjesëtarëve të tjerë të familjes. Nga ana tjetër, edhe sa i takon shkakut ligjor të blerjes së apartamentit, referon se ai nuk është blerë për t'u përdorur nga bashkëshortja dhe nuk është në fakt përdorur prej saj që nga viti 2007. Gjithashtu, subjekti sjell në vëmendje se me dhurimin formal tek babai i bashkëshortes, i cili do të ishte bërë në çdo rast, apartamenti ka ndjekur rrugën e natyrshme ligjore, duke u ndarë eventualisht sipas regjimit të trashëgimisë ligjore.

67. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti referon se VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, nuk kërkon që gjyqtari të mos ketë asnjë pronë të regjistruar në emër të tij në kuptimin formal, por kërkon që gjyqtari të mos ketë në pronësi një sipërfaqe më të madhe se ajo e parashikuar në VKM. Në këtë kuptim, argumenton se edhe nëse do

⁴⁷ Në mbështetje të këtyre deklarimeve ka depozituar si provë të re deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2023, të lëshuar nga nëna e bashkëshortes S.J dhe vëllai i saj B.J, redaktuar nga noteri publik, znj. F.K.

⁴⁸ Në mbështetje të deklarimeve të tij subjekti ka depozituar dokumentin noterial, dëshmi e trashëgimisë ligjore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2021, lëshuar/redaktuar nga noteri publik, znj F.K.

të ishte bërë pjesëtimi i pasurisë, i cili nuk është kërkuar dhe as pretenduar ndonjëherë, sipërfaqja që në realitet do t'i takonte bashkëshortes së tij do të ishte e papërfillshme në krahasim me kufijtë e përcaktuar nga VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë".

68. Në përfundim, subjekti parashtron se kalimi i pronësisë mbi apartamentin e sipërpërmendur nga bashkëshortja tek babai i saj është një veprim që nuk është kryer me qëllim plotësimin e kushteve për kredi me kushte lehtësuese dhe asnjë veprim fiktiv, por se qëllimi i vetëm i këtij transaksioni ka qenë rivendosja e përputhshmërisë mes gjendjes faktike dhe regjistrimit formal të apartamentit, ashtu siç është pasqyruar në veshjen juridike të këtij transaksioni, pra në kontratën e dhurimit. Po ashtu, referon se ky veprim i ka sjellë të gjitha pasojat që nga momenti i kryerjes, duke kaluar në pronësi dhe, për rrjedhojë, posedim ekskluziv të prindërve të bashkëshortes, por edhe në vijimësi, duke u ndarë sipas regjimit të trashëgimisë ligjore.

69. Në të njëjtën linjë arsyetimi me sa më sipër, subjekti referon se apartamenti i blerë nga familja e tij (në emër të babait G.H), porositja dhe pagesa e pjeshme e të cilit është analizuar hollësisht nga Komisioni, nuk mund të përbëjë mosplotësim të kushteve të VKM-së nr. 600. Ky apartament, siç është pasqyruar edhe në rezultatet e hetimit administrativ, është porositur nga babai i tij dhe pjesa më e madhe e pagesave të bëra për të e ka burimin nga të ardhurat e babait dhe nënës. Sqaron se kontributi i tij ka qenë në marrjen e kredisë, duke e trajtuar këtë si detyrim të familjes, pasi edhe apartamenti ishte pasuri e familjes së origjinës, duke qenë se në kohën e marrjes së kredisë (2006) ishte pjesë e familjes së origjinës dhe beqar. Në këtë kuptim, argumenton se edhe nëse do të ishte bërë pjesëtimi i pasurisë, i cili nuk është kërkuar dhe as pretenduar ndonjëherë, sipërfaqja që në realitet do i takonte atij do të ishte e papërfillshme në krahasim me kufijtë e përcaktuar nga VKM-ja nr. 600, datë 12.9.2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë", madje edhe nëse ajo shihej në kombinim me apartamentin e prindërve të bashkëshortes, të analizuar më lart.

70. Subjekti deklaron se në këto rrethana, duke plotësuar në mënyrë thelbësore kushtet e kriteret për kredi në kushte lehtësuese, kanë paraqitur edhe kërkesën, e cila është miratuar gati një vit më vonë.

71. Parashtron se në aplikimin për kredi me kushte lehtësuese, i cili është pranuar, nuk ka pasur prej tij pasqyrim të rrethanave të pavërteta apo shkelje të rregullave të etikës së profesionit, duke referuar se sipas VKM-së plotësimi i kushteve verifikohet në momentin e aprovimit të kërkesës nga autoriteti përkatës, në këtë rast Kryetari i Gjykatës së Lartë. Megjithatë, argumenton se në rastin e tij, qoftë në momentin e paraqitjes së kërkesës (26.1.2012), qoftë në momentin e kalimit të saj në Këshillin e Ministrave nga Kryetari i Gjykatës së Lartë (8.2.2012 dhe 20.12.2012) apo në momentin e nënshkrimit të kontratës së kredisë bankare (25.9.2013), nuk ka ekzistuar mospërbushje thelbësore e kushteve e kriterëve për përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese. Po ashtu, arsyeton se asnjë veprim i kryer prej tij dhe bashkëshortes nuk ka qenë fiktiv, pra nuk është kryer me qëllimin e vetëm për të plotësuar kushtet për kredi, pasi rezulton se të gjitha veprimet e kryera prej tyre kanë sjellë pasoja juridike të pritshme dhe të dëshiruara, madje vazhdojnë t'i sjellin edhe sot. Në këtë këndvështrim, deklaron se nuk ka pasur prej tij kryerje të veprimeve jashtë detyrës që mund të konsiderohen se ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor, sipas standardit etik të zbatueshëm në atë kohë⁴⁹.

72. Sa i përket revokimit të kontratës së porosisë nga babai i tij, parashtron se ky ka qenë një vendim i tij, i marrë në kushte të caktuara familjare, duke evidentuar faktin se

⁴⁹ Rregulli 15 i Kodit të Etikës Gjyqësore.

marrëdhënia mes tij dhe shitësit, shoqërisë “S” sh.p.k. (më konkretisht, përfaqësuesit ligjor të saj A.S), ka qenë e llojit të veçantë, ku bashkohet puna e përbashkët në vite dhe miqësia e ngushtë. Referon se në kohën kur është bërë revokimi i kontratës ata (ai dhe bashkëshortja) po prisnin një fëmijë dhe se rrethanat e tyre familjare dhe financiare kishin ndryshuar. Ndërkohë, sqaron se vendimin për të marrë kredinë për shtëpinë e motrës e kishin marrë bashkërisht, dhe babai, duke qenë kredihënës e dorëzuan njëkohësisht, ndiente përgjegjësinë për shlyerjen e saj. Për këtë arsye, ai vendosi ta revokonte kontratën, duke pasur pikërisht si synim shlyerjen e kredisë së motrës.

73. Kështu, subjekti pretendon se vendimi për të blerë të njëjtin apartament me kredinë e miratuar ishte më i vonë në kohë sesa vendimi i babait për të revokuar kontratën e porosisë dhe se, duke qenë shfaqje të ndara të vullnetit, ato pasqyrojnë veprime të ndara e që nuk mbivendosen për nga qëllimi dhe pasojat. Deklaron se blerja e apartamentit me kredinë me kushte lehtësuese ishte një veprim juridik i vërtetë, që ka sjellë pasoja juridike, pikërisht ato pasoja të synuara nga palët, duke sqaruar se para këtij veprimi juridik ai nuk ishte pronar i asnjë apartamenti në vendin e ushtrimit të detyrës, kurse pas tij se ai u bë pronar i një apartamenti. Referon se atëherë, por edhe sot, ky është apartamenti i vetëm në pronësinë e tij, për të cilin vazhdon të paguajë rregullisht kredinë bankare me kushte lehtësuese. Pra, sipas subjektit, këto veprime jo vetëm kanë sjellë pasojat e dëshiruara dhe të pritshme ligjërisht për ta, por këto pasoja mund të verifikohen edhe sot.

74. Si përfundim, subjekti referon se veprimet paralele të babait të tij për marrjen e likuiditetit dhe shlyerjen e kredisë së marrë bashkërisht janë vetëm rastësisht të lidhura me veprimet e tij dhe se mes tyre nuk ka mbivendosje të qëndrimit intelektual, prandaj nuk duhen parë të lidhura për nga qëllimi i tyre, duke parashtruar se marrëveshja dhe veprimet mes babait dhe shtetasit A.S kanë qenë një çështje e tyre, në të cilën deklaroi se nuk është përfshirë.

75. Në lidhje me rezultatin financiar të vitit 2013, vit në të cilin janë blerë nga subjekti dy pasuritë objekt vlerësimi, Komisioni vëren se me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka ngritur pretendime për përllogaritjen e disa të ardhurave shtesë të përfituara nga leja e lindjes së bashkëshortes, si dhe të tjera të përfituara prej tij si rezultat i shërbimeve të kryera për ***. Gjithashtu, vërehet se subjekti pretendon heqjen e shpenzimeve mjekësore të vetëdeklaruar prej tij për vitin 2013⁵⁰, pasi referon se janë mbuluar nga kompanitë e sigurimit, si dhe kërkon reduktimin e shpenzimeve të udhëtimit jashtë vendit, duke pretenduar se një pjesë e tyre janë mbuluar nga punëdhënësit/organizatorët.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

76. Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni konkludon se në momentin e aplikimit subjekti i rivlerësimit plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret për t’u trajtuar me kredi me kushte lehtësuese sipas VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”.

⁵⁰ Vetëdeklaruar gjatë hetimit administrativ.

77. Parë në këtë optikë, Komisioni u ndal në vlerësimin e veprimeve dhe transaksioneve të kryera nga subjekti dhe/apo personi i lidhur përpara aplikimit dhe përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese, për shkak të funksionit që mbante subjekti i rivlerësimit.

77.1 *Së pari*, sa i përket dhurimit të pasurisë së llojit apartament nga bashkëshortja e tij te babai i saj, Komisioni vëren se në kontratën e dhurimit të datës 11.1.2012, ndër të tjera është referuar se: *“Pala pranuese e dhurimit është babai i dhurueses dhe arsyeja e këtij dhurimi është se apartamenti që po dhurohet është në të vërtetë apartamenti i familjes dhe babai është kontribuesi kryesor në blerjen e tij. Në vitin 2004, prindërit banonin në Gjirokastër, kurse ajo dhe vëllai në Tiranë, prandaj për të evituar pagimin e qirave të larta, prindërit kontribuuan një shumë të konsiderueshme për blerjen e këtij apartamenti. Apartamenti u ble në emrin e saj dhe kredia për pjesën e mbetur të çmimit të blerjes u mor po në emrin e saj, për shkak se ajo ndodhej në Tiranë dhe ishte më e lehtë për të të merrej me dokumentacionin e blerjes së apartamentit dhe kredisë. Gjithashtu, rezulton se në këtë kontratë dhurimi – nga pala dhuruese është referuar se: “Tani që është martuar dhe e ndarë nga familja, si dhe kredia e marrë për blerjen e këtij apartamenti është shlyer plotësisht, dëshiroj që t’i kthej ligjërisht tim eti apartamentin objekt dhurimi, që në të vërtetë i takon atij si kryefamiljar dhe kontribuesi më i madh në blerjen e tij.”*

77.1.1 Për sa më sipër, Komisioni konstaton se në aktin noterial të kohës së dhurimit thuhet qartësisht se kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët familjare, për të cilën duket se anëtarët e familjes J kishin bashkërisht kontribut në blerjen e saj.

77.1.2 Nga ana tjetër, referuar informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile⁵¹, rezulton se familja e bashkëshortes së subjektit në shkurt të vitit 2005 është regjistruar me banim në qytetin e Tiranës, në adresën që lidhet me vendndodhjen e apartamentit në fjalë. Gjithashtu, pas verifikimit të provave të depozituara nga subjekti nëpërmjet prapësimeve pas dërgimit të rezultateve të hetimit duket se kontratat e shërbimeve utilitare për këtë apartament janë regjistruar qysh në fillim e vazhdojnë të jenë në emër të prindërve të bashkëshortes së subjektit.

77.1.3 Komisioni vëren se në datën 6.12.2021 është bërë lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë ligjore⁵² të babait të bashkëshortes së subjektit e, në vijim, është bërë pjesëtimi i apartamentit në fjalë, duke u regjistruar në regjistrat hipotekorë me nga 1/3 pjesë takuese në emër të trashëgimtarëve ligjorë të z. LL.J, konkretisht bashkëshortes së subjektit, nënës dhe vëllait të saj. Për më tepër, nuk rezulton që prindërit e bashkëshortes apo vëllai i saj të kishin pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi.

77.1.4 Për sa u evidentua më sipër, Komisioni i gjen bindëse shpjegimet e subjektit dhe arrin në përfundimin se, pavarësisht se apartamenti në fjalë është porositur dhe fillimisht është regjistruar në emër të bashkëshortes së subjektit, kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët të familjes J, për të cilën ata kanë kontribuar bashkërisht. Kështu, trupi gjykues argumenton se, megjithëse mund të supozohet se kalimi nëpërmjet dhurimit është bërë për shkak të nevojës për plotësimin e kushteve formale për aplikimin dhe përfitimin e kredisë

⁵¹ Shkresë e DPGJC-së nr. *** prot., datë 19.3.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.3.2024).

⁵² Dokumenti, vendim për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr.*** rep., nr. *** kol., datë 6.12.2021.

me kushte lehtësuese, vlerësohet se ky veprim nuk cenon procesin e aplikimit dhe përfitimit të kësaj kredie, për sa kohë çmohet se nëpërmjet tij është bërë i mundur rregullimi i situatës së gjendjes faktike të kësaj pasurie, të cilën duket se personi i lidhur nuk e përdorte që prej fillimit të bashkëjetesës me subjektin. Në këtë kuptim, Komisioni arrin në përfundimin se dhurimi i apartamentit nga ana e personit të lidhur nuk është një veprim fiktiv, por një veprim real që ka sjellë pasojat ligjore e faktike jo vetëm në momentin që është kryer, por edhe në vijimësi.

77.2 *Së dyti*, në lidhje me veprimet/transaksionet e kryera nga babai i subjektit dhe, në vijim, nga subjekti në lidhje me apartamentin objekt vlerësimi, Komisioni çmon se ato duhet të vlerësohen në tërësi në raport me marrëdhënien e babait të subjektit me shoqërinë ndërtuese “S” sh.p.k., faktit se vetë subjekti nuk kishte porositur prej saj pasuri dhe as nuk kishte pasuri të tjera në pronësi, si dhe me rrethanën e konstatuar se subjekti dhe babai i tij ishin bashkëkredimarrës për një pasuri të blerë nga e motra e subjektit.

77.2.1 Kështu, trupi gjykues çmon se për sa kohë veprimet juridike të kryera nga subjekti e kanë sjellë pasojën, pra blerjen e apartamentit të financuar me kredinë me kushte lehtësuese, pavarësisht kompleksitetit të tyre, nuk mund të vlerësohen si veprime fiktive apo të simuluar. Bazuar në nenet 79⁵³, 92⁵⁴ dhe 93⁵⁵ të Kodit Civil, doktrina dhe jurisprudenca shqiptare është mjaft e konsoliduar në lidhje me përcaktimin e veprimit juridik fiktiv ose të simuluar, ku në mënyrë të përmbledhur evidentohet se si juridik fiktiv ose i simuluar quhet veprimi që bëhet me marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellë pasoja juridike dhe se palët kontraktuese krijojnë vetëm anën e jashtme të një kontrate, për të cilën ata nuk duan të ketë efekt ose krijojnë anën e jashtme të një kontrate të ndryshme nga ajo që dëshirojnë. Në këtë kontekst, në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik⁵⁶.

77.2.2 Nga analizimi në tërësi i të gjitha veprimeve të kryera nga subjekti dhe babai i tij, megjithëse ato paraqiten mjaft komplekse, Komisioni e gjen bindës shpjegimin e subjektit se, nëse analizohen si dy veprime të ndara, me qëllime të ndryshme, secili paraqitet si një veprim i vërtetë juridik që ka sjellë pasojën ligjore të synuar nga palët. Nga njëra anë, subjekti, së bashku me bashkëshorten e tij, duke mos pasur apartament banimi në pronësi të tyre, kanë synuar të bëhen pronarë të një apartamenti në Tiranë, pikërisht në vendin e ushtrimit të detyrës nga ana e subjektit. Përfshirja e mëparshme e subjektit dhe personit të lidhur në kredimarrje për nevoja të strehimit të familjarëve të tyre vlerësohet se nuk e privon subjektin nga e drejta për përfitimin e një kredie me kushte lehtësuese me qëllim blerjen e një pasurie për strehimin e familjes së tij të re, për sa kohë që ai plotëson kushtet dhe kriteret e legjislacionit për përfitimin e kredisë, si dhe kushtet e kriteret e vendosura nga banka lidhur me aftësinë paguese.

⁵³ Ku thuhet se: “Veprimi juridik është shfaqja e ligjshme e vullnetit të personit fizik ose juridik, që synon të krijojë, të ndryshojë ose të shuajë të drejta ose detyrime civile”.

⁵⁴ Ku thuhet se: “Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: ...ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”.

⁵⁵ Ku thuhet se: “Kur veprimi juridik është bërë me qëllim për të mbuluar një veprim juridik tjetër, ky i fundit është i vlefshëm në qoftë se përmbush gjithë kushtet e nevojshme për vlefshmërinë e tij. Veprimi juridik fiktiv ose i simuluar nuk dëmton personat e tretë të cilët në mirëbesim kanë fituar të drejta në bazë të tij”.

⁵⁶ Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 932, datë 22.6.2000.

77.2.3 Nga ana tjetër, babai i subjektit ka synuar të shlyejë detyrimin e kredisë që ka pasur si pasojë e blerjes së një apartamenti prej së bijës, duke revokuar një kontratë të mëparshme porosie, në të cilën vetëm ai ishte palë porositëse. Pavarësisht kontributit financiar që vetë subjekti kishte pasur në vite në pagesat sipas kontratës së porosisë, i evidentuar gjatë hetimit administrativ dhe i pranuar prej tij, revokimi i kontratës së porosisë dhe shlyerja e kredisë, në të cilën babai i subjektit ishte bashkëkredimarrës dhe dorëzanës, paraqiten si shprehje të vullnetit të lirë të këtij të fundit, të cilat gjithashtu i kanë sjellë të gjitha pasojat e synuara. Në këtë kuptim, përdorimi i fondeve të kthyer nga shoqëria “S” sh.p.k. për shlyerjen e kredisë së marrë nga subjekti dhe babai i tij për blerjen e apartamentit të motrës së subjektit nuk e cenon marrëdhënien e re të krijuar mes vetë subjektit dhe kësaj shoqërie.

72.2.4 Të gjitha veprimet e mësipërme të palëve janë kryer në kuadrin e marrëdhënieve të posaçme familjare, me qëllim përmbushjen e nevojës për strehim të anëtareve të familjes së origjinës së subjektit, përfshirë edhe vetë subjektin. Këto veprime i kanë sjellë pasojat e synuara e të pritshme ligjërisht prej tyre. Kështu, babai i subjektit ka humbur të drejtën për të fituar pronësinë mbi apartamentin e porositur dhe ka shlyer kredinë e marrë për apartamentin e së bijës, kurse subjekti dhe personi i lidhur kanë fituar pronësinë mbi apartamentin, duke plotësuar nevojat e tyre për strehim. Sjellim në vëmendje këtu se edhe aktualisht subjekti dhe personi i lidhur vazhdojnë të paguajnë rregullisht këstet e kredisë me kushte lehtësuese të marrë për blerjen e apartamentit në fjalë.

77.2.5 Në rastin konkret, është më se e qartë që pasoja juridike kryesore ka ardhur dhe se, për më tepër, është pikërisht apartamenti për të cilin subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes me rezervë si pjesë e dokumentacionit për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, i cili në vijim ka kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

78. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se u provua bindshëm se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë kryer veprime fiktive apo të simuluar me qëllim plotësimin e kushteve për përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese, si dhe se veprimet e subjektit dhe personit të lidhur nuk kanë pasur për synim të sjellin pasoja të ndryshme nga ato që duhet të priten prej tyre. Në këtë kuptim, nuk ka pasur prej tij shkelje të rregullave të etikës së profesionit.

79. Sa i përket analizës financiare të vitit 2013, vit në të cilin janë blerë nga subjekti dy pasuritë objekt vlerësimi, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, Komisioni vendosi të heqë shpenzimet mjekësore, pasi rezultojnë të mbuluara nga shoqëria e sigurimit “S. U. G. A.” sh.a.,⁵⁷ si dhe të reduktojë shpenzimet e një udhëtimi drejt SHBA-së në vlerën 179,469 lekë, për të cilin duket se shpenzimet janë mbuluar nga organizatori i aktivitetit përkatës⁵⁸.

79.1 Në këtë drejtim, subjekti ka pretenduar edhe korrigjimin e analizës financiare në lidhje me të ardhurat shtesë me burim nga leja e lindjes së bashkëshortes. Komisioni vëren se ky

⁵⁷ Referojuni dokumentit të depozituar nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, “Vërtetim” nr. *** prot., datë 17.5.2024, i shoqërisë “S. U. G. A” sh.a.

⁵⁸ Referojuni dokumentit në gjuhë të huaj (anglisht) “Vërtetim Pjesëmarrje”, së bashku me *email*-et shoqëruese, të depozituara nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, të cilët referon se nga data 4.2.2013 – 22.2.2013 subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesëmarrës si vizitor në aktivitetin e zhvilluar nga Ambasada e ***-së, në bashkëpunim me Zyrën e Punëve Edukative dhe Kulturore të Departamentit të Shtetit të ***-së.

pretendim është i drejtë dhe se këto të ardhura duhet të shtohen në analizën financiare të subjektit. Shuma prej 2,355,599 lekësh e pasqyruar në analizën financiare është totali i të ardhurave të personit të lidhur, të pasqyruara në deklaratën vjetore të të ardhurave (DIVA 2013), konfirmuar edhe nga të ardhurat e kredituara nga punëdhënësi në llogarinë e personit të lidhur në Intesa Sanpaolo Bank. Komisioni e gjen të drejtë prapësimin se në këtë total nuk mund të kenë qenë të përfshira të ardhurat nga leja e lindjes, të cilat, si të ardhura që nuk taten, nuk janë pjesë e DIVA-s (formulari i DIVA-s nuk lejon shtimin e të ardhurave me tatim 0). Për sa më sipër, të ardhurave të personit të lidhur u shtohen edhe 266,508 lekë të ardhura nga leja e lindjes, duke e çuar totalin e të ardhurave në 2,522,107 lekë.

79.2 Gjithashtu, me dërgimin e prapësimeve edhe në seancë subjekti ka bërë kërkime lidhur me disa të ardhura shtesë të përfituara nga shërbimet e kryera prej tij në favor të organizatës ndërkombëtare *** përgjatë viteve 2013 – 2015, duke referuar e depozituar një vërtetim në gjuhë të huaj (anglisht) të lëshuar nga ***, datë 27.10.2016 (dokument i depozituar edhe me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*), për të cilat referon se janë tërhequr me çek. Më konkretisht, për vitin 2013, pretendon se ka përfituar shumën 3,750 euro. Në prapësimet e dërguara në përgjigje të barrës së provës, subjekti, duke pranuar se nuk ka mundësi të vërtetojë pagimin e detyrimeve tatimore, ka kërkuar që, nëse këto të ardhura nuk llogariten në totalin e të ardhurave të tij për vitin 2013, nga analiza e tij financiare të zbritet edhe pasuria e fituar drejtpërsëdrejti prej tyre, specifikisht gjendja *cash* e shtuar në vitin 2013, duke ulur penalizimin e tij në pasuritë e tjera të fituara gjatë këtij viti. Ndërsa në shpjegimet e tij në seancë subjekti u shtoi pretendimeve të tij, duke referuar jurisprudencën e Komisionit dhe Kolegjit⁵⁹ lidhur me të ardhurat nga *** për të njëjtin lloj shërbimi, njohjen e tyre si të ardhura të ligjshme.

79.2.1 Pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë periodikë vjetorë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, Komisioni konstaton se në DIPP 2013, në seksionin e deklarimit të të ardhurave, subjekti ka deklaruar si të ardhura – pagesa për shërbim konsulence nga *** shumën prej 3,750 euro. Gjithashtu, rezulton se edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga shërbimet e kryera për *** për vitet 2013 – 2015, në total shumën prej 4,510 euro.

79.2.3 Sa i përket vlerësimit të këtyre të ardhurave, pavarësisht se: (i) konstatohet se përfitimi i tyre është deklaruar në vazhdimësi nga subjekti, duke mos u lidhur deklarimi i tyre specifikisht me procesin e rivlerësimit dhe rezultatin paraprak financiar të vitit 2013; (ii) nuk vihet në dyshim ligjshmëria e krijimit të tyre –, gjithsesi për sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi to, Komisioni vlerëson se ato nuk përmbushin standardin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës dhe, si të tilla, nuk do të reflektohen si të ardhura në analizën financiare të vitit 2013.

80. Për sa u argumentua më sipër, bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën përfundimtare financiare të vitit 2013, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për shlyerjen e çmimit të plotë për pagesën e kryer në favor të shoqërisë “S” sh.p.k. për

⁵⁹ Vendimet nr. 227, datë 17.1.2020 dhe nr. 393, datë 3.6.2021, të Komisionit, të cilat nuk janë rrëzuar nga Kolegji.

porositjen dhe blerjen e pasurive të llojit apartament banimi dhe garazh, të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

Tabela nr. 5

Analiza e treguesve financiare për vitin 2013	Vlerat në Lek
A) Pasuri	7 838 032
Apartament me sip. 89,82 m ² (neto), ndodhur në lagjen “****”, Tiranë	6 200 000
Garazh me sip. 18,77 m ² , ndodhur në lagjen “****”, Tiranë	500 000
Ndryshim likuiditeti	1 138 032
B) Detyrime	4 960 000
Kredia e disbursuar në datën 7.10.2013 BKT (4,960,000 lekë)	4 960 000
C) Pasuri neto (A-B)	2 878 032
D) Të ardhura	9 571 830
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit	907 725
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në Universitetin L	50 670
Të ardhurat nga paga e subjektit, Sh.U.Gj të Shqipërisë	93 985
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit në ***	-
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit nga ***	164 673
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes B.H	2 522 107
Të ardhurat nga kursimet e prindërve të SR dhe revokimi i kontratës me “S” sh.p.k. nga G.H	5 832 670
E) Shpenzime	7 438 529
Shpenzime jetike	352 560
Shpenzime kredia nr. ***, datë 12.2.2009, Alpha Bank (2,000,000 lekë)	377 774
Shpenzime kredia nr. ***, datë 14.7.2010, Alpha Bank (5,800,000 lekë)	6 014 036
Shpenzime kredia nr. ***, datë 7.10.2013, BKT (4,960,000 lekë)	119 652
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit pranë Alpha Bank	14 234
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë BKT Bank	40 122
Shpenzime për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga paga B.H	321 053
Shpenzime mjekësore	0
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	199 098
Balanca e fondeve (D-C-E)	(- 744 731)

81. Sa më sipër, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së dy pasurive objekt vlerësimi (apartament dhe garazh), shtesat e likuiditeteve *cash* dhe në llogari bankare, si dhe mbulimin/kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara e të evidentuara për vitin 2013, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, porse në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit⁶⁰ trupi gjykues konkludoi se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

81.1 Në vijim të arsytimit, trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare përbën rreth 9,5 % të vlerës, në raport me totalin e pasurive të krijuara nga subjekti dhe personi i lidhur përgjatë vitit 2013, duke pasur parasysh këtu se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, pasi, për shkak të kohës së kaluar dhe mënyrës së kryerjes së analizës, mund të paraqitet edhe një shkallë e caktuar pasaktësie në elementet që ajo vlerëson. Në këtë përfundim, Komisioni është bazuar edhe në përfundimet e nxjerra lidhur me shumën rreth 525,000 lekë, me burim të ardhurat e përfituara nga

⁶⁰ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 38/2021 (JR).

shërbimet e kryera prej subjektit në ***, për të cilat megjithëse Komisioni nuk vuri në dyshim ligjshmërinë e krijimit, vlerësoi se ato nuk përmbushin standardin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës. Në këtë drejtim, Komisioni i gjeti të bazuara pretendimet e subjektit, të mbështetura edhe nga provat e paraqitura prej tij se kjo shumë nuk ka shërbyer për vënien e pasurive të paluajtshme, por vetëm për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2013 nga subjekti dhe personi i lidhur.

81.2 Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti ka deklaruar për herë të parë gjendje *cash* në vlerën 700,000 lekë. Pasi i janë kërkuar sqarime nga ILDKPKI-ja, në datën 21.1.2015 ai ka sqaruar se: “Në datën 31.12.2013 kemi pasur edhe 700,000 lekë në gjendje të lirë (*cash*), të cilat kanë qenë të ardhura nga punësimi dytësor si konsulent pranë *** dhe UGJSH⁶¹”. Ky deklaram, i përsëritur nga subjekti edhe gjatë hetimit administrativ, gjendet i provuar bindshëm nga Komisioni, pasi rezultoi se në datën 4.10.2013 subjekti ka tërhequr me çek 918 USD të paguara nga U.Gj.Sh⁶², kurse më 30.12.2013 ka tërhequr me çek 3,750 euro të paguara nga ***⁶³. Këto veprime janë deklaruar nga subjekti në mënyrë të përsëritur e të qëndrueshme, pa u lidhur me procesin e rivlerësimit. Duke mos pasur investime apo pagesa të deklaruara e të kryera nga subjekti me datë 31.12.2013, Komisioni, bazuar në balancën e probabiliteteve, e gjen të mundshëm deklaramin e subjektit se kjo shumë është mbartur si gjendje *cash*. Në vijimësi, gjendja *cash* është mbartur nga subjekti nga viti në vit, siç pasqyrohet edhe më poshtë në këtë vendim, dhe është përdorur vetëm në vitin 2016, kohë deri në të cilën subjekti ka pasur mundësinë të zëvendësojë këtë vlerë të përjashtuar nga analiza financiare me të ardhura të ligjshme, bazuar në standardin e nenit D/3 të Aneksit të Kushtetutës.

81.3 Në përfundim, trupi gjykues në vlerësimin e kësaj shtate u ndikua edhe nga fakti se duket se kemi të bëjmë me një balancë negative, që është e njëjta e evidentuar më sipër për pasurinë kryesore të paluajtshme (apartamentin), e cila, pasi zbriten të ardhurat nga *** që nuk kanë shërbyer për këtë pasuri, rezultoi të jetë edhe më e vogël. Për më tepër, kjo është balanca e vetme negative vjetore që i rezultoi subjektit dhe personit të lidhur pas kryerjes së analizës financiare përfundimtare⁶⁴ për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

82. Në vijim të verifikimit të llogarive bankare rezultoi se në datën 9.10.2013 (pra, një ditë pas transferimit të fondeve të kredisë me kushte lehtësuese në dukje të llogaria e shoqërisë “S” sh.p.k.) babai i subjektit depozitonte *cash* shumë prej 5,400,000 lekësh në llogarinë e subjektit në Alpha Bank, llogari e cila duket se lidhej dhe shërbente për kryerjen e pagesave të kredisë së marrë nga subjekti, babai dhe bashkëshortja e tij në korrik të vitit 2010, me qëllim financimin për blerjen e një pasurie të paluajtshme (apartament) nga e motra e subjektit, J.H. Menjëherë pas derdhjes së këtyre fondeve është bërë mbyllja e plotë e kësaj kredie⁶⁵.

Kredia e marrë nga subjekti në Alpha Bank për blerjen e shtëpisë së motrës

83. Nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit, babai dhe bashkëshortja e tij në datën 21.6.2010 kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare me Alpha Bank për marrjen hua të shumës në vlerën prej 5,800,000 lekësh, me qëllim blerjen dhe rikonstruksionin e një apartamenti. Nga verifikimi i dokumentacionit – pjesë e dosjes së kësaj kredie, konstatohet kontrata e premtim shitjes pasuri e paluajtshme⁶⁶ e datës 4.6.2010, me palë shitëse shtetasin

⁶¹ Kthim përgjigje datë 21.1.2015, drejtuar ILDKPKI-së, pjesë e dokumentacionit të dërguar nga ILDKPKI-ja me nr. *** prot., datë 25.10.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.10.2023.

⁶² Shihni dokumentacionin e dërguar nga ILDKPKI-ja si më sipër.

⁶³ Shihni dokumentacionin e dërguar nga ILDKPKI-ja si më sipër.

⁶⁴ Referojuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, ndodhur në Aneksin ***, pjesë e këtij vendimi.

⁶⁵ Në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar shlyerjen e kësaj kredie nga kredimarrësi G.H.

⁶⁶ Kontratë shitblerjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2010.

G.M dhe palë blerëse shtetasit G.H dhe J.H, për çmimin 48,000 euro. Nga ana tjetër, rezulton se fondet e kësaj kredie bankare janë disbursuar në llogarinë e subjektit në Alpha Bank, në datën 14.7.2010, dhe se po në të njëjtën ditë shuma prej 5,784,000 lekësh është transferuar me përshkrimin “*Juljan Haxhiu sa kaluar për G.M për blerje apartamenti*”.

83.1 Gjithashtu, Komisioni konstaton se si kolateral për përfitimin e kësaj kredie është vendosur apartamenti me sipërfaqe prej 133 m², ndodhur në bulevardin “****”, Tiranë, në pronësi të babait të subjektit G.H, pasuri e cila, sikurse u evidentua edhe më sipër, rezulton t’i jetë kaluar në pronësi pa kundërshtim nga shoqëria “S” sh.p.k. në muajin nëntor të vitit 2000⁶⁷, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit sapo kishte nisur studimet në Shkollën e Magjistraturës.

84. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2010, në seksionin “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”, subjekti ka deklaruar hapjen e llogarisë së përbashkët bankare në Alpha Bank në emër të tij, bashkëshortes dhe babait G.H. Ndërsa, në seksionin e deklarimit “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” subjekti ka deklaruar kredi për blerje apartamenti në Alpha Bank, në shumën prej 5,800,000 lekësh, bashkëkredimarrës me bashkëshorten dhe babain e tij.

84.1 I pyetur më parë nga ILDKPKI-ja⁶⁸ mbi deklarimin e kredisë për blerje apartamenti, subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë për motrën e tij, e cila banon në të prej muajit prill të vitit 2011, duke paraqitur kontratën e shitblerjes⁶⁹ të datës 15.6.2010, në referim të së cilës motra e subjektit, J.H, ka blerë nga shtetasi G.M apartamentin me sipërfaqe prej 57.1 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, për çmimin prej 5,139,000 lekësh.

84.2 Në lidhje me këtë marrëdhënie, gjatë hetimit administrativ⁷⁰ subjekti ka deklaruar se në vitin 2010 për shkak të disa rrethanave shëndetësore e familjare të motrës së tij, në pamundësi që ajo dhe partneri i saj, me të cilin bashkëjetonte deri atëherë, të siguronin banesë bashkëshortore, bashkërisht në familje vendosën që të kontribuonin për blerjen e një apartamenti pranë tyre. Subjekti ka sqaruar se me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.6.2010, u ble nga pala shitëse G.M në favor të palës blerëse J.H apartamenti me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 57.1 m², i ndodhur në rrugën “****”, me vlerë shitjeje 5,139,000 lekë. Blerja dhe mobilimi i këtij apartamenti u financua nga kredia bankare e marrë pranë Alpha Bank, me kontratën nr. ***, datë 21.6.2010, në vlerën prej 5,800,000 lekë dhe me afat 15 vjet. Referon se kredimarrës ishte ai vetë së bashku me bashkëshorten dhe babain dhe se, me disbursimin e kredisë, janë përfituar 5,784,000 lekë, nga të cilat 5,139,000 lekë i janë kaluar shitësit dhe pjesa tjetër është përdorur për mobilimin e apartamentit.

85. Referuar të dhënave të pasqyruara në kontratën e depozituar nga subjekti, rezulton se kjo pasuri është e njëjtë me pasurinë e blerë më parë nga babai i subjektit dhe e motra e tij në datën 4.6.2010, për çmimin prej 48,000 euro, po nga shtetasi G.M, kontratë e cila është pjesë e dosjes së kredisë.

⁶⁷ Referuar dokumentit, akt noterial për heqje dorë nga apartament banimi/kontratë për kalim pronësie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.11.2000, redaktuar nga noteri publik, znj. V.S.

⁶⁸ Referojuni shkresës së depozituar nga subjekti në ILDKPKI, që mban datën 21.1.2015 dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, të përcjellë në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 26.10.2023).

⁶⁹ Kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.6.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. M.H.

⁷⁰ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. ***.

85.1 Nga ana tjetër, Komisioni vëren se në kontratën e datës 15.6.2010 përcaktohet se çmimi i shitjes së këtij apartamenti është likuiduar nga ana e blerësve në favor të shitësit jashtë zyrës noteriale.

86. Në lidhje me ekzistencën e këtyre dy kontratave, gjatë hetimit administrativ⁷¹ subjekti ka deklaruar se ka qenë një kërkesë e bankës – në dukje me qëllimin e kreditimit të shumës së plotë të çmimit të dakordësuar për blerjen e kësaj pasurie, përfshirë këtu dhe shpenzimet shtesë të mobilimit.

87. Gjithashtu, Komisioni konstaton se bazuar në kontratën e shitjes të datës 15.6.2010 – në të cilën referohet shlyerja e plotë e çmimit të përcaktuar nga palët, në datën 2.7.2010, kjo pasuri është regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të motrës së subjektit, znj. J.H. Ndërkohë, ka rezultuar se vetëm në datën 14.7.2010 janë kaluar fondet në favor të shitësit të kësaj pasurie, z. G.M, në shumën 5,784,000 lekë.

87.1. Pra, duket se vlera e këtij apartamenti është shlyer tërësisht nga pala blerëse përpara disbursimit të fondeve të kredisë nga Alpha Bank. Për rrjedhojë, duket se fondet e përfituara nga Alpha Bank nuk janë përdorur me qëllim likuidimin e çmimit të blerjes së këtij apartamenti.

88. Për sa më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit duke i kërkuar: (i) të deklarojë dhe depozitojë dokumentacion justifikues ligjor mbi të ardhurat të cilat kanë shërbyer për likuidimin në datën 15.6.2010 të çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe prej 57.1 m², të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, në shumën 5,139,000 lekë; (ii) të deklarojë mbi destinacionin e fondeve të përfituara nga kredia e marrë në Alpha Bank, në total në shumën 5,784,000 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

89. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit parashtroi se u qëndron deklarimeve të dhëna më parë, qoftë në lidhje me qëllimin e marrjes së kredisë, ashtu edhe në lidhje me mënyrën se si janë kryer veprimet.

90. Në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka sqaruar historikun e këtyre veprimeve, duke u qëndruar edhe shpjegimeve në pyetësorët e dërguar gjatë hetimit administrativ e duke sqaruar se kredia është marrë prej tij, bashkëshortes dhe babait për të blerë një apartament për motrën dhe familjen e saj. Deklaron se që në momentin e identifikimit të një apartamenti të përshtatshëm ata e kishin marrë vendimin se do të merrnin një kredi për të, të cilën do ta paguanin me të ardhurat e përbashkëta, por bisedimet me shitësin dhe modalitetet e marrëdhënies me të ia lanë babait dhe motrës. Referon se për këtë arsye ai ka deklaruar më parë dhe i qëndron deklaramit se nuk e ka takuar asnjëherë shitësin G.M dhe nuk i ka bërë atij asnjëherë asnjë pagesë, përveç asaj të kryer nëpërmjet transfertës bankare në datën 14.7.2010.

91. Subjekti ka deklaruar se që në fillim marrëveshja me shitësin ka qenë që apartamenti do të blihej për çmimin prej 5,139,000 lekë, dhe se kjo ishte vlera në të cilën ai (shitësi) e kishte blerë këtë apartament më pak se 4 muaj më parë⁷². Referon se, me sa kujtojnë familjarët e tij, ai e kishte blerë apartamentin për të banuar aty, por një ndryshim në rrethanat familjare e kishte shtyrë ta shiste pothuajse menjëherë. Nisur nga këto rrethana, subjekti parashtroi se vërtetohet që vlera e blerjes ka qenë 5,139,000 lekë, qoftë edhe për faktin se nuk do të kishte qenë e mundur që vlera e tregut të apartamentit të ishte rritur në

⁷¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. ***.

⁷² Bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka depozituar si provë të re kopje të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.2.2010, redaktuar nga noteri publik, znj. N.K.

6,662,880 lekë (ekuivalent i vlerës prej 48,000 euro), pra një rritje prej 1,500,000 lekësh ose 22.5% e vlerës në më pak se 4 muaj, për një banesë që ndodhej në një ndërtesë të para viteve '90, ndërtim parafabrikat.

92. Në vijim, subjekti ka argumentuar se nisur nga rrethanat e veçanta të rastit ku rezultonte se kredimarrësi dhe blerësi i pronës nuk ishin i njëjti person, ndërkohë që prona e vendosur si kolateral ishte një pronë tjetër⁷³, banka kredidhënëse u kërkoi që të paraqesin jo vetëm kontratën e shitjes, por edhe certifikatën e pronësisë, e cila do të vërtetonte kalimin e pronësisë tek blerësi. Shpjegon se për këtë arsye kontrata e shitblerjes përmban shënimin që vlera është likuiduar e plotë jashtë zyrës noteriale, e nevojshme për të kryer regjistrimin. Megjithatë, deklaron se nuk ka pasur pagesa të kryera ndaj shitësit G.M as prej tij dhe as nga anëtarë të familjes para ose në kohën e nënshkrimit të kontratës, dhe as nuk do të kishte qenë kjo e mundur, pasi nuk dispononin një likuiditet të tillë në bankë apo në gjendje *cash*. Subjekti ka deklaruar se nuk është në gjendje të flasë me siguri të plotë për perceptimin e situatës nga ana e shitësit G.M, por familjarët e tij kujtojnë se ai ishte në nevojë për ta shitur shpejt apartamentin dhe për të marrë të gjithë vlerën në një dorë. Mendon se kjo ka qenë arsyeja që ai ka rënë dakord me mënyrën e mësipërme të të vepruarit⁷⁴.

93. Për sa ka sqaruar më sipër, subjekti parashtron se pagesa e vetme dhe e plotë e vlerës së blerjes i është bërë shitësit G.M pas disbursimit të kredisë bankare, siç është treguar edhe nga mandati bankar. Pra, deklaron se destinacioni i kredisë së marrë ka qenë vetëm likuidimi i çmimit në favor të shitësit G.M, duke referuar se do të kishte qenë një veprim krejt i pakuptimtë prej tyre marrja e kësaj kredie bankare, në rast se do ta kishin, qoftë edhe bashkërisht me të gjithë anëtarët e familjes, likuiditetin që nevojitej për t'i blerë një apartament motrës dhe aq me tepër të vendosnin si garanci për kredinë një pronë që e tejkalonte dyfish vlerën e saj⁷⁵.

94. Më tej në prapësimet e tij, subjekti ka evidentuar faktin se kredia është disbursuar në llogari bankare dhe nuk i është paguar shitësit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga Alpha Bank/kredidhënësi, pra se nuk është kaluar drejtpërdrejt nga banka te pala shitëse. Sipas subjektit, në këtë moment ata nuk kishin ndonjë detyrim para bankës që vlerën e kredisë t'ia kalonin shitësit, gjë që nuk do ta kishin bërë nëse atij do t'i ishte paguar çmimi i shitjes, duke argumentuar se arsyeja e vetme e kryerjes së kësaj transferte ka qenë fakti që shitësit ende nuk i ishte bërë pagesa dhe se kjo përfaqëson pagesën e vetme të bërë për të.

95. Si përfundim, subjekti deklaron se çmimi i blerjes së këtij apartamenti ka qenë 5,139,000 lekë, likuiduar nëpërmjet transfertës bankare në favor të palës shitëse, me burim fondet e përfituara nga kredia e marrë në Alpha Bank.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

96. Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni vëren se, ndryshe nga sa argumenton subjekti, si pjesë e dosjes së kredisë është depozituar kontrata e premtim-shitjes pasuri e paluajtshme⁷⁶ e datës 4.6.2010, me palë shitëse shtetasin G.M dhe palë blerëse shtetasit G.H dhe J.H, për çmimin prej 48,000 euro, në të cilën referohet se është paguar paraprakisht shuma prej 2,000 euro. Pra, për bankën një nga palët blerëse është pala e cila ka lënë si kolateral një pasuri të paluajtshme.

⁷³ Apartamenti në pronësi të babait.

⁷⁴ Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar si provë të re “Deklaratën Noteriale” të lëshuar nga babai dhe motra e tij nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.5.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. F.K.

⁷⁵ Siç tregohet në dosjen e kredisë, të administruar nga Komisioni.

⁷⁶ Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.6.2010.

96.1 Për rrjedhojë, duket se depozitimi i kësaj kontrate në dosjen e kredisë është bërë më qëllim përfitimin e një vlerë kredidhënieje të tillë që të mbulonte vlerën e plotë të shitblerjes së kësaj pasurie sipas kontratës së shitblerjes⁷⁷ të datës 15.6.2010.

96.2 Megjithatë, pas verifikimit të dosjes së plotë të kredisë bankare, duket se, përveç faktit se subjekti ka qenë kredimarrës së bashku me babain dhe bashkëshorten e tij, nuk rezulton të ketë pasur rol aktiv në procesin e shitblerjes së pasurisë objekt vlerësimi dhe se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se subjekti ka pasur dijeni për paraqitjen e një kontrate të ndryshme në dosjen e kredisë nga ajo e dakordësuar prej motrës së tij me palën shitëse. Ky përfundim mbështetet edhe në faktin se në ILDKPKI subjekti ka deklaruar pikërisht kontratën e datës 15.6.2010, në referim të së cilës kjo pasuri është regjistruar në emër të motrës së tij.

97. Nga ana tjetër, nisur nga evidentimi i çmimit të blerjes së kësaj pasurie nga pala shitëse rreth katër muaj para shitjes së saj në favor të motrës së subjektit, si dhe për shkak të rrethanave të tjera të lidhura me transaksionet e kryera për likuidimin e çmimit të shitblerjes nëpërmjet sistemit bankar, Komisioni i gjen bindëse deklaratimet e subjektit se nuk ka pasur pagesë të mëparshme në funksion të shlyerjes së çmimit të blerjes të kësaj pasurie – krahas asaj të kaluar në llogarinë bankare të shitësit me burim të ardhurat e përfituara nga kredia e marrë në Alpha Bank.

98. Për sa u argumentua më sipër, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit⁷⁸, për sa kohë nuk ngrihen dyshime të arsyeshme për pasuri të fshehur në emër të subjektit të rivlerësimit, porse evidentohet vetëm përfshirja e tij në marrjen përsipër të detyrimeve (si bashkëkredimarrës), trupi gjykues çmon se transaksionet e kryera në lidhje me këtë pasuri nuk mund të ndikojnë në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarit Juljan Haxhiu.

99. Pasuria e llojit apartament banimi, ndodhur në Durrës, Lagjja ***, ***, me sipërfaqe prej 53 m², me vlerë 34,800 euro. Deklaron se zotëron 25% pjesë takuese të kësaj pasurie.

99.1 Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) shumën 13,800 euro, nga kursimet personale të prindërve të tij G dhe M.H; (ii) shumën 5,000 euro, nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes B.H; (iii) shumën 2,000,000 lekë (ose 16,000 euro) të përfituar nga kredia e marrë në Alpha Bank (kontratë kredie bankare nr. ***, datë 13.1.2009).

99.2 Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se ky apartament është blerë në vitin 2009 dhe është regjistruar në emër të babait G.H, porse ai vetë dhe bashkëshortja kanë kontribuar në pagesën e kështit të parë dhe në vlerën e kredisë së marrë, të cilën e kanë paguar me të ardhurat nga pagat.

100. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Pas verifikimit të deklaratave të interesave privatë/ periodikë vjetorë të depozituar ndër vite në ILDKPKI, mbi deklaratimet e bëra nga subjekti të lidhura me pasurinë objekt vlerësim, Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2009, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar kredi për blerje apartamenti të marrë në Alpha Bank, në shumën 2,000,000 lekë, kredimarrës së bashku me bashkëshorten. Ndërsa në seksionin e të dhënave konfidenciale të kësaj deklarate subjekti ka deklaruar se *G.H i ati dhe M.H e ëma, dy kreditë bankare janë marrë për blerjen e dy apartamenteve të përbashkëta*. Duket se njëra kredi që referohet në këtë deklaram është pikërisht kredia e tij e marrë në Alpha Bank në vitin 2009.

⁷⁷ Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.6.2010, redaktuar nga noteri public, znj. M.SH.

⁷⁸ Referojuni vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 21 (JR), datë 10.9.2020 (paragrafët 74 – 77).

101. Konstatimi i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar. ZVRPP-ja Durrës konfirmon apartamentin në pronësi të babait të subjektit, z. G.H.

102. Hetimi/verifikimet i/e kryer/a nga Komisioni lidhur me këtë pasuri: Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së ILDKPKI-së, i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, si dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri⁷⁹, Komisioni konstaton se:

103. Në datën 6.1.2009, mes babait të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e porositësit dhe shoqërisë “A” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes⁸⁰, në të cilën përcaktohet se sipërmarrësi do të ndërtojë / shesë pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 58 m² dhe sipërfaqe të përbashkët 5 m², të ndodhur në katin e ***, ap. ***, në objektin e ndërtuar/që po ndërtohej nga shoqëria “A” sh.p.k., pajisur me leje ndërtimi nga KRRT-ja e Bashkisë Durrës, të ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës, kundrejt çmimit në total 34,800 euro. Palët kanë përcaktuar se kësti i parë në shumën 13,000 euro deklarohet i paguar në datën e lidhjes së kësaj kontrate. Për diferencën përcaktojnë se do paguhet përkatësisht kësti i dytë në shumën prej 20,000 euro brenda datës 10.2.2009, ndërsa kësti i tretë në vlerën 1,800 euro do të likuidohet në momentin e nënshkrimit të aktit përfundimtar të shitjes.

104. Në datën 5.5.2011, babai i subjektit të rivlerësimit në cilësinë e blerësit dhe shoqëria “A” sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin A.K, në cilësinë e shitësit, nënshkruajnë kontratën e shitblerjes⁸¹ me objekt blerjen e një apartamenti banimi nr. ***, kati ***, dhe nr. pasurie ***, z.k. nr. ***, me sipërfaqe prej 53 m² dhe 5m², për çmimin 2,200,000 lekë. Në këtë kontratë, çmimi i përcaktuar 2,200,000 lekë është konsideruar i shlyer midis palëve para nënshkrimit të kontratës së shitjes.

105. ASHK – Drejtoria Vendore Durrës⁸² konfirmon se në emër të babait të subjektit figuron e regjistruar pasuria objekt vlerësimi e llojit apartament banimi me sipërfaqe prej 53 m². Duket se kjo pasuri është regjistruar në emër të babait të subjektit në regjistrat hipotekorë, bazuar në kontratën e shitblerjes të datës 5.5.2011, të sipërcituar.

106. Nga verifikimi i llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në Alpha Bank rezulton se në datën 30.12.2008 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 13,000 euro. Referuar rezultateve të analizës paraprake financiare, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të krijonte këtë vlerë monetare si kursim përgjatë vitit 2008 – me burim nga të ardhura financiare të ligjshme.

107. Gjithashtu, Komisioni konstaton se kjo llogari bankare nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit si shtesë pasurie në DIPP-në e vitit 2008.

108. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegimet e tij mbi mosdeklarimin e kësaj llogarie bankare në deklaratën e interesave privatë të vitit

⁷⁹ (i) Dokumentacioni i depozituar nga subjekti me dorëzimin e deklaratës së rivlerësimit kalimtar *Vetting*, ndodhur në Aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) dokumentacioni i përcjellë me shkresën e ILDKPKI-së nr. ** prot., datë ** (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë **); (iii) dokumentacioni i administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ; (iv) dokumentacioni i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

⁸⁰ Kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.1.2009, redaktuar nga noteri publik, z. R.K.

⁸¹ Kontratë porosie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.2.2011, redaktuar nga noteri publik, znj. G.B.

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 16.3.2021).

2008 të depozituar në ILDKPKI, si dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, iu kalua barra e provës mbi rezultatet e analizës financiare të vitit 2008⁸³.

109. Në vijim të verifikimit të kësaj llogarie, Komisioni konstaton se në datën 6.1.2009 (një ditë pas nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes për porositjen e pasurisë objekt vlerësimi), shuma prej 13,000 euro transferohet me përshkrimin “*Sa paguar nga Haxhiu Juljan për G.H tek A sh.p.k. / likuidim kësti i parë për blerje apartamenti, objekti *** në Durrës*”.

110. Rezulton se në datën 27.1.2009 subjekti i rivlerësimit ka lidhur kontratën e kredisë bankare⁸⁴ me Alpha Bank për marrjen e huas në shumën prej 2,000,000 lekësh. Në datën 12.2.2009, në llogarinë e subjektit është disbursuar kredia në shumën 2,000,000 lekë, vlerë e cila konvertohet në shumën 15,229 euro. Po në datën 12.2.2009, subjekti depoziton *cash* në këtë llogari shumën 4,740 euro. Më tej rezulton se në datën 13.2.2009 subjekti e transferon shumën 19,719 euro me përshkrimin “*Sa paguar nga Juljan Haxhiu për G.H tek A sh.p.k./likuidim kësti i dytë për blerje apartamenti, objekti *** në Durrës*”.

111. Sa më sipër, duket se pagesat e dy kësteve të para për shlyerjen e çmimit të blerjes së kësaj pasurie – në total në shumën 32,719 euro, janë kryer nga subjekti i rivlerësimit. Rezulton se edhe në këtë rast subjekti është investuar në marrjen e një kredie për shlyerjen e çmimit të blerjes për pasuri të paluajtshme të porositur nga babai i tij.

112. Në këto rrethana, në kushtet e evidentimit të kryerjes së dy pagesave nga subjekti i rivlerësimit – në dukje me të ardhura nga burime financiare të tij – Komisioni ngre dyshimin e arsyeshëm se kemi të bëjmë me pasuri të porositur dhe paguar plotësisht nga subjekti, por të regjistruar në emër të babait të tij. Vlen të përmendim këtu se subjekti ka deklaruar pjesë takuese në këtë pasuri, duke referuar se ka investuar në likuidimin e çmimit të blerjes së saj me kredinë e marrë dhe disa kursime të tjera të tij.

113. Si rrjedhim, Komisioni paraprakisht vlerësoi se të gjitha pagesat e bëra në shkurt të vitit 2009 janë kryer nga ana e subjektit me burime financiare të tij.

114. Bazuar në analizën e mësipërme, deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën paraprake financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës në favor të shoqërisë “A” sh.p.k., për likuidimin e dy kësteve të para për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi (regjistruar në emër të babait), nga duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie. Evidentohet balanca negative e fondeve në shumën prej rreth 1.2 milionë lekësh⁸⁵.

115. Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit mbi dyshimet e ngritura në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, si dhe mbi rezultatet e analizës së bërë në lidhje me mundësinë e blerjes

⁸³ Vlen të sqarohet këtu se në materialin Rezultatet e Hetimit Administrativ në trajtimin e pasurisë objekt vlerësimi ka pasur një gabim material duke u parashtruar se: “*Referuar rezultateve të analizës paraprake financiare duket se, subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi të krijonte këtë vlerë monetare si kursim përgjatë vitit 2008 (shumën prej 13,000 euro evidentuar si gjendje në llogari bankare) – me burim nga të ardhura financiare të ligjshme*” (duhej **nuk ka pasur mundësi**). Gjithsesi, me rezultatet e analizës paraprake financiare subjektit i është kaluar barra e provës edhe për pamundësinë financiare për krijimin e shtesave të pasurive dhe/apo mbulimin e shpenzimeve për vitin 2008 (vit në të cilin evidentohet krijimi i kësaj depozite), ku u konstatua balanca negative e fondeve në shumën prej 1,342,188 lekësh.

⁸⁴ Kontrata e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.1.2009, redaktuar nga noteri publik, z. J.ZH.

⁸⁵ Analiza e treguesve financiarë e kryer për periudhën 1.1.2009 – 13.2.2009 (data e likuidimit të çmimit të plotë të pasurisë objekt vlerësimi).

së saj nga burime financiare të ligjshme të subjektit dhe personit të lidhur, evidentuar si më sipër.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

116. Komisioni vëren se nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore publike, në lidhje me këtë apartament subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se u qëndron deklarimeve të bëra më parë në deklaratat periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, pra se kemi të bëjmë me një pasuri, identifikimi dhe planifikimi për blerje i së cilës është bërë nga babai i tij dhe se ai i është bashkuar kësaj ideje, duke qenë dakord për përdorimin e mëtejshëm të përbashkët të saj.

117. Subjekti deklaron se kontributi i babait (prindërve të tij) në vënien e kësaj pasurie ka qenë i konsiderueshëm dhe se ka qenë pikërisht babai që ka zhvilluar të gjitha bisedimet dhe veprimet ligjore, si dhe ka kontribuar financiarisht për blerjen e saj. Argumenton se kryerja e veprimeve bankare prej tij nuk e bën automatikisht pronar të vetëm të kësaj pasurie.

118. Në vijim të prapësimeve të tij, në lidhje me konstatimet e bëra dhe analizën e treguesve financiare të kryer nga Komisioni për këtë pasuri, subjekti ka parashtruar se:

118.1 *Së pari*, siç evidentohet edhe nga Komisioni, duhet të mbahet parasysh se vlera totale e paguar për vitin 2009 (muajt janar e shkurt) ka qenë 32,719 euro, porse ekuivalenti i kësaj shume në lekë në këtë kohë është 4,488,065 lekë, por 4,124,920 lekë⁸⁶.

118.2 *Së dyti*, pasi evidenton faktin se pagesa e kësaj të parë në favor të shoqërisë “A” sh.p.k. është bërë në datën 6.1.2009⁸⁷ nëpërmjet transfertës nga llogaria e tij në Alpha Bank, me burim një shumë të depozituar në datën 30.12.2008, vlerëson si të drejtë konstatimin e Komisionit se gjendja e kësaj llogarie nuk është deklaruar në deklarin periodik vjetor për vitin 2008, por se ky mosdeklarim nuk ka pasur si qëllim fshehjen dhe as nuk do të kishte qenë e mundur fshehja e një veprimi të kryer nëpërmjet sistemit bankar. Referon se në kohën e plotësimit të deklaratës shuma ishte përdorur tashmë dhe mospasqyrimi i saj ka qenë vetëm një harresë, e ndikuar nga fakti që depozitimi ishte bërë shumë afër fundit të vitit dhe, në kohën e plotësimit të deklaratës, kishin kaluar disa muaj e shuma ishte likuiduar tashmë. Nga ana tjetër sqaron se llogaria në Alpha Bank nuk përdorej shpesh prej tij për veprime të zakonshme bankare, por në këtë rast u përdor sepse në këtë bankë do të merrej edhe kredia bankare.

118.3 *Së treti*, deklaron se burimi i kësaj shume (vlerës prej 13,000 euro, gjendje në llogari bankare në Alpha Bank në fund të vitit 2008) kanë qenë të ardhurat familjare gjatë vitit. Subjekti ka evidentuar veprimet e kryera në llogaritë bankare të tij dhe babait G.H, si vijon: (i) Në datën 29.12.2008, ai ka tërhequr nga llogaria e pagës në BKT shumën prej 550,000 lekësh që ishte gjendje në llogari nga pagat e vitit; (ii) Në datën 29.12.2008, babai G.H ka tërhequr shumën prej 200,000 lekësh nga llogaria në Raiffeisen Bank që përfaqësojnë kursime të tij dhe nënës nga pagat⁸⁸; (iii) Në datën 30.12.2008, babai G.H ka tërhequr shumën prej 292,500 lekësh nga llogaria në ProCredit Bank, që përfaqësojnë kursime të tij dhe nënës nga pagat; (iv) Në datën 30.12.2008, babai G.H ka tërhequr shumën prej 297,940 lekësh nga llogaria në Alpha Bank, që përfaqësojnë kursime të tij dhe nënës nga pagat.

⁸⁶ Ka referuar kursin zyrtar ditor të këmbimit për datat e kryerjes së pagesave, të reflektuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.

⁸⁷ Datë në të cilën është nënshkruar edhe kontrata mes palëve.

⁸⁸ Referon se të dhënat për punësimin e tyre janë administruar në dosjen e hetimit administrativ.

Referon se këto fonde, së bashku me gjendjen *cash* të mbajtur në shtëpi prej tij dhe bashkëshortes, janë përdorur për pagesën e kështit të parë.

118.4 *Së katërta*, referon edhe një herë se kësti i dytë është paguar në datën 13.2.2009, një ditë pas disbursimit të kredisë bankare, vlera e së cilës është konvertuar në shumën 15,299 euro, dhe së bashku me vlerën 4,740 euro, depozituar në llogari në datën 12.2.2009, shoqërisë sipërmarrëse i janë transferuar 19,719 euro. Në lidhje me depozitim e shumës 4,470 euro dhe burimin e krijimit të saj, subjekti ka evidentuar faktin se në datën 9.1.2009 babai G.H ka tërhequr nga llogaria e tij në ProCredit Bank shumën prej 340,000 lekësh, që përfaqëson kursimet e tij dhe të nënës nga pagat, kurse për pjesën tjetër janë përdorur po kursimet e prindërve, të cilat i mbanin gjendje *cash* në shtëpi.

118.5 *Së pesti*, krahas sa më sipër, subjekti ka kërkuar që të hiqen shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit të reflektuara në analizën financiare për periudhën 1.1.2009 – 12.2.2009, pasi i referohen një udhëtimi, shpenzimet e të cilit kanë qenë të mbuluara nga organizatori (F. A, anëtarë të të cilit kanë qenë ai dhe personi i lidhur, bashkëshortja).

119. Më tej në prapësimet e tij, subjekti ka referuar se një fakt i rëndësishëm që duhet përmendur, është se për efekt të garantimit të pagesës së kredisë së marrë për këtë pasuri, garanci është vendosur apartamenti në pronësi të prindërve të tij⁸⁹, çka përbën një provë më tepër për faktin se kjo nuk ka qenë një pronë vetjake. Në rast se do të kishte qenë ndryshe, vetë apartamenti i blerë do të ishte vendosur si garanci pasi vlerat e kontratave të sipërmarrjes dhe kredisë e mundësonin këtë gjë, në vend që të bllokohej një pronë që kalon disa herë vlerën e apartamentit në Durrës. Gjithashtu, evidenton faktin se shërbimet në apartament janë regjistruar në emra të ndryshëm (uji dhe energjia elektrike në emër të babait, shërbime të tjera në emrin e tij)⁹⁰, çka tregon se në asnjë moment ai nuk është munduar ta prezantojë këtë pronë si të babait të tij, porse ka deklaruar se apartamenti është përdorur që nga fillimi dhe vazhdon të përdoret bashkërisht.

120. Për sa më sipër, në përfundim parashtron se kjo pasuri nuk është pasuri vetjake, por pasuri në bashkëpronësi me babain dhe nënën, me kontribut të përbashkët në vënien e saj, gëzim e posedim të përbashkët për gjithë kohën që nga viti 2009, si dhe se kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, të cilat mundësojnë plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së kësaj pasurie.

121. Në vijim të verifikimeve të prapësimeve të depozituara nga subjekti sa i përket rezultatit të analizës financiare të vitit 2008, që lidhet me mundësinë e krijimit të shumës 13,000 euro – evidentuar si gjendje në llogarinë bankare të subjektit në Alpha Bank, e më pas transferuar në favor të shoqërisë “A” sh.p.k., për likuidimin e kështit të parë të çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, Komisioni vëren se subjekti ka ngritur pretendime se për një udhëtim jashtë vendit të evidentuar për vitin 2008 (për periudhën 27.4.2008 – 7.5.2008) nuk ka kryer shpenzime, duke referuar se ka qenë për arsye pune dhe shpenzimet janë mbuluar nga organizatori prej të cilit ishte ftuar⁹¹, si dhe ka kërkuar që të reflektohen në analizën financiare të ardhurat e përfituara prej bashkëshortes së tij nga puna e kryer për vitin 2008, për të cilat me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës për të depozituar dokumentacion justifikues ligjor me qëllim provueshmërinë e

⁸⁹ Kontrata e hipotekës është administruar në dosjen e hetimit administrativ.

⁹⁰ Me dërgimin e prapësimeve ka depozituar kopje të dokumenteve: (i) librezë e operatorit OSHEE, Qendra Durrës, nr. kontrate ***, në emër të babait të tij G.H; (ii) librezë e operatorit Ujësjellës-Kanalizime D, nr. kontrate ***, në emër të babait të tij G.H; (iii) dy dokumente shërbimi televizioni dhe interneti nga operatori A., në emër të subjektit Juljan Haxhiu.

⁹¹ Në mbështetje të prapësimeve të tij ka depozituar si provë të re dokumentin në gjuhë të huaj (anglisht), nga ku duket se në listën pjesëmarrëse të një aktiviteti studimor të financuar nga Këshilli i Europës shfaqet edhe emri i subjektit të rivlerësimit si i ftuar në aktivitetin që do mbahej në datat 28.4.2008 – 30.4.2008.

pagesës së detyrimeve tatimore për të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur si punonjëse pranë Ambasadës së *** për vitet 2007 – 2010.

122. Kështu, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij, B.H, të ardhurat e së cilës janë deklaruar në deklaratat vjetore të pasurisë dhe në deklaratën *Vetting*, si person i lidhur, ka punuar pranë Ambasadës së *** në Tiranë (O.) nga data 4.3.2007 deri në datën 31.7.2019, duke evidentuar se siç është pasqyruar gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, për periudhën 4.3.2007 – 31. 12.2010, për pagat e marra si punonjëse në Ambasadën e *** nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat nga punësimi.

123. Subjekti argumenton se sipas jurisprudencës së konsoliduar të Komisionit dhe të Kolegjit duket se njohja e të ardhurave, për të cilat ka paqartësi apo kontestime në lidhje me pagesën e kontributeve apo detyrimeve tatimore, varet nga ekzistenca e disa faktorëve kumulativë, të cilët provojnë jo vetëm gjendjen juridike të faktit, por edhe dijeninë apo qëndrimin intelektual të personit në rrethana konkrete si: (1) natyrën e marrëdhënies së pretenduar që ka gjeneruar të ardhura; (2) provueshmërinë e krijimit të të ardhurave të pretenduara; (3) anën subjektive të personit të lidhur mbi pagesën ose jo të detyrimeve tatimore (dijenja dhe qëndrimi ndaj mungesës së pagesës).

123.1 Kështu, subjekti parashtron se marrëdhënia juridike e krijuar mes Ambasadës së *** dhe bashkëshortes së tij është një marrëdhënie pune e zakonshme, për të cilën janë paguar nga punëdhënësi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore⁹². Subjekti referon se, bazuar në atë jurisprudencë të paktë që gjykatat tona kanë krijuar në lidhje me dallimin e kontratës së punës nga marrëdhënie të tjera juridike⁹³, por edhe në jurisprudencën e vendeve me sisteme të ngjashme⁹⁴ ligjore, mund të thuhet se një person duhet të konsiderohet i punësuar me kontratë pune nëse është i lidhur në mënyrë të vazhdueshme me funksionin thelbësor të punëdhënësit, nëse hyn në kuadrin organizativ të tij dhe vepron nën urdhra dhe direktiva specifike, kushte të cilat referon se plotësohen në rastin e bashkëshortes së tij – duke qenë se ajo ka punuar për 12 vjet e ka qenë pjesë e strukturës organizative të punëdhënësit, Ambasadës së ***.

123.2 Në këto rrethana, në kushtet kur rezulton e provuar tejet çdo dyshimi të arsyeshëm se jemi para një marrëdhënieje pune, subjekti arsyeton se bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, tatimi mbi të ardhurat nga punësimi mbahet në burim nga punëdhënësi, i cili detyrohet të mbajë edhe regjistrat përkatës⁹⁵. Më tej, subjekti evidenton se ky parashikim nuk është ndryshuar asnjëherë që nga viti 1998, si dhe për më tepër ligji për procedurat tatimore⁹⁶ përmban sanksione për punëdhënësin që nuk mban, nuk deklaron dhe/ose nuk paguan në burim tatimin mbi të ardhurat nga punësimi. Subjekti

⁹² Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar si prova të reja disa vërtetime të lëshuara nga ISSH-ja, të cilat referojnë të dhëna mbi pagën bruto mbi të cilën është derdhur kontributi (sigurime shoqërore dhe shëndetësore) nga punëdhënësi, subjekti Ambasada e ***, në vitet 2007 – 2019, për punonjësen B.H (J), si vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 23.5.2024; vërtetim për bazën e vlerësueshme datë 16.5.2024; vërtetim për bazën e vlerësueshme nr. *** prot., datë 19.8.2019 etj.

⁹³ Vendim nr. ***, datë 7.2.2012, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

⁹⁴ P.sh. vendimet e Gjykatës Franceze të Kasacionit, 4.3.1983 dhe 17.4.1991; Vendimi i Gjykatës Italiane të Kasacionit nr. 4476, datë 21.3.2012.

⁹⁵ Në nenin 10 të ligjit “Mbledhja e tatimit” thuhet:

1. Çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës.

2. Të gjithë punëdhënësit mbajnë regjistrime të pagesave të specifikuara në shkronjën “a” të nenit 8 të këtij ligji, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

⁹⁶ Ligji nr. 8560, datë 22.12.1999, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

parashtron se këto ligje nuk përmbajnë përjashtime nga ky rregull dhe as sanksione për punëmarrësin që nuk paguan tatimin mbi të ardhurat nga punësimi.

123.3 Më tej, subjekti ka shpjeguar se me miratimin e ligjit nr. 20/2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili krijoi Deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), bashkëshortes së tij iu krijua një hapësirë për të zgjidhur më në fund këtë problem, i cili referon se ka qenë veçanërisht shqetësues për të pikërisht për shkak të faktit se në bazë të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, kishte detyrimin për të deklaruar pasurinë dhe interesat privatë si person i lidhur.

123.4 Duke u ndalur tek DIVA, subjekti argumenton se gjithsesi edhe për këtë periudhë (2011 e në vijim), detyrimi për të mbajtur, deklaruar dhe paguar tatimin mbi të ardhurat nga punësimi i takonte punëdhënësit, porse kjo deklaratë (DIVA) është përdorur nga bashkëshortja e tij në mungesë të zbatimit të këtij detyrimi, pasi, sipas subjektit, DIVA nuk ka qenë e krijuar për të paguar tatimin mbi të ardhurat personale nga marrëdhëniet e punësimit. Për këto arsye, subjekti deklaron se pagimi i tatimit mbi të ardhurat nga punësimi nëpërmjet DIVA-s (për periudhën pas vitit 2010) është një provë më tepër që tregon se bashkëshortja e tij nuk ka pasur asnjëherë qëllim të shmangë pagesën e detyrimeve tatimore, porse ky detyrim nuk kishte qenë i saj e nuk mund të përmbushej prej saj, duke u mbajtur në konsideratë se edhe gjatë të gjitha viteve që është paguar tatimi nëpërmjet DIVA-s kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kanë vazhduar të paguheshin nga punëdhënësi.

123.5 Në vijim të arsyetimit, pasi jep disa shembuj të llojit të të ardhurave të deklaruara në DIVA, mënyrën e deklarimit të tyre dhe pagesën e detyrimeve tatimore mbi to, si dhe situata problematike të hasura gjatë vetëdeklarimit të tatimit me DIVA, subjekti parashtron se është e qartë se kjo deklaratë nuk synonte pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, por vetëm deklarimin e tyre, me qëllim deklarimin kumulativ të të ardhurave mbi 2,000,000 lekë në vit. Megjithatë, referon se bashkëshortja e përdori atë për disa vjet për të paguar tatimin mbi të ardhurat e saj nga punësimi, në mungesë të një mjeti specifik për rastin e saj dhe se do të kishte bërë të njëjtën gjë në vitet 2007 – 2010 nëse do të kishte ekzistuar një mjet ekuivalent. Subjekti pretendon se ajo ka qenë një ndër personat e paktë, në mos e vetmja që ka kryer këto lloj pagesash me vullnet të lirë dhe se kjo rrethanë është e mjaftueshme për të provuar qëllimin e saj për të përmbushur me çdo mjet ligjor detyrimin e papërmbushur nga punëdhënësi.

123.6 Edhe sa i përket provueshmërisë së krijimit të të ardhurave të pretenduara, subjekti referon se Komisioni ka mbledhur tashmë prova që i evidentojnë ato në mënyrë të qartë, ku krahas deklarimit të tyre të rregullt në ILDKPKI provohet kalimi i tyre nëpërmjet sistemit bankar.

124. Si përfundim, subjekti parashtron se të gjitha veprimet e mësipërme janë kryer në kushtet kur marrëdhëniet e saj e punës ka qenë plotësisht e deklaruar në sistemin tatimor nëpërmjet pagesës për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, pagesat janë marrë krejtësisht nëpërmjet sistemit bankar dhe janë deklaruar rregullisht pranë ILKDKPI-së dhe asnjë nga institucionet shtetërore që ka administruar këtë veprimtari nuk ka konstatuar detyrime shtesë për t’u plotësuar nga ana e bashkëshortes. Referon se këto fakte janë provë shtesë për qëndrimin e tij se mbajtja e tatimit në burim nga punëdhënësi ka qenë një detyrim i tij, i cili, bazuar në kuadrin ligjor të zbatueshëm në atë kohë, por edhe në kuadrin ligjor aktual, nuk mund të zëvendësohet nga asnjë veprim apo pagesë e punëmarrësit.

125. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nisur nga natyra dhe pozicioni i punëdhënësit konkret në vendim tonë dhe faktin që marrëdhënia e punësimit ka përfunduar prej 5 vjetësh, nuk mund të pretendojë të marrë informacion lidhur me arsyet e mosdeklarimit dhe mbajtjes së tatimit në burim.

126. Bazuar në argumentet dhe provat e mësipërme, subjekti pretendon se arrin të plotësojë standardin për barrën e provës së vendosur nga Komisioni, duke provuar se bashkëshortja si person i lidhur ka krijuar si pasojë e një marrëdhënieje punësimi të ligjshme, të njohur nga institucionet përkatëse të administrimit të marrëdhënieve të punësimit dhe detyrimeve tatimore, të ardhura të ligjshme, për të cilat ligji detyron punëdhënësin të mbajë në burim tatimin mbi të ardhurat, dhe se, me gjithë përpjekjet e saj, nuk ka ekzistuar një mënyrë alternative e pagesës së tatimit e për të cilat administrata tatimore nuk e konsideron debitore⁹⁷. Për rrjedhojë, subjekti parashtron se, duke qenë të ligjshme, këto të ardhura duhet të përfshihen në analizën financiare si të mundshme për krijimin e pasurive dhe/apo mbulimin e shpenzimeve sipas shumave përkatëse të provuara si të kredituara nga punëdhënësi në llogarinë bankare të bashkëshortes së tij, të ndara në vite dhe në vlera, si vijon: (i) për vitin 2007, shuma 1,682,427 lekë; (ii) për vitin 2008, shuma 2,175,867 lekë; (iii) për vitin 2009, shuma 2,640,089 lekë; (iv) për vitin 2010, shuma 3,047,349 lekë.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

127. Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara gjatë hetimit administrativ dhe prapësimet e provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, trupi gjykues krijoi bindjen se sa i përket apartamentit të ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës, kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët të subjektit dhe babait të tij (prindërve të tij), në krijimin e së cilës kanë kontribuar bashkërisht.

128. Kështu, sa i përket krijimit të shumës prej 13,000 euro në llogarinë bankare të subjektit të Alpha Bank, vlerë e cila rezulton në datën 6.1.2009, është transferuar në favor të shoqërisë "A" sh.p.k. si pagesë për likuidimin e çmimit të parë të pasurisë objekt vlerësimi, pas shqyrtimit të prapësimeve të subjektit dhe dokumentacionit bankar të administruar në dosje, Komisioni vëren se:

128.1 Në datën 29.12.2008, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaria e tij në Bankën Kombëtare Tregtare (BKT)⁹⁸ shumën prej 558,471 lekësh, e cila përfaqëson gjendjen e krijuar në këtë llogari nga akumulimi i pagave të tij.

128.2 Në datën 29.12.2008, nëna e subjektit ka tërhequr nga llogaria e saj në Raiffeisen Bank⁹⁹ shumën prej 200,000 lekësh. Nga verifikimi i kësaj llogarie rezulton se kemi të bëjmë me llogari page të hapur prej nënës së subjektit që në vitin 2005, në të cilën i është kredituar paga prej datës 4.7.2005 e në vijim. Rezultoi se gjendja e kësaj llogarie e krijuar nga akumulimi i pagave deri në datën 29.12.2008 (para tërheqjes së shumës prej 200,000 lekë) ka qenë në vlerën 209,096 lekë.

⁹⁷ Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar si provë të re, shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. *** prot., datë 29.5.2024.

⁹⁸ Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 19.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.2.2021).

⁹⁹ Shkresë e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 9.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. ***, datë 9.2.2021).

128.3 Në datën 30.12.2008, babai i subjekti ka tërhequr nga llogaria e tij depozitë në ProCredit Bank¹⁰⁰ shumën prej 292,500 lekësh. Nga verifikimi i lëvizjeve të kësaj llogarie rezultoi se ajo është hapur që në vitin 2002, e në vijim ka pasur depozitime vlerash monetare në vitet 2004 e 2007, ku pas përfitimit edhe të disa interesave bankarë është krijuar gjendja prej 292,500 lekësh, e tërhequr nga babai i subjektit në datën 30.12.2008.

128.4 Në datën 30.12.2008, babai i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij depozitë në Alpha Bank¹⁰¹ (llogari e cila rezulton e hapur që në vitin 2006 dhe ka pasur depozitime vlerash në vitin 2008) shumën prej 297,740 lekësh.

128.5 Në vijim, rezulton se në datën 30.12.2008 subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në llogarinë e tij në Alpha Bank shumën prej 13,000 euro, për të cilën e referon se ka pasur si burim pikërisht këto tërheqje të kryera nga llogaritë bankare të tij dhe prindërve të tij, si dhe kursime të tjera të tij në gjendje *cash* nga të ardhurat vjetore, e më tej ka deklaruar se ka shërbyer për likuidimin e kështit të parë të çmimit të blerjes së apartamentit në Durrës.

129. Në vlerësim të këtyre rrethanave në raport me deklaratimet e bëra në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI dhe gjatë hetimit administrativ, Komisioni krijoi bindjen se në krijimin e shumës 13,000 euro, gjendje në llogarinë bankare të subjektit në Alpha Bank në fund të vitit 2008, kanë shërbyer shumat e tërhequra prej tij dhe prindërve të tij nga llogaritë e tyre bankare, si dhe kursime të tjera në gjendje *cash* nga të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur gjatë këtij viti. Thënë më thjesht, pas pakësimit të vlerave të katër llogarive bankare është krijuar një vlerë e vetme në një llogari bankare - me burim pikërisht vlerat e tërhequra prej këtyre llogarive dhe kursime të tjera të subjektit, me qëllim kryerjen e pagesës së kështit të parë për likuidimin e çmimit të apartamentit në Durrës.

129.1 Në këtë kontekst, në analizën financiare të vitit 2008, vlerat e tërhequra nga prindërit e subjektit nga llogaritë e tyre do të reflektohen si të ardhura të mundshme për krijimin e shumës 13,000 euro në llogarinë bankare të subjektit në Alpha Bank.

130. Në rezultatin financiar të vitit 2008 – vit në të cilin është krijuar depozita prej 13,000 euro, por edhe për periudhën 1.1.2009 deri në 13 shkurt 2009 – moment në të cilin është kryer pagesa e kështit të dytë për likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi, rëndësi merr vlerësimi përfundimtar i të ardhurave të pretenduara dhe deklaruara nga personi i lidhur si të përfituara nga puna e saj në Ambasadën e *** në Shqipëri, të cilat paraprakisht nuk u reflektuan në analizën financiare për vitet 2007 – 2010.

131. Pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit shkresor të administruar në dosje, trupi gjykues krijoi bindjen se personi i lidhur ka qenë në një marrëdhënie punësimi me Ambasadën e *** në Shqipëri, pasi që prej muajit mars 2007 e në vijim kjo ambasadë, e pajisur me NUIS ***, në cilësinë e punëdhënësit ka deklaruar dhe paguar kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore për punëmarrësin B.H (J), fakt që është i mjaftueshëm në optikën e Komisionit për të vërtetuar se ndodhemi përpara ekzistencës së një marrëdhënieje punësimi. Por, nga ana tjetër, Komisioni vërejti se për periudhën 2007 – 2010 nuk është paguar tatimi mbi të ardhurat nga punësimi për këtë punëmarrëse. Ndërsa,

¹⁰⁰ Shkresa e ProCredit Bank nr. *** prot., datë 11.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. ***, datë 11.2.2021).

¹⁰¹ Shkresa e OTP Bank (Banka përthithëse/blerëse e Alpha Bank) nr. *** prot., datë 31.1.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** datë 31.1.2024).

për vitet 2011 e në vijim ky tatim është paguar vullnetarisht nga personi i lidhur nëpërmjet deklaratës individuale të të ardhurave (DIVA).

131.1 Në nenin D/3 të Aneksit të Kushtetutës, ndër të tjera përcaktohet se pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, si dhe se elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. Ndërsa në pikën 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: *“Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara nga ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”.*

131.2 Në nenin 4 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me titull “Burimi i të ardhurave”, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to, dhe një nga kategoritë e këtyre të ardhurave janë të ardhurat e parashikuara në shkronjën a) Të ardhurat nga marrëdhënia e punës së ushtruar në Republikën e Shqipërisë.

131.3 Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat për kategoritë e të ardhurave personale shtrihet mbi të ardhurat e individëve (neni 6 i ligjit nr. 8438/1998), të cilët janë rezidentë në kuptim të Kodit Civil dhe në kuptim të nenit 7 të ligjit të sipërcituar, i nënshtrohen detyrimit për tatimin mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.

131.4 Për sa më sipër, si dhe bazuar në parashikimet e nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se të ardhurat e referuara si të përfituara nga personi i lidhur në funksion të marrëdhënies së punës me Ambasadën e ***-së janë të ardhura të tatueshme.

131.5 Referuar nenit 10 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në shkronjën “a” të nenit 8 të këtij ligji, mban tatimin mbi të ardhurat personale, në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të këtij ligji dhe e derdh tatimin e mbajtur në favor të organeve tatimore jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Në vijim, në këtë dispozitë parashikohet se të gjithë punëdhënësit dhe personat e vetëpunësuar janë të detyruar të deklarojnë tatimin mbi të ardhurat vetjake, të mbajtur në burim për punëmarrësit.

131.6 Edhe në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, parashikohet: *“Çdo punëdhënës që paguan një pagë a shpërblim të parashikuar në shkronjën ‘a’ të nenit 8 të ligjit, është i detyruar të llogarisë dhe të mbajë në burim tatimin mbi të ardhurat personale (të ardhurat nga punësimi) në përputhje me paragrafin e parë të nenit 9 të ligjit. Tatimi i mbajtur nga punëdhënësi duhet të derdhet në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit pasardhës të kryerjes së pagesës. Deklarimi dhe pagesa e këtij tatimi do të bëhet duke përdorur “Formularin e deklarimit dhe pagesës të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi” (me ndryshimet e bëra është përcaktuar “Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi”), që i bashkëngjitet këtij udhëzimi. Kjo deklaratë paraqitet në Bankën ku kryhet pagesa dhe, pas kryerjes së pagesës, dërgohet në organin tatimor.*

131.7 Nga analizimi në harmoni i dispozitave të mësipërme rezulton se detyrimi për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga paga i takon punëdhënësit, i cili e pasqyron atë në formularët përkatës dhe kryen pagesën në favor të organit tatimor.

131.8 Megjithëse nga tërësia e kësaj marrëdhënieje punësimi dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e hetimit mund të supozohet se personi i lidhur ka qenë në dijeni se punëdhënësi, Ambasada e ***, nuk do të paguante në burim detyrimet tatimore, por vetëm sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe se ka rënë dakord me këtë fakt, Komisioni vlerëson se kjo marrëveshje nuk mund të qëndrojë e as të zbatohet, duke qenë se legjislacioni fiskal shqiptar nuk lejon që t'i kalohet/ngarkohet punëmarrësit detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, pasi këtë përgjegjësi ligji ia ka ngarkuar ekskluzivisht punëdhënësit, i cili në këtë rast luan rolin e agjentit tatimor dhe madje sanksionohet me penalitete në rast të mospërbushjes së këtij detyrimi.

131.9 Në këtë kontekst, Komisioni vlerëson se ka qenë detyrim i punëdhënësit (Ambasadës së ***-së) mbajtja, deklarimi dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat për punëmarrësin B.H (J).

131.10 Nga ana tjetër, Komisioni vëren se, pavarësisht se nuk kishte pasur asnjë sanksion nga administrata tatimore dhe, në fakt, në kushtet e mungesës së bazës ligjore për sanksione të tilla për punëmarrësit në situatën e personit të lidhur, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 20/2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili krijoi Deklaratën individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), bashkëshortja e subjektit ka gjetur një mjet për të deklaruar e paguar tatimin mbi të ardhurat personale të pagës së saj, pasi ishte në dijeni për mospagimin e tyre nga punëdhënësi. Subjekti dhe personi i lidhur kanë shpjeguar në detaje se edhe gjatë periudhës së pagimit të detyrimeve tatimore nëpërmjet DIVA-s, kanë vlerësuar se kjo deklaratë nuk ka si funksion të saj pagesën e të ardhurave nga punësimi, por vetëm deklarimin e tyre së bashku me të ardhurat totale që shkojnë mbi 2,000,000 lekë, duke supozuar se tatimi është mbajtur, deklaruar e paguar nga punëdhënësi. Kjo rrethanë, e pranuar si bindëse nga Komisioni, tregon qasjen e personit të lidhur në raport me zbatimin e ligjit, aq më shumë kur bëhet fjalë për një detyrim që nuk i takonte asaj për ta përmbushur, por punëdhënësit. Komisioni gjen bindëse analizën ligjore të subjektit dhe personit të lidhur mbi mungesën e një mjeti ekuivalent me DIVA-n për periudhën para hyrjes në fuqi të saj, pasi formularët e vetëdeklarimit të tatimeve para vitit 2011 e përjashtonin në mënyrë të shprehur pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi. Pra, edhe në kushtet e dijenisë në lidhje me mospagimin e tatimit mbi të ardhurat nga paga prej punëdhënësit, duket se ka qenë e pamundur prej personit të lidhur kryerja e kësaj pagese. Në mungesë të ndërhyrjes së administratës tatimore për të rregulluar këtë situatë, Komisioni vlerëson se personi i lidhur ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të përmbushur detyrimet tatimore, bazuar në një gjykim e njohje mesatare të ligjit, dhe vlerëson se ajo nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi për ndërmarrjen e veprimeve të tjera në këtë drejtim, çka mund të passillte rivlerësime tatimore dhe penalitete ndaj punëdhënësit e, për rrjedhojë, të reflektonte në marrëdhënien e punësimit.

132. Për sa u argumentua më sipër, në kushtet kur kemi të bëjmë me të ardhura të përfituara nga një burim i ligjshëm në Republikën e Shqipërisë – marrëdhënie punësimi ku punëmarrësi është deklaruar nga punëdhënësi për efekt të pagesës së sigurimeve shoqërore

e shëndetësore dhe për të cilat detyrimi për pagesën e tatimit mbi të ardhurat i takon punëdhënësit, si dhe në konsideratë të faktit se dokumentohet plotësisht kalimi i tyre nëpërmjet sistemit bankar, trupi gjykues vlerësoi të përfshijë në analizën financiare edhe të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur nga marrëdhënia e punës me Ambasadën e *** për periudhën 2007 – 2010.

133. Pas kryerjes së analizës financiare përfundimtare për vitin 2008, rezulton se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pasuritë e krijuara (ku përfshihet depozita në Alpha Bank në shumën 13,000 euro), si dhe shpenzimet e deklaruara/evidentuara për këtë vit¹⁰². Për më tepër, në referim të kësaj analize, Komisioni vëren se edhe nëse shumat e tërhequra nga prindërit e subjektit në datat 29 – 30.12.2008 nuk do të merren si burim për krijimin e depozitës 13,000 euro në llogarinë e subjektit në Alpha Bank, sërish analiza financiare e vitit 2008 do të paraqitej me balancë pozitive fondesh. Në këtë kontekst, mosdeklarimi i kësaj depozite nga ana e subjektit në fund të vitit 2008, e pashoqëruar me mungesën e burimeve financiare për krijimin e saj, do të konsiderohet si pasaktësi që nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimit kalimtar.

134. Bazuar në analizën financiare të vitit 2008, trupi gjykues arrin në konkluzionin se familja e subjektit (subjekti/personi i lidhur/prindërit e subjektit) ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme, që mundësonin plotësisht pagesën e shumës 13,000 euro në datën 6.1.2009 për likuidimin e kështit të parë të pasurisë objekt vlerësimi.

135. Sa i përket analizës financiare për periudhën 1.1.2009 – 13.2.2009, krahas përfshirjes së të ardhurave të bashkëshortes nga puna e saj në Ambasadën e *** për periudhën në fjalë, Komisioni reflektoi ndryshimin në kursin e këmbimit në momentin e kryerjes së pagesës, duke gjetur të drejtë pretendimin e subjektit, si dhe heqjen e shpenzimit për një udhëtim të bërë nga subjekti e personi i lidhur në këtë periudhë, pasi dokumentohet se mbulimi i tij është bërë me fonde të organizatorit të aktivitetit (OJF), aktivitet i cili duket se lidhet me profilin e punës së tyre. Gjithashtu, në kushtet kur nga tërësia e rrethanave/transaksioneve të evidentuara në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, Komisioni krijoi bindjen se kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët të subjektit me prindërit e tij, që për efekt analize do të reflektohet si e ardhur e mundshme në pagesën e kryer deri më 13.2.2009 për likuidimin e çmimit së saj edhe shuma 340,000 lekë, e tërhequr në datën 9.1.2009 nga llogaria e babait të subjektit në ProCredit Bank.

136. Bazuar në analizën e mësipërme, deklaratimet e bëra, dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vlerësim objektiv të prapësimeve e provave të referuara/depozituara nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën financiare përfundimtare me qëllim evidentimin e mundësisë së familjes së subjektit (subjekti/personi i lidhur/prindërit e subjektit) për kryerjen e pagesës në favor të shoqërisë “A” sh.p.k. për likuidimin e dy kësteve të para për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi (regjistruar në emër të babait), të paraqitur në tabelën si më poshtë:

¹⁰² Referojuni tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

Tabela nr. 6

Analiza e treguesve financiarë për periudhën 1.1.2009 - 13.2.2009	Vlerat në Lek
A) Pasuri	2 517 199
Apartament me sip. 58 m ² , ndodhur në Lagjen ***, ***, Durrës	4 162 565
Ndryshim likuiditeti	-1 645 366
B) Detyrime	2 000 000
Kredia e disbursuar në datën 12.2.2009 Alpha Bank (2,000,000 lekë)	2 000 000
C) Pasuri neto (A-B)	517 199
D) Të ardhura	691 499
Të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit	67 991
Të ardhurat nga paga e bashkëshortes B.H	283 508
Nga kursimet e prindërve (tërhequr nga babai dt. 9.1.2009 P.Credit Bank)	340 000
E) Shpenzime	302 000
Shpenzime jetike	32 190
Shpenzime kredia nr. ***, datë 20.7.2006, Alpha Bank (1,900,000 lekë)	97 590
Shpenzime kredia nr. ***, datë 12.2.2009, Alpha Bank (2,000,000 lekë)	20 200
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë BKT Bank	152 020
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	0
Balanca e fondeve (D-C-E)	- 127 700

137. Sa më sipër, Komisioni konstaton se familja e subjektit (subjekti/personi i lidhur/prindërit e subjektit) ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer deri në datën 13.2.2009 në favor të shoqërisë “A” sh.p.k. për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, porse në përputhje edhe me jurisprudencën e Kolegjit¹⁰³ nga trupi gjykues u konkludua se kjo balancë negative fondesh nuk është e tillë për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

137.1 Në vijim të arsytimit, trupi gjykues vlerëson se balanca negative e rezultuar nga analiza financiare është relativisht e vogël në raport me investimin total të kryer nga subjekti dhe familja e tij për pasurinë objekt vlerësimi, duke pasur parasysh këtu se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, pasi, për shkak të kohës së kaluar dhe mënyrës së kryerjes së analizës, mund të paraqitet edhe një shkallë e caktuar pasaktësie në elementet që ajo vlerëson. Në këtë kontekst, duke qenë një balancë negative relativisht e vogël, ajo nuk arrin nivelin e cenimit të publikut dhe as nuk ngre dyshime të qenësishme mbi mundësitë financiare të subjektit dhe familjarëve të tij për likuidimin e çmimit të plotë të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes, duke evidentuar këtu faktin se kemi të bëjmë me një pasuri të përbashkët të subjektit me prindërit e tij, për të cilën subjekti ka referuar dhe provuar burimet e krijimit.

137.2 Për më tepër, vlen të evidentohet këtu se subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se prindërit e tij kanë pasur kursime likuiditetesh në gjendje *cash*, të cilat i kanë përdorur në funksion të pagesës së kryer në datën 13.2.2009, për shoqërinë “A” sh.p.k., porse, në mungesë të kryerjes së një analize objektive, Komisioni nuk e reflektoi këtë pretendim të subjektit në analizën financiare të kryer.

138. Pasuria e llojit likuiditet, llogari e përbashkët bankare e subjektit dhe personit të lidhur (plan kursimesh) në Intesa Sanpaolo Bank, me gjendje në datën 6.1.2017 në vlerën prej 1,247,000 lekësh. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga pagat.

¹⁰³ Referojuni qëndrimit të mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimin nr. 38/2021 (JR).

139. Deklarimi i kësaj pasurie në vite

Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, sa u përket deklaratimeve të bëra për pasurinë objekt vlerësimi Komisioni konstaton se:

139.1 Në DIPP-në e vitit 2010, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit), ndër të tjera, ka deklaruar hapjen e një plani kursimesh, krijuar në datën 9.12.2010, me vlerë 5,000 lekë, në Intesa Sanpaolo Bank.

139.2 Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar marrjen e 50% të të drejtave mbi llogarinë e kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank së bashku me bashkëshorten dhe se gjendja e saj në datën 31.12.2011 është në vlerën 157,203 lekë. Gjithashtu, konstatohet se personi i lidhur ka bërë të njëjtin deklaram në DIPP-në e vitit 2011.

139.3 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar zotërimin e 50% të planit të kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2012 është në vlerën 395,454 lekë. Gjithashtu, konstatohet se personi i lidhur ka bërë të njëjtin deklaram në DIPP-në e vitit 2011.

139.4 Në DIPP-në e vitit 2013, subjekti ka deklaruar zotërimin e 50% të planit të kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2013 është në vlerën 745,756 lekë. Gjithashtu, konstatohet se personi i lidhur ka bërë të njëjtin deklaram në DIPP-në e vitit 2013.

139.5 Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti ka deklaruar zotërimin e 50% të planit të kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2014 është në vlerën 976,782 lekë. Gjithashtu, konstatohet se personi i lidhur ka bërë të njëjtin deklaram në DIPP-në e vitit 2014.

139.6 Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar zotërimin e 50% të planit të kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2015 është në vlerën 1,090,143 lekë.

139.7 Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar zotërimin e 50% të planit të kursimeve pranë Intesa Sanpaolo Bank dhe se gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 është në vlerën 1,274,000 lekë.

140. Konkluzioni i ILDKPKI-së mbi këtë pasuri: Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjen e Intesa Sanpaolo Bank.

141. Hetimi/verifikimet i/e kryer/a nga Komisioni lidhur me këtë pasuri: Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të dërguar nga Intesa Sanpaolo Bank¹⁰⁴, rezulton se në datën 9.12.2010, në llogarinë për plan kursimi të subjektit dhe personit të lidhur, në monedhën lekë (nr. llogarisë ***), kreditohet shuma prej 5,000 lekësh me përshkrimin “*B.J/trfr to saving plan lek*”. Në vijim, për periudhën 2011 – 2016, rezulton se personi i lidhur ka transferuar në periodicitet 1-mujor nga llogaria e saj e pagës¹⁰⁵ te kjo llogari plan kursimi shuma të ndryshme – duke filluar nga 15,000 lekë muaj deri në 50,000 lekë/muaj dhe, për rrjedhojë, gjendja e planit të kursimit në datën 31.12.2016 ka shkuar në shumën 1,274,033 lekë.

¹⁰⁴ Shkresa e ISP Bank nr. *** prot., datë 17.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.2.2021).

¹⁰⁵ Llogaria nr. *** në ISP Bank. Personi i lidhur për periudhën mars 2007 – dhjetor 2016 rezulton se ka qenë e punësuar në Ambasadën *** në Shqipëri, pranë O. në Departamentin e Drejtësisë, në pozicionin e specialistit ligjor dhe se paga i ka kaluar pikërisht në këtë llogari bankare.

142. Komisioni konstaton se në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar në ILDKPKI, që u përkasin viteve 2010 – 2016, subjekti ka deklaruar saktë gjendjen e llogarisë plan kursimi në fund të çdo viti.

143. Gjithashtu, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e pasurisë objekt vlerësimi, plan kursimi në Intesa Sanpaolo Bank.

144. Llogari të tjera bankare: Rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar edhe disa llogari të tjera bankare si vijon: (i) llogari rrjedhëse në BKT, me gjendje në datën 6.1.2017 në shumën prej 13,801 lekësh; (ii) llogari rrjedhëse në Credins Bank me gjendje në datën 5.1.2017 në shumën prej 1,080 lekësh; (iii) llogari rrjedhëse në Alpha Bank me gjendje në datën 6.1.2017 në shumën 10 euro; (iv) llogari rrjedhëse në Alpha Bank me gjendje në datën 6.1.2017 në shumën 0 lekë; (v) llogari rrjedhëse në ISP Bank me gjendje në datën 6.1.2017 në shumën 0 lekë.

145. Pas verifikimit të dokumentacionit bankar të administruar në dosjen e hetimit, Komisioni konstaton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë të dhënat mbi gjendjen e këtyre llogarive bankare.

146. Pasuria e llojit automjet e tipit “**”,** blerë nga babai G.H, përdorur edhe nga subjekti dhe bashkëshortja e tij B.H, me vlerë 400,000 lekë.

147. Komisioni konstaton se në përgjigjet e pyetësorit standard nr. 1 të dërguar nga Komisioni, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...Kam një autorizim për përdorimin e automjetit V me targë ***, i cili është blerë nga babai G.H. Këtë automjet e kam përdorur unë dhe bashkëshortja”.

148. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. ***, i pyetur mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: “Ky automjet, i cili është automjeti i vetëm në pronësi dhe përdorim në familje që nga viti 2014, është blerë me kursime familjare. Pagesa është bërë me para në dorë dhe kemi pasur të ardhura dhe gjendje të mjaftueshme cash për ta bërë këtë pagesë”.

149. Nga verifikimi i dokumentacionit shkresor të administruar në dosje lidhur me këtë pasuri¹⁰⁶, Komisioni konstaton se: (i) Në datën 23.7.2013, ky automjet është çregjistruar në vendin e origjinës – Itali nga pronari i mjetit F.RR; (ii) Në datën 28.8.2013, shtetasi A.L e ka blerë këtë automjet kundrejt çmimit 1,000 euro nga shtetasi F.RR; (iii) Në datën 28.8.2013 janë kryer procedurat e zhdoganimit të këtij automjeti duke u paguar detyrimi doganor në shumën 217,014 lekë. Vërehet se vlera statistikore e kësaj pasurie për efekt të pagesës së detyrimeve doganore është shënuar nga autoritetet në shumën prej 1,085,077 lekësh; (iv) Në datën 29.8.2013, shtetasi A.L është pajisur me certifikatën e pronësisë për këtë automjet, duke e targuar ***; (v) Në datën 3.2.2014, shtetasi G.H e ka blerë këtë automjet¹⁰⁷ kundrejt çmimit prej 400,000 lekësh nga shtetasi A.L, e, në vijim, i ka ndryshuar targat këtij automjeti në ***.

150. Rezulton se në datën 6.2.2014 z. G.H ka nënshkruar një prokurë të posaçme¹⁰⁸, në referim të së cilës autorizon subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij ta huapërdorin këtë automjet brenda dhe jashtë vendit për një afat të pacaktuar për përdorim vetjak.

¹⁰⁶ Dokumentacioni i përcjellë me shkresën e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 2.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 4.2.2021).

¹⁰⁷ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.2.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

¹⁰⁸ Dokumenti noterial “Prokurë e Posaçme” nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. E.K.

151. Nga informacioni i përfituar prej burimeve të hapura, si dhe pas verifikimit të bërë në faqen zyrtare të *web-it* të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit të bizneseve (QKR), duket se shtetasi A.L, i cili shfaqet si shitësi i automjetit në favor të babait të subjekti, është me profesion avokat dhe se e ka zhvilluar këtë aktivitet privat i regjistruar me adresë ushtrimi aktiviteti në qytetin e Lezhës, qytet në të cilin subjekti ka ushtruar më parë detyrën e gjyqtarit.

152. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni kreu verifikime¹⁰⁹ mbi rrethana të mundshme të konfliktit të interesit dhe/apo papajtueshmërisë në të cilat mund të gjendej subjekti i rivlerësimit në raport me shtetasin A.L, nga ku rezultoi se: (i) Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë¹¹⁰ ka konfirmuar se për periudhën 1.9.2007 – 1.11.2011 (periudhë gjatë së cilës subjekti ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë dhe Lezhë) nuk ka pasur çështje civile/penale që të lidhen me shtetasin e sipërcituar; (ii) nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹¹¹ rezulton se për periudhën 2002 – 2003 dhe 2011 e në vijim (periudhë në të cilën subjekti ka ushtruar funksionin si gjyqtar pranë kësaj gjykate) nuk ka pasur çështje civile/penale që të lidhen me këtë shtetas.

152.1 Gjithashtu, Komisioni u kërkoi gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Lezhë¹¹² të informojnë nëse subjekti i rivlerësimit, gjyqtari Juljan Haxhiu, për periudhën që ka qenë gjyqtar pranë këtyre gjykatave, ka gjykuar çështje civile/penale apo nëse ka shqyrtuar kërkesa të veçanta, ku si avokat/mbrojtës ligjor i palëve të ketë qenë shtetasi A.L (qoftë edhe i caktuar kryesisht nga gjykata).

152.2 Në informacionin e dërguar, këto gjykata referojnë se është i pamundur identifikimi në lidhje me pjesëmarrjen e avokatit/mbrojtësit ligjor në çështjet gjyqësore civile apo penale, pasi verifikimi në sistem bëhet në emër të palëve/ankuesit/kërkuesit/personit nën hetim/nr. procedimi penal dhe se nuk jepet mundësi e kërkimit me avokat/përfaqësues ligjor¹¹³.

153. Gjithsesi, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë mbi marrëdhënien e tij me shtetasin A.L, konkretisht nëse ka pasur lidhje për shkak të detyrës me këtë shtetas. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të konfirmojë nëse ka pasur në ndjekje/hetim/gjykim materiale/çështje, ku si paditës/i paditur/palë kallëzuese/i kallëzuar/i pandehur/i dëmtuar etj., apo si përfaqësues ligjor i palëve (avokat) të shfaqet shtetasi A.L (qoftë edhe për ndonjë material që lidhet me kërkesa të veçanta).

154. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe shpjegimeve të dhëna gjatë seancës dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se A.L nuk e njeh për shkak të detyrës. Në vijim evidenton faktin se ky shtetas e ka filluar ushtrimin e profesionit të avokatit në vitin 2013 dhe që nga kjo kohë e ushtron këtë profesion me seli në qytetin e

¹⁰⁹ Shkresat e Komisionit nr. *** prot. dhe *** prot., datë 17.10.2023, drejtuar gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit Tiranë dhe Lezhë.

¹¹⁰ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nr. *** prot., datë 2.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.11.2023).

¹¹¹ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. *** prot., datë 22.11.2023 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 22.11.2023).

¹¹² Shkresat e Komisionit nr. *** prot. dhe 1210 prot., datë 2.5.2024.

¹¹³ Referojuni shkresave: (i) Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë nr. *** prot., datë 10.5.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.5.2024); (ii) Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. *** prot., datë 13.5.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 14.5.2024).

Lezhës¹¹⁴, ndërkohë që ai vetë është transferuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vitin 2011.

154.1 Nga ana tjetër, subjekti ka sqaruar se marrëdhënia shoqërore me shtetasin A.L bazohet kryesisht në angazhimin e përbashkët akademik që bashkëshortja e tij ka krijuar me të gjatë viteve, duke qenë se z. L është pedagog prej shumë vitesh e, po ashtu, bashkëshortja e tij ka pasur aktivitet të vazhdueshëm akademik e në mësimdhënie, duke referuar e paraqitur si prova lidhjet e dy artikujve që ata kanë botuar së bashku¹¹⁵.

155. Mbështetur në sa më sipër, subjekti referon se ka arritur të provojë se shitësin A.L nuk e njeh për shkak të detyrës dhe gjithashtu deklaron se nuk ka pasur me të marrëdhënie juridiko – civile që të jenë ndikuar nga detyrat e ushtruara prej secilit.

156. Pasi vlerësoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje në raport me deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, shpjegimet dhe provat e depozituara pas dërgimit të rezultateve të hetimit, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, Komisioni arrin në përfundimin se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* subjekti ka deklaruar saktë këtë pasuri në përdorim, si dhe nuk ka dyshime të tjera në lidhje me mënyrën e përfitimit të saj nga personi tjetër i lidhur, babai i subjektit.

157. Pasuria e llojit likuiditet në gjendje *cash* në shumën prej 500,000 lekësh, deklaruar me burim krijimi kursimet personale.

158. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë/periodikë vjetorë të depozituar ndër vite nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, sa u përket deklaratimeve të bëra mbi shtesat/pakësimet/gjendjet e likuiditeteve *cash*, Komisioni konstaton se: (i) Në DIPP-në e vitit 2013 ka deklaruar para në dorë në shumën 700,000 lekë; (ii) Në DIPP-në e vitit 2014 ka deklaruar lekë në dorë (*cash*) në shumën 1,000,000 lekë; (iii) Në DIPP-në e vitit 2015 ka deklaruar lekë në dorë (*cash*) në datën 31.12.2015 shumën 1,200,000 lekë; (iv) Në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar lekë në dorë (*cash*) në datën 31.12.2016 shumën 500,000 lekë.

159. Bazuar në vetëdeklarimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI mbi gjendjen e likuiditeteve *cash* ndër vite, duket se ecuria e gjendjes së kursimeve në formë likuiditetesh *cash*, nga DIPP-ja e vitit 2013 deri në DIPP-në e vitit 2016, paraqitet e pasqyruar në tabelën si më poshtë:

¹¹⁴ Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar si prova: (i) certifikatë nëpërmjet së cilës vërtetohet se shtetasi A.L ka fituar titullin “Avokat” me nr. licence ***, datë 2.11.2012, konfirmuar me dokumentin noterial “Vërtetim njësie me origjinalin” nr. *** rep., datë 17.5.2024, redaktuar nga noteri publik, znj. M.D; (ii) kopje të ekstraktit historik të regjistrimit tregtar për subjektin “A.L” person fizik, me datë regjistrimi 3.5.2013, me fushë të veprimtarisë avokat/ndërmjetës dhe vend ushtrim aktiviteti (seli) në Lezhë.

¹¹⁵ <https://www.iiis.org>***

dhe https://ijbssnet.com/view.php?u=https://www.***

Tabela nr. 7

Analizë e ecurisë së shtesave / pakësimeve dhe gjendjes së likuiditeteve <i>cash</i> sipas deklarimeve periodike të subjektit dhe personit të lidhur (Vlerat në Lek)			
Viti	Shtesë	Pakësim	Gjendje
DIPP 2013	0	0	700,000
DIPP 2014	0	0	1,000,000
DIPP 2015	0	0	1,200,000
DIPP 2016	0	0	500,000
Deklaruar në <i>Vetting</i> më 25.1.2017			500,000

❖ ÇËSHTJE TË TJERA

160. Pasuria e llojit tokë arë e familjes së personit të lidhur – Nga hetimi administrativ u administrua dokumenti “Prokurë e posaçme”, datë 23.5.2014¹¹⁶, nënshkruar nga personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit, znj. B.H), nëna dhe vëllai i saj (S.J dhe B.J). Referuar këtij dokumenti, shtetasit e sipërcituar emërojnë si përfaqësues ligjor të posaçëm z. LL.J (babain e bashkëshortes së subjektit), të cilit i japin të drejta dhe kompetenca të plota që në emër dhe për llogari të tyre të kryejë të gjitha veprimet juridike, administrative dhe ligjore në lidhje me shitjen e pjesëve të tyre takuese në pasurinë e paluajtshme arë, pasuri e familjes bujqësore, regjistruar në ZVRPP-në Gjirokastër në zonën kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, numër pasurie ***, e ndodhur në fshatin V, Gjirokastër, me sipërfaqe 6,800 m², regjistruar në emër të shtetasit LL.Z.J.

161. Nga verifikimi i deklaratave të interesave privatë të depozituar nga bashkëshortja e subjektit, znj. B.H (J), në cilësinë e subjektit deklarues në ILDKPKI, për vitet 2003 dhe 2004, si dhe i deklaratave të bëra në cilësinë e personit të lidhur që mbart detyrimin për deklarim, prej vitit 2008 e në vijim, nuk rezulton që të jetë deklaruar kjo pasuri, të drejtat reale mbi të dhe pjesa takuese që zotëronte. Gjithashtu, edhe në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* nuk rezulton të jenë deklaruar të dhëna lidhur me këtë pasuri.

162. Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të deklarojë për periudhën dhe mënyrën e fitimit të kësaj pasurie nga personi i lidhur dhe familjarët e saj, si dhe të specifikojë burimin konkret të krijimit të saj. Gjithashtu, subjektit iu kërkuar të depozitohet dokumentacionin e plotë tekniko–ligjor të kësaj pasurie, duke evidentuar nëse ka pasur investime të kryera mbi të, e nëse po, vlerën e investimit dhe burimin e krijimit, dhe si përfundim të deklarojë statusin aktual të kësaj pasurie dhe pjesën takuese, të drejtat reale që disponon personi i lidhur mbi të.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

163. Nëpërmjet prapësimeve të depozituara, si dhe deklarimeve të bëra në seancën dëgjimore publike, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ekzistenca e kësaj pasurie iu rikujtua prej raportit të dërguar nga Komisioni, duke përshkruar në vijim historikun e kësaj pasurie, si dhe arsyet për të cilat pretendon se nuk është pasqyruar ajo në deklaratat e pasurisë.

163.1 Kështu, subjekti ka shpjeguar se pasuria e paluajtshme e llojit arë, regjistruar në ZVRPP Gjirokastër, në zonën kadastrale ***, volumi ***, faqe ***, numër pasurie **, e ndodhur në fshatin V, Gjirokastër, me sipërfaqe 6,800 m², i është kaluar babait të

¹¹⁶ Dokument i dërguar nga noteri publik, znj. E.K me shkresën e datës 7.3.2022, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 8.3.2024.

bashkëshortes LL.J në bazë të ligjit nr. 7501 si ish-punonjës (***) i një ndërmarrjeje bujqësore.

163.2 Subjekti deklaron se është e panjohur për ta koha e saktë e ndarjes së kësaj pasurie, pasi ajo nuk pasqyrohet në dokumentet që ka ruajtur familja e bashkëshortes, ndërkohë që evidenton faktin se babai i saj ka ndërruar jetë. Gjithsesi, subjekti referon se mendohet se ajo është fituar midis viteve 1993 – 1995 dhe se në dijeninë e tyre kjo pasuri nuk është përdorur asnjëherë nga babai i bashkëshortes e as nga persona të tjerë, duke evidentuar se një ndër arsytet është edhe fakti se familja e bashkëshortes nuk ishte familje bujqësore në kuptimin literal të kësaj fjale, pasi ata jetonin në qytet dhe nuk kryenin aktivitete bujqësore.

163.3 Në vijim, subjekti ka evidentuar se sipas dokumentacionit të mbajtur nga familja e bashkëshortes kjo pasuri është regjistruar në regjistrat kadastralë në vitin 2011¹¹⁷ dhe se në këtë kohë bashkëshortja tij kishte disa vite që ishte ndarë nga trangu familjar, prandaj ajo nuk ka pasur as dijeni për këtë fakt dhe as nuk e ka konsideruar veten bashkëpronare, në kushtet që nuk ishte më pjesë e familjes.

163.4 Subjekti i rivlerësimit parashtron se në vitin 2014, kur babai i bashkëshortes ka dashur ta shesë këtë pronë, atij i është kërkuar që të marrë miratimin e anëtarëve të familjes sipas gjendjes familjare të vitit 1991, pra përfshirë edhe bashkëshorten e tij, dhe se ajo e ka dhënë këtë miratim formalisht për të mos penguar procedurën e shitjes, por duke qenë e bindur nga ana morale, por edhe nga këndvështrimi i saj ligjor se nuk i takonte pjesë në këtë pasuri. Gjithashtu, evidenton faktin se kjo pasuri është shitur në vitin 2014¹¹⁸ dhe se bashkëshortja e tij nuk ka përfituar pjesë nga vlera e shitjes.

Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave

164. Në vlerësim përfundimtar të prapësimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në raport me provat e administruara gjatë hetimit administrativ, Komisioni vëren se rezulton e provuar se familja e bashkëshortes së subjektit për periudhën prej vitit 1976 – 2005 ka qenë e regjistruar si banuese në qytetin e Gjirokastrës¹¹⁹ e, për rrjedhojë, nuk mund të trajtohej me tokë si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën”. Nga ana tjetër, rezulton se babai i bashkëshortes së subjektit, z. LL.J, figuron të ketë qenë i punësuar si agronom për periudhën 1967 – 1992¹²⁰.

164.1 Në këto rrethana, në mungesë të dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor për mënyrën e fitimit të kësaj pasurie, duket bindës deklarimi i bërë nga subjekti se kjo pasuri është fituar nga babai i bashkëshortes si punonjës i ndërmarrjeve bujqësore, bazuar në ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për Tokën” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

164.2 Në vijim, rezulton se në vitin 2014 kjo pasuri është shitur nga babai i subjektit – në cilësinë e përfaqësuesit të familjes bujqësore – sipas prokurës së dhënë nga bashkëshortja dhe fëmijët e tij, ku përfshihej edhe personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit, për vlerën prej 1,944,000 lekësh.

¹¹⁷ Ka depozituar si provë kopje të dokumentit “Certifikatë për vërtetim pronësie” me nr. serial ***, datë 16.12.2011, për pasurinë e llojit arë me sipërfaqe 6800 m², nr. ***, volumi ***, faqe ***, z. k. ***, ndodhur në V, Gjirokastrë, regjistruar në emër të babait të bashkëshortes së subjektit, z. LL.J, si përfaqësues i familjes bujqësore.

¹¹⁸ Në mbështetje të prapësimeve të tij subjekti ka depozituar kopje të dokumentit kontratë shitjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.6.2014, redaktuar nga noteri publik, znj. F.SH.

¹¹⁹ Referojuni shkresës së DPGJC-së nr. *** prot., datë 19.3.2024 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 20.3.2023).

¹²⁰ Referojuni informacionit dhe dokumentacionit të dërguar nga ISSH-ja me shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.2.2021).

164.3 Trupi gjykues çmon se pikërisht në këtë moment shfaqet edhe qasja e bashkëshortes së subjektit në lidhje me këtë pasuri, duke evidentuar faktin se ajo as nuk ka deklaruar dhe as nuk ka pretenduar të ardhura nga shitja e saj.

165. Për sa më sipër, trupi gjykues i gjen bindëse shpjegimet e dhëna nga subjekti se bashkëshortja e tij nuk ka pasur dijeni në lidhje me këtë pasuri dhe as nuk e ka konsideruar veten bashkëpronare.

165.1 Për më tepër, Komisioni vlerëson se edhe nëse do ishim në kushtet e deklarimit të pasaktë sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, kjo pasaktësi do t’u takonte deklaramëve të interesave privatë periodikë vjetorë të personit të lidhur, pasi rezulton se ajo nuk është më në pronësi të familjes së bashkëshortes së subjektit në momentin e deklarimit për efekt të këtij procesi.

166. Si përfundim, në kushtet kur duket se kemi të bëjmë me një pasuri të fituar me ligj – pra se nuk ka dyshime për krijimin e saj, si dhe se personi i lidhur nuk ka deklaruar dhe as pretenduar të ardhura si pjesë takuese nga shitja e saj, trupi gjykues konkludon se mungesa e supozuar e deklarimit të pjesës takuese mbi të nga personi i lidhur në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, të depozituara prej saj ndër vite në ILDKPKI, nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj bashkëshortit të saj, gjyqtarit Juljan Haxhiu.

167. Analiza financiare për periudhën 1994 – 2003 dhe vitet 2004 – 2016

Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, deklaramet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, si dhe në përgjigje të pyetësorëve të dërguar gjatë procesit të hetimit administrativ, Komisioni kreu analizën paraprake të treguesve financiarë lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1992 – 2002 dhe vitet 2003 – 2016, nga ku dukej se vitet 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2013 paraqiten me balancë negative në fund të çdo viti, e konkretisht: (i) për vitin 2007 – balanca negative e fondeve (- 346,625 lekë); (ii) për vitin 2008 – balanca negative e fondeve (- 1,342,882 lekë); (iii) për vitin 2009 – balanca negative e fondeve (- 3,302,719 lekë); (iv) për vitin 2010 – balanca negative e fondeve (- 3,298,236 lekë); (v) për vitin 2013 – balanca negative e fondeve (- 1,282,928 lekë). Totali i balancës negative – në shumën prej - 9,573,389 lekësh.

168. Sa më sipër, duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2013.

169. Pas kalimit të barrës së provës mbi rezultatet e analizës financiare, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet prapësimeve të tij dha shpjegime dhe depozitoi prova të reja, duke ngritur pretendime në lidhje me: (i) ligjshmërinë e të ardhurave të deklaruara dhe të përfituara nga personi i lidhur prej punës së kryer në Ambasadën e ***, të paflektuara në analizën financiare paraprake; (ii) të ardhura shtesë të përfituara prej personit të lidhur në vitin 2013 nga barrëlindja, të paflektuara në analizën financiare paraprake; (iii) mbulimin tërësisht prej shoqërive të sigurimit të shpenzimeve mjekësore të deklaruara për vitet 2010, 2013 dhe 2016; (iv) reduktimin e shpenzimeve të udhëtimeve jashtë vendit për vitet 2005, 2006, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, me pretendimin se janë paguar nga punëdhënësit apo organizatorët respektivë të aktiviteteve; (v) aplikimin e kursit të këmbimit në periudhën e kryerjes së disa transaksioneve.

170. Pas verifikimit dhe analizimit të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit mbështetës të depozituar nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, pjesa më e madhe e të cilave janë trajtuar në mënyrë të detajuar si më sipër në këtë vendim, Komisioni vlerësoi: (i) të reflektojë të ardhura shtesë për

periudhën 2007 – 2010 si të përfituara nga bashkëshortja e subjektit prej punës së kryer në Ambasadën e ***; (ii) të heqë shpenzimet mjekësore për vitet 2010, 2013 dhe 2016; (iii) të shtojë të ardhurat nga leja e lindjes për bashkëshorten në vitin 2013; (iv) të reduktojë shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit për subjektin dhe personin e lidhur për vitet 2005, 2006, 2008, 2009, 2010, 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016; (v) të aplikojë kursin e këmbimit sipas pretendimit të subjektit për disa transaksione të kryera në vitin 2009.

171. Për sa më sipër, bazuar në: (i) dokumentacionin e administruar në dosje; (ii) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI; (iii) shpjegimet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë¹²¹ lidhur me pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994 – 2003 dhe për vitet 2004 – 2016, nga ku rezulton se vetëm viti 2013 paraqitet me balancë negative të fondeve, e konkretisht për vlerën - 744,731 lekë.

172. Në vlerësim përfundimtar të rezultatit të analizës financiare, trupi gjykues çmon se kjo balancë negative e vitit 2013 (evidentuar edhe më sipër në trajtimin e pasurive si balanca e vetme negative vjetore) nuk është e mjaftueshme për ta vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pra, arrihet në konkluzionin se edhe kjo rrethanë e konstatuar nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

173. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

173.1 Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Ai ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

173.2 Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë e konstatuara dhe balanca negative e fondeve e rezultuar nuk është e mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

173.3 Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaratimet e pasakta të konstatuara si më sipër dhe problematikat e evidentuara në analizën financiare nuk çmohen të mjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë apo të vlerësohen si të tilla që të ndikojnë në vlerësimin tërësor në procesin e rivlerësimit të kryer për këtë subjekt. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia, pasi vlerësimi duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit.

174. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

¹²¹ Referojuni tabelës së analizës përmbledhëse të treguesve financiarë të kryer nga Komisioni, Aneks 1 – pjesë e këtij vendimi.

B. KONTROLLI I FIGURËS

175. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK), ish-DSIK, ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur/ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

176. Për këtë qëllim, AKSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin¹²² mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej tij në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

177. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu.

178. Komisioni ka kërkuar nga AKSIK-ja¹²³ përditësimin e raportit mbi kontrollin e figurës me informacione të reja, të mundshme, të përcjella rishtazi nga organet e verifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu. AKSIK-ja ka dërguar në Komision shkresat e administruara nga institucionet e verifikimit pas përpilimit të raportit mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt. Nga verifikimi i tyre nuk rezulton të jenë përcjellë informacione apo sinjalizime mbi kontakte të papërshtatshme dhe/apo përfshirjen e subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, në veprimtari të kundërligjshme.

179. Në këtë kontekst, AKSIK-ja nuk ka përpiluar një raport të ri për subjektin e rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, por me vendimin nr. ***, datë 4.7.2023, të KDZH-së, ka deklasifikuar plotësisht raportin mbi kontrollin e figurës të dërguar më parë në Komision, me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës¹²⁴.

180. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

181. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

182. Subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, për periudhën nëntor 2002 – tetor 2003 ka qenë stazhier (gjyqtar) pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; për periudhën tetor 2003 – gusht 2007 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mirditë;

¹²² Raporti mbi kontrollin e figurës nr. *** prot., datë 2.11.2017.

¹²³ Shkresa e Komisionit nr. *** prot., datë 10.2.2023.

¹²⁴ Dërguar raportin i kontrollit të figurës i deklasifikuar plotësisht, me shkresën e AKSIK nr. *** prot., datë 6.7.2023, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2023.

për periudhën shtator 2007 – nëntor 2011 ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë; për periudhën nëntor 2011 – e deri aktualisht ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

183. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përpiluar raportin për analizën e aftësive profesionale¹²⁵, i cili është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dokumenteve ligjore/dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

184. Referuar raportit, subjekti i rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, ka shfaqur aftësi të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, duke i kushtuar mjaft vëmendje arsytimit ligjor të vendimeve të dhëna prej tij. Ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Rezulton se ka shfaqur aftësi të mira për të kryer procedurat gjyqësore dhe në përgjithësi ka qenë eficient në çështjet që ka shqyrtuar. Gjithashtu, konstatohet se ky gjyqtar ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë, si dhe për planifikimin e organizimin e veprimeve të nevojshme dhe përgatitjen e çështjeve për gjykim në funksion të zgjidhjes së tyre. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

185. Por, gjithsesi, nga vëzhgimi i 3 dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, në raport janë listuar disa gjetje e, më konkretisht: (i) tejkalimi i afatit standard të gjykimit civil me disa ditë, të rezultuara në 2 dosje të shortuara dhe në 2 dokumente të paraqitura nga vetë gjyqtari; (ii) zgjatje afati të arsytimit të vendimeve në 4 dosje; (iii) mosregjistrim i seancave gjyqësore në audio, çka bie ndesh me solemnitetin dhe transparencën në gjykim.

Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni

186. Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur 3 dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së, nga ku duket se nuk konstatohen problematika thelbësore lidhur me kriterin e vlerësimit profesional. Por, nga ana tjetër, duket se qëndrojnë gjetjet e evidentuara në raportin për analizën e aftësive profesionale, për të cilat subjektit iu kërkuan shpjegime me dërgimin e rezultateve të hetimit.

187. Në vlerësimin e gjyqtarit Juljan Haxhiu u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe 38 denoncime të depozituara nga publiku. Pas verifikimit dhe shqyrtimit të tyre, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës dhe/apo i kërkoi të japë shpjegime për çështje gjyqësore të gjykuara prej tij që lidhen me pesë ankesa të depozituara nga publiku. Kështu, Komisioni i kërkoi subjektit të japë në mënyrë të përgjithshme shpjegimet/sqarimet/argumentet e tij mbi këto ankesa për pretendimet e ngritura nga denoncuesit, gjetjet e evidentuara, si dhe të provojë e referojë me dokumente justifikuese ligjore veprimet e kryera prej tij në proceset gjyqësore që lidhen me çështjet objekt denoncimi.

¹²⁵ Raporti për vlerësimin e aftësive profesionale nr. *** prot., datë 23.9.2022.

DENONCIME

Denoncim i shtetasit E.M¹²⁶

188. Shtetasi E.M, në cilësinë e përmbaruesit pranë zyrës përmbarimore “K. B. S”, ka paraqitur pranë Komisionit ankesë, ku referon se pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë ka qenë palë ndërgjyqëse në një çështje gjyqësore civile me objekt “Anulim i veprimeve përmbarimore”, shqyrtuar nga subjekti i rivlerësimit, proces i cili ka përfunduar me vendimin gjyqësor nr. ***, datë 25.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ankuesi ka paraqitur pretendime të natyrës së zgjidhjes së themelit, të cilat, pasi u shqyrtuan, vlerësohen se nuk janë kompetencë e Komisionit bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjithashtu, ndër të tjera, referon për disa shkelje procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me ngritjen e padisë jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga neni 610 i Kodit të Procedurës Civile.

189. Mbi bazën e këtyre *indicieve*, Komisioni administroi vendimet gjyqësore në lidhje me këtë çështje, ku vërehet se:

189.1 Me vendimin nr. ***, datë 25.9.2019, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë¹²⁷, është vendosur: “Anulimi i veprimeve përmbarimore, konkretisht të procesverbalit nr. *** prot., datë 4.12.2018, të përmbaruesit gjyqësor privat E.M në zbatim të kontratës së huas datë 14.5.2010 dhe vendimit të urdhrit të ekzekutimit nr. ***, datë 20.2.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe konstatimin e pavlefshmërisë së ankandëve për këtë pasuri të paluajtshme; rrëzimin e kërkesës për pezullimin e ekzekutimeve të mëtejshme të veprimeve përmbarimore të kalimit të pronësisë në favor të blerësit të pasurisë së paluajtshme objekt ankandi. Ky vendim përbën titull ekzekutiv pasi të marrë formë të prerë, si dhe është i ekzekutueshëm nga përmbarimi”.

189.2 Me vendimin nr. ***, datë 2.3.2020, të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur: “Ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 25.9.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë si vijon: rrëzimi i kërkesëpadisë”.

190. Nga analizimi i akteve u konstatua se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar padinë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore jashtë afatit ligjor (5-ditor), përcaktuar në nenin 610, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile. Mbi këtë konstatim subjektit iu kërkuan shpjegime/ prova për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

191. Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij u ndal të arsyetonte në detaje në lidhje me marrjen në shqyrtim të padisë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore e duke mbajtur qëndrimin se ka pasur një interpretim nga ana e tij në lidhje me pranimin e shqyrtimit të padisë, ku në thelb qëndron lidhja e themelit me veprimet përmbarimore. Mbi këtë bazë ka konkluduar në lidhje me moszbatimin e afatit të parashikuar nga neni 610 i Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, subjekti ka shpjeguar se kjo ankesë është shqyrtuar edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili pas shqyrtimit ka vendosur të arkivojë ankesën, duke paraqitur në cilësinë e provës vendimin nr. *** prot., datë 12.9.2023, të ILD-së, sipas të cilit, ndër të tjera, është arsyetuar se shkeljet e pretenduara hyjnë në sferën e shqyrtimit nga një gjykatë më e lartë sipas parimit të hierarkisë gjyqësore.

192. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, i çmon ato bindëse, pasi subjekti arriti të provojë para Komisionit se nuk ka “neglizhuar” zbatimin e dispozitës ligjore, porse, në raport me faktet e paraqitura për shqyrtim nëpërmjet padisë, ka vlerësuar mbrojtjen e interesit të ligjshëm të kërkuesit, duke bërë interpretim mbi moszbatimin e dispozitës ligjore, parashikuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile.

¹²⁶ Ankesa nr. *** prot., datë 4.12.2019.

¹²⁷ Shkresa e Gjykatës nr. *** prot., datë 21.2.2024.

193. Trupi gjykues arrin në këtë konkluzion bazuar në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit parashikohet se vlerësuesi në vlerësimin e aftësive profesionale nuk gjykon interpretimin apo logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Denoncim i shtetasit DH.N¹²⁸

194. Shtetasi Dh. N. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit dhe disa gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Tiranë për moszbatim të vendimeve të Gjykatës së Apelit në një çështje civile (tregtare), duke paraqitur akte të proceseve gjyqësore, nga administrimi i të cilave ka rezultuar si vijon:

194.1 Para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është shqyrtuar çështja civile me paditës M. N., të paditur shoqërinë “P.” sh.a., me objekt “Pavlefshmëri e ndarjes së shoqërisë dhe akteve që ndryshuan statutin e shoqërisë “P” sh.a. Pezullimin e procedurave të mëtejshme të ndarjes së shoqërisë “P” sh.a. dhe akteve për publikim”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 25.4.2004, ka vendosur “Kthimin e kërkesëpadisë me paditës M. N. si kërkesëpadi me të meta”. Ky vendim është kundërshtuar nga paditësi në Gjykatën e Apelit Tiranë.

194.2 Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 31.1.2006, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 25.4.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e akteve në po atë gjykatë me të njëjtin trup gjykues për vazhdimin e gjykimit”. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, ka arsyetuar se: “[...] nuk shërben si shkak, siç është pranuar nga gjykata, se meqë i padituri nuk ka përcaktuar saktë se kush do të thirrej me cilësinë e të paditurit, meqë sh.a. P është ndarë, që padia të kthehet, por gjykata duhej të vazhdonte gjykimin, duke aplikuar nenin 184 e 199 të Kodit të Procedurës Civile mund të vendoste për zëvendësimin procedural të palës së paditur. ... Meqë nga Gjykata e Shkallës së Parë kërkesëpadija e ngritur nga paditësi M. N. është kthyer si kërkesëpadi me të meta, vlerësohet se vendimi i gjykatës është i pabazuar, pasi është marrë në kundërshtim me nenin 154 të Kodit të Procedurës Civile, prandaj vendimi duhet prishur dhe të vazhdohet gjykimi”.

194.3 Pasi çështja është kthyer për rigjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë pas shqyrtimit me vendimin nr. ***, datë 8.10.2009, ka vendosur “Kthimin e kërkesëpadisë dhe akteve që i përket çështjes civile nr. *** akti paditësit si kërkesëpadi me të meta të paplotësuar”, me arsyetimin se padia ka objekt të papërcaktuar. Ky vendim është ankimuar nga paditësi M. N. në Gjykatën e Apelit Tiranë.

194.4 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 2.11.2010, ka vendosur “Prishjen e vendimit civil nr. ***, datë 8.10.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për të vazhduar gjykimin në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues”. Gjykata e Apelit ka argumentuar se në rigjykim gjykata e shkallës së parë është e detyruar t’i përmbahet vendimit të Gjykatës së Apelit nr. ***, datë 31.1.2006, trajtuar më sipër, si dhe urdhëron gjykatën e faktit që të vazhdojë gjykimin.

194.5 Në vijim, pasi çështja i caktohet gjyqtarit Juljan Haxhiu, vërehet se subjekti i rivlerësimit me vendimin nr. ***, datë 22.7.2014, ka vendosur “Kthimin e akteve që i përkasin kësaj padie nr. regjistri **, me palë ndërgjyqëse paditësin M.N dhe palë e paditur shoqëria “P” sh.a., me objekt “Pavlefshmëria e ndarjes së shoqërisë dhe akteve që ndryshuan statutin e shoqërisë P sh.a.”, me arsyetimin se gjykata ka orientuar palën paditëse që të rregullojë padinë, duke përcaktuar cilat janë palët ndërgjyqëse, adresat dhe

¹²⁸ Ankesa nr. *** prot., datë 13.3.2019.

caktimin e një objekti të përbashkët për të gjithë. Objekti i padisë duhet të jetë i njëjtë për të gjitha palët ndërgjyqëse dhe nuk mund të jetë i ndryshëm për secilën palë të paditur.

194.6 Vërehet se paditësi përsëri duke mos qenë dakord ka vijuar me ankimimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në vijim, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 18.12.2014, ka vendosur “Prishjen e vendimit nr. ***, datë 22.7.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Dërgimin e çështjes për të vazhduar gjykimin në po atë gjykatë me të njëjtin trup gjykues”, duke mbajtur të njëjtin arsyetim si më parë që gjykata e shkallës së parë nuk duhej të kthente padinë me të meta, por duhej të vazhdonte gjykimin e duke aplikuar nenin 184 e 199 të Kodit të Procedurës Civile mund të vendoste për zëvendësimin procedural të palës së paditur.

195. Komisioni, pasi shqyrtoi pretendimet e denoncuesit dhe analizoi aktet e paraqitura, i kaloi subjektit barrën e provës për të paraqitur prova/shpjegime të tjera sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 në lidhje me mozbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit, pasi nga moszbatimi i tyre duket se është zvarritur procesi.

196. Subjekti ka theksuar se pavarësisht se pretendohet nga ana formale se nuk është zbatuar një vendim i Gjykatës së Apelit, është zbatuar në mënyrë korrekte ligji dhe janë respektuar të drejtat e të gjitha palëve, duke arsyetuar se: “Përcaktimi formal i paditësit në padi nuk është i mjaftueshëm për ta konsideruar padinë e plotë, pasi në nenin 15 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se padia përmban “emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë”.

196.1 Në kushtet kur objekti i padisë ka qenë pikërisht “Pavlefshmëria e ndarjes së shoqërisë “P sh.a.”, sipas logjikës së subjektit dhe gjyqtarëve të tjerë që e kanë shqyrtuar padinë më parë ka qenë e qartë se shoqëria “P” sh.a. nuk ekziston më e, për rrjedhojë, padia duhet të ngrihet kundër entiteteve që kanë trashëguar të drejtat e saj.

196.2 Për më tepër, procedimi me zëvendësimin procedural të palëve, sikurse është udhëzuar nga Gjykata e Apelit, ka qenë i pamundur, edhe pse është sugjeruar si zgjidhje për atë që vetë Gjykata e Apelit pranon se është e metë e padisë, pavarësisht se ka vendosur prishjen e vendimit. Gjykata e Apelit ka sugjeruar që të aplikohen nenet 184 dhe 199 të Kodit të Procedurës Civile, por këto nene nuk mund të aplikohen së bashku, sepse rregullojnë raste të ndryshme të zëvendësimit procedural të palëve. Neni 184¹²⁹ ka të bëjë me zëvendësimin procedural, që vjen si pasojë e themelit të çështjes dhe kërkon dakordësinë e të gjitha palëve të përfshira, kurse neni 199¹³⁰ ka të bëjë me zëvendësimin gjatë gjykimit kur njëra palë vdes apo mbaron. Mirëpo, në rastin konkret, “P” sh.a. pranohet nga paditësi se ka mbaruar që para gjykimit dhe përcaktimi i personave që kanë të trashëguar të drejtat e tij duhet të ishte bërë që me ngritjen e padisë. Pra, të metat ishin të tilla që nuk lejonin fillimin e gjykimit.

197. Pasi ka arsyetuar në lidhje me pamundësinë sipas tij për vijimin e gjykimit referuar kushteve të padisë, subjekti ka ndaluar të shpjegojë edhe mbi dinamikën e krijuar nga paditësi për shkak të kësaj parregullsie, duke paraqitur informacion në rend kronologjik në

¹²⁹ Kur gjatë gjykimit del se padia është ngritur nga një person, që nuk ka të drejtë ta ngrejë, ose është ngritur kundër një personi ndaj të cilit nuk duhej të ngrihej, me kërkesën e palës së interesuar gjykata mund të lejojë zëvendësimin e paditësit ose të të paditurit të parë, me paditësin që i përket e drejta që të ngrejë padinë ose me të paditurin kundër të cilit duhej të ngrihej padia. Për këtë zëvendësim gjykata duhet të marrë më parë pëlqimin e të dyja palëve dhe të personit që hyn në vend të tyre si palë.

¹³⁰ Kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga ose kundër trashëgimtarëve të saj.

Kur pala që është person juridik mbaron, çështja vazhdon nga ose kundër personit juridik a fizik, të cilit i kanë kaluar të drejtat e detyrimet e personit juridik që ka mbaruar.

lidhje me datat e seancave të shtyra (5 seanca përgatitore) për t'i dhënë mundësi paditësit të saktësojë palën e paditur.

197.1 Për më tepër, subjekti ka shpjeguar se përveç kësaj dinamike, paditësi ka qenë në kufijtë e ngritjes edhe të padive të reja, pasi në seancën e datës 4.6.2014 paditësi ka shtuar e saktësuar padinë, duke shtuar si palë të paditur edhe persona të tjerë si A.K, M.S, L.C (notere), F.SH (notere), V.S (notere), A.M (notere), D.P (notere), ZVRPP Tiranë, P.H (ekspert vlerësues) dhe persona të tretë shoqëria “M. – P.” sh.a., shoqëria “Z” sh.p.k., shoqëria “M” sh.p.k., shoqëria “P” sh.a., familja P., duke paraqitur edhe objekte të ndryshme padie, me shkaqe të ndryshme ligjore për secilën palë të paditur. Më në fund, subjekti ka theksuar se për këtë çështje janë kryer disa gjykime e rigjykime, në të cilat ka qenë prezent vetëm paditësi, pa iu dhënë mundësi asnjë pale tjetër në konflikt të paraqesë pretendime apo të bëjë ankime, pikërisht për faktin se këto palë nuk janë identifikuar. Subjekti ka konkluduar se për sa arsyetuar ka qenë i pamundur vazhdimi i gjykimit pa u rregulluar të metat e padisë nga paditësi.

198. Trupi gjykues, duke pasur parasysh dinamikën e kësaj çështjeje, arsyetimin e subjektit në vendimmarrjen e tij, si dhe shpjegimet shteruese të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit, çmon se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm se ka bërë të gjitha përpjekjet për vlerësimin me objektivitet të padisë së paraqitur për shqyrtim.

199. Nga vlerësimi i arsyetimit të vendimit, trupi gjykues çmon se pavarësisht dispozitivit formal të përcaktuar në vendimin e gjykatës së apelit, duket se subjekti ka vlerësuar opsionet e sugjeruara nga gjykata e apelit në raport me faktet e paraqitura për shqyrtim e në përfundim ka vendosur duke u bazuar në bindjen e tij.

200. Trupi gjykues, në këtë kontekst, çmon të theksojë se përcaktimi i palës së paditur në padi nuk është një detyrim formal i paditësit, por është një detyrim thelbësor që ka të bëjë me të drejtën e palës së paditur për t'u njoftuar për padinë e paraqitur dhe se vijimi i gjykimit në këto kushte, me palë të paditura të papërcaktuara qartë, do të kishte përbërë shkelje procedurale nga ana e gjykatës.

Denoncim i shtetasës R.S¹³¹

201. Shtetasja R. S. nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë Komisionit ankohet për disa shkelje të konstatuara në një proces gjyqësor civil me objekt “Kundërshtim veprimesh përmbartimore të përmbartuesit privat V. Sh.”, për të cilat, pasi u shqyrtuan nga Komisioni, nuk u gjetën *indicie*.

201.1 Gjithashtu, ndër të tjera, Komisioni shqyrtoi edhe pretendimin e ankueses në lidhje me tejzgjatjen e procesit gjyqësor në kundërshtim me afatin maksimal prej 20 ditësh, përcaktuar në nenin 610 të Kodit të Procedurës Civile dhe, pasi administroi aktet¹³² në lidhje me këtë denoncim, i kërkoi subjektit shpjegime bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

202. Në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka shpjeguar se nuk ka pasur seanca joproductive. Nga analizimi i shtyrjeve të seancave ka rezultuar se gjykimi i kësaj çështjeje ka zgjatur 2 muaj e 15 ditë, pasi është ndërprerë për 4 muaj si pasojë e kufizimeve të

¹³¹ Ankesa nr. *** prot., datë 2.11.2020.

¹³² Referojuni shkresës së Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 26.2.2024.

“Covid-19” dhe për 1 muaj gjatë lejes vjetore të gjykatës. Subjekti ka theksuar se edhe gjatë kohës efektive të gjykimit asnjë seancë nuk është shtyrë për shkaqe që lidhen me të, por me kërkesë të palëve, përfshirë dhe vetë denoncuesen, të cilat kanë kërkuar vazhdimisht marrjen e provave apo kanë paraqitur kërkesa të tjera procedurale, për të cilat është shtyrë gjykimi. Subjekti ka shpjeguar se kjo ankesë është paraqitur edhe në institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili pas shqyrtimit ka vendosur të arkivojë këtë ankesë, duke vlerësuar se nuk identifikohen veprime të qëllimshme për zvarritjen e gjykimit nga ana e gjyqtarit, duke paraqitur në cilësinë e provës vendimin nr. *** prot., datë 21.12.2023, të ILD-së.

203. Nga analizimi me objektivitet i shpjegimeve të subjektit, trupi gjykues çmon se subjekti arriti të provojë se nuk ka pasur mungesë efektiviteti nga ana e tij si gjyqtar i çështjes, porse shtyrjet e seancave kanë ardhur për shkaqe objektive të pavarura nga subjekti, si dhe për t’u dhënë mundësi palëve për të realizuar të drejtat e tyre ligjore.

Denoncim i shoqërisë “B” sh.p.k. me përfaqësues ligjor z. K.Ç¹³³

204. Në denoncimin e paraqitur, shoqëria “B” sh.p.k. ka pretenduar se pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pasur një proces gjyqësor në lidhje me një konflikt pronësie për një sipërfaqe prej 198m² trualli të dhënë për ndërtim, i cili ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 16.5.2017, të gjyqtarit Juljan Haxhiu, ku është vendosur rrëzimi i padisë së paraqitur nga denoncuesi si të pambështetur në ligj dhe në prova. Më tej, vendimi është ankimuar nga shoqëria B sh.p.k. në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ku në vijim të hetimit¹³⁴ të kryer nga Komisioni informohet se për këtë çështje nuk është caktuar ende datë për gjykimin e saj.

204.1 Në lidhje me këtë çështje, denoncuesi ka paraqitur disa pretendime, të cilat, pasi u shqyrtuan, nuk u gjetën *indicie* për subjektin e rivlerësimit. Në lidhje me pretendimin se subjekti i rivlerësimit ka mundësuar gjatë procesit thirrjen e një eksperti, që nuk figuron në listat e Ministrisë së Drejtësisë e, për këtë arsye, nuk duhej të thirrej, pasi bie në kundërshtim me nenin 224/a të Kodit të Procedurës Civile¹³⁵, Komisioni i kërkoi subjektit të provonte të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

205. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka theksuar se në këtë çështje nuk ka shkelur rregullat procedurale për caktimin e ekspertit duke arsyetuar si vijon. Padia është paraqitur në datën 3.12.2015 dhe vendimi është dhënë në datën 16.5.2017. Në këtë kohë ka qenë në fuqi Kodi i Procedurës Civile me ndryshimet e bëra deri në vitin 2013, i cili ka pasur zbatim gjatë gjithë kohëzgjatjes së gjykimit, bazuar në dispozitat kalimtare të vetë Kodit. Sipas dispozitave të zbatueshme gjatë gjykimit¹³⁶, eksperti nuk caktohej nga ndonjë listë elektronike. Caktimi i ekspertit rregullohej nga nenet 224/a¹³⁷ dhe 225¹³⁸ në formulimin e vjetër. Regjistri elektronik i ekspertëve është krijuar nga ndryshimet në nenin 224/a¹³⁹ dhe

¹³³ Ankesa nr.*** prot., datë 10.10.2022.

¹³⁴ Shkresa e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. *** prot., datë 26.2.2024.

¹³⁵ Sipas të cilit “*Ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë*”.

¹³⁶ Të cilat ngelen të zbatueshme edhe në shkallët më të larta për këtë çështje.

¹³⁷ Ekspertët caktohen sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

¹³⁸ Caktimi i ekspertit bëhet nga gjykata duke marrë edhe mendimin e palëve e të pjesëmarrësve në gjykim.

¹³⁹ Ekspertët zgjidhen nga një regjistër elektronik i personave të licencuar, i cili administrohet dhe publikohet nga Ministria e Drejtësisë, përveç kur janë kushtet e parashikuara në nenin 224/d, pika 2 e këtij Kodi.

shtimin e nenit 224/d të bërë me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

206. Në përfundim, subjekti ka konkluduar se ka arritur të plotësojë standardin për barrën e provës së vendosur nga Komisioni, duke provuar se në këtë çështje nuk janë shkelur rregullat e zbatueshme për caktimin e ekspertit.

207. Trupi gjykues çmon se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm se në caktimin e ekspertit të çështjes ka zbatuar dispozitat ligjore që kanë qenë në fuqi gjatë kohës së shqyrtimit të çështjes, ku eksperti caktohej nga gjykata pasi merrte mendimin e palëve. Rregullimi specifik që i është bërë caktimit të ekspertëve është parashikuar me kuadrin e ri ligjor, ligjin nr. 38/2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar¹⁴⁰, si dhe aktin nënligjor Udhëzim nr. 10619, datë 19.10.2018, i ministrit të Drejtësisë “Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të regjistrimit elektronik për ekspertët”, i cili ka përcaktuar rregulla të hollësishme në lidhje me caktimin e ekspertëve, si dhe të drejtën e publikut/palëve të interesuara për të aksesuar *online* listën e ekspertëve teknikë.

Denoncim i shoqërisë “D” sh.p.k.¹⁴¹ dhe i shoqërisë “**” sh.a.¹⁴²**

208. Në ankimet e paraqitura, të dyja shoqëritë pretendojnë në lidhje me disa gabime teknike të kryera në vendimmarrje nga subjekti i rivlerësimit në një proces civil sigurim padie, gabime të cilat janë rregulluar më vonë po me vendim të gjyqtarit.

209. Komisioni tërhoqi¹⁴³ dosjen gjyqësore të kërkesës për sigurim padie të gjyqtarit Juljan Haxhiu, ku vërehen këto fakte: ankuesit, shtetasit V. D. dhe A. D. janë thirrur si persona të tretë nga shoqëria “G” sh.p.k. në çështjen civile nr. *** regj. them., datë 13.4.2021, sigurim padie dhe themeli të gjykuar nga gjyqtari Juljan Haxhiu me palë paditëse – shoqërinë “G” sh.p.k; të paditur – shoqërinë “Shtëpia Botuese ***” sh.a.; person i tretë – shoqëria “D” sh.p.k., V. D., A. D. dhe ASHK Tiranë me objekt “Konstatimin e faktit të parashkrimit fitues me mirëbesim kundër të paditurit Shtëpia Botuese... sh.a. në favor të “G” sh.p.k. si pronar i pasurisë me sip. 241 m². Regjistrimin e pasurisë me sip. 241 m² në ASHK Tiranë në emër të paditësit “G” sh.p.k. Sigurimin e padisë duke vendosur masën e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme me sip. 241 m², regjistruar në emër të Shtëpisë Botuese... sh.a. dhe pezullimin e çdo veprimi juridik për tjetërsimin etj.”.

209.1 Në përfundim të gjykimit të kërkesës për masë sigurimi, subjekti i rivlerësimit me vendimin datë 20.4.2021 ka vendosur “Pranimin e kërkesës. Sigurimin e padisë duke vendosur masën e sekuestros konservative mbi pasurinë e paluajtshme me sip. 241 m² në pronësi të Shtëpisë Botuese... sh.a. dhe pezullimin e çdo veprimi juridik ...deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes”.

¹⁴⁰ Hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2017, pra pas shqyrtimit të çështjes, përfunduar me vendimin datë 16.5.2017.

¹⁴¹ Ankesa nr. *** prot., datë 27.9.2022.

¹⁴² Ankesa nr. *** prot., datë 27.9.2022.

¹⁴³ Shkresa e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm nr. *** prot., datë 21.2.2024.

210. Nga shqyrtimi i çështjes u konstatuan pjesë arsyetimi të përdorura nga subjekti në vendim, të cilat dukeshin kontradiktore me vendimin e dhënë e për të cilat Komisioni i kaloi barrën e provës për sa dukeshin që cenonin qartësinë e arsytimit ligjor.

211. Subjekti ka shpjeguar se në vendimin objekt ankese për sigurimin e padisë ka pasur një gabim material në pjesën arsyetuese, i cili është shkaktuar nga ngarkesa në punë, por, pasi është vërejtur nga gjykata, është korrigjuar nëpërmjet institutit të ndreqjes së gabimit. Kjo pasaktësi ka qenë e veçuar në një paragraf të vendimit për shkak të ngarkesës, ndërkohë që përmbajtja e arsytimit në tërësi ka qenë në funksion të vendimit të marrë.

211.1 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se kjo çështje është bërë objekt shqyrtimi edhe nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili ka vendosur ta arkivojë këtë ankesë pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se veprimet dhe vendimet në lidhje me masën e sigurimit të padisë në këtë çështje hyjnë në sferën e pavarësisë së gjyqtarit për të shqyrtuar rastin dhe për të interpretuar dispozitat materiale e procedurale të ligjit.

212. Trupi gjykues çmon se subjekti shpjegoi bindshëm në lidhje me barrën e provës së lënë për sa i përket cilësisë së arsytimit. Subjekti arriti të provojë se gabimet materiale të konstatuara në pjesën arsyetuese të vendimit janë korrigjuar më vonë përmes institutit të ndreqjes së gabimit dhe nuk u gjetën problematika të tjera që të mund të cenonin elemente të tjera të vendimmarrjes.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

213. Për sa më sipër, Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet prapësimet e subjektit të rivlerësimit të shoqëruara me shpjegimet dhe provat përkatëse, çmon se ai ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor sa i përket gjetjeve të evidentuara në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe mbi kërkesat dhe/apo gjetjet e evidentuara në trajtimin e problematikave të ngritura në denoncimet e depozituara nga publiku, ku nga vlerësimi tërësor i tyre nuk vërehen rrethana që mund të përbëjnë shkelje procedurale, të tilla që mund të çojnë në konkluzione negative lidhur me kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale.

214. Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

215. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe në rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga prej tij, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Juljan Haxhiu, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 7.6.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Alma FASKAJ
Kryesuese

Pamela QIRKO
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare (kundër)

Sekretare gjyqësore
Amela Idrizi

ANEKS 1 – TABELA PËRMBLEDHËSE E ANALIZËS FINANCIARE

Analiza financiare për periudhën 1994 - 2003 dhe vitet 2004 - 2016. Vlerat në Lek	1994-2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	2,700,292	2,153,649	-294,744	2,342,831	1,169,400	656,114	3,034,655	5,012,649	250,707	134,245	7,838,032	1,182,048	398,939	-977,650
Apartament me sip. 89,82 m ² (96 m ²), ndodhur në lagjen ***, Tiranë.		3,358,610		2,474,060										
Apartament me sip. 58 m ² , ndodhur në lagjen *** Durrës.							4,162,565		287,802					
Apartament me sip. 57.1 m ² ndodhur në rrugën ***, Tiranë.								5,139,000						
Apartament me sip. 89,82 m ² (neto), ndodhur në lagjen ***, Tiranë.											6,200,000			
Garazh 18,77 2 m ² , ndodhur në lagjen ***, Tiranë.											500,000			
Autoveturë*** (targa ***) blerë nga subjekti datë 29.11.2003.	250,000													
Autoveturë*** (targa ***) blerë nga subjekti datë 31.08.2007.					965,836									
Autoveturë*** (targa ***) blerë nga babai i subjektit datë 03.02.2014.												400,000		
Ndryshim likuiditeti	2,450,292	-1,204,961	-294,744	-131,229	203,564	656,114	-1,127,910	-126,351	-37,096	134,245	1,138,032	782,048	398,939	-977,650
B) DETYRIME	0	0	0	1,900,000	0	400,000	2,000,000	5,800,000	0	0	4,960,000	0	0	0
Kredia e disburuar në datë 01.03.2004 Alpha Bank (30.000 usd) (B. J.H)				1,900,000										
Kredia e disburuar në datë 20.07.2006 Alpha Bank (1.900.000 lekë)						400,000								
Kredia e disburuar në datë 14.08.2008 Alpha Bank (400.000 lekë)							2,000,000							
Kredia e disburuar në datë 12.02.2009 Alpha Bank (2.000.000 lekë)								5,800,000						
Kredia e disburuar në datë 14.07.2010, Alpha Bank (5,800,000 lekë)											4,960,000			
Kredia e disburuar në datë 07.10.2013 BKT (4,960,000 lekë)														
C) PASURI NETO (A-B)	2,700,292	2,153,649	-294,744	442,831	1,169,400	256,114	1,034,655	-787,351	250,707	134,245	2,878,032	1,182,048	398,939	-977,650
D) TË ARDHURA	6,462,327	3,066,666	1,806,363	1,658,434	4,145,961	4,353,846	4,250,722	4,280,842	4,680,936	5,149,903	9,405,322	4,521,752	4,244,497	3,415,620
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit	1,034,402	863,832	856,896	859,087	898,984	845,171	818,440	879,819	848,884	949,147	907,725	1,139,544	1,172,836	1,088,912
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit shkolla e Magjistraturës.	600,890		7,699		32,030	38,880	17,280			489,568			27,625	
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në U.A.T					76,173	103,473	18,518	44,974	124,700					
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në U.E.T					104,705									
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në Univeritetin L.	156,000	153,000	145,700	159,840	172,170	232,110	246,420	261,450	122,670	37,710	50,670			
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në Sh. U.Gj të Shqipërisë											93,985	252,000		
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në T. B. U									301,205	132,750				
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në ***														
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit në F.Sh.F												18,000	43,000	51,000
Të ardhura nga paga e subjektit të rivlerësimit nga ***										329,394	164,673	161,271		
Të ardhura nga paga e bashkëshortes B.H					1,682,427	2,175,867	2,640,089	3,047,349	3,201,527	3,211,334	2,355,599	2,950,937	3,001,036	1,925,708
Të ardhura nga paga e bashkëshortes B.H në Fakultetin e Drejtësisë / UAT						54,900		47,250	81,950					
Të ardhura nga paga e bashkëshortes B.H në ***						8,500	169,975							
Të ardhura nga prindërit e bashkëshortes B.H														
Të ardhura nga interesat e depozitës Alpha Bank në emër të Juljan Haxhiu	48,117	9,214	5,877	5,081	-	-								
Të ardhura nga interesat e depozitës ProCredit Bank në emër të Juljan Haxhiu					3,385									
Të ardhura nga interesat e depozitës Alpha Bank në emër të Brulinda Jani Haxhiu					3,840									
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa *** në datë 28.06.2016.														350,000
Të ardhura nga shitja e automjetit me targa *** në datë 09.07.2007.					250,000									
Të ardhura nga shitja e apartamentit në Krujë, shitur në datë 18.06.2001 (1,500,000 lekë).	1,500,000													
Të ardhura nga paga e babait G.H	1,465,119	365,008	438,147	258,638	326,700									
Të ardhura nga pagesa e invaliditetit të babait G.H														
Të ardhura nga pensioni G.H					305,823									
Të ardhura nga paga / vendimi gjyqësor M. H	1,589,399	288,930	309,100	365,229	384,492									
Të ardhura nga pensioni M. H														
Të ardhura nga interesat e depozitës Raiffeisen Bank në emër të M. H			28,049											
Të ardhura nga interesat e depozitës ProCredit Bank në emër të G.H	68,400	73,668	14,895	10,579	9,937									
Të ardhura nga interesat e depozitës Alpha Bank në emër të G.H														
Të ardhura nga interesat e depozitës Credins Bank në emër të G. H														
Të ardhura nga interesat e depozitës BKT Bank në emër të G. H														
Të ardhura nga kursimet e prindërve të SR dhe revokimi i kontratës me S nga G.H		1,313,014				790,240	340,000				5,832,670			
E) SHPENZIME	2,449,021	455,302	438,228	637,630	1,640,759	2,173,942	2,664,517	3,329,493	3,095,683	2,859,649	7,438,529	2,545,585	1,968,268	3,557,927
Shpenzime jetike	2,449,021	375,456	438,228	438,228	683,100	273,240	273,240	273,240	273,240	282,048	352,560	659,994	672,828	862,004
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 1 të disburuar në datë 01.03.2004, Alpha Bank (30.000 usd)					247,512	189,743	144,729	204,548	510,163					
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 2 të disburuar në datë 20.07.2006, Alpha Bank (1,900,000 lekë)				107,367	429,310	407,400	843,898	552,909						
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 3 të disburuar në datë 14.08.2008, Alpha Bank (400,000 lekë)						64,585	99,629	99,686	255,882					
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 4 të disburuar në datë 12.02.2009, Alpha Bank (2,000,000 lekë)							376,493	386,351	393,640	364,868	377,774	750,194		
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 5 të disburuar në datë 14.07.2010, Alpha Bank (5,800,000 lekë)								380,234	731,836	719,016	6,014,036	0	0	0
Shpenzime për pagesën e kredisë nr. 6 të disburuar në datë 07.10.2013, BKT (4,960,000 lekë)											119,652	286,411	357,028	310,097
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit pranë Alpha Bank							223,352	609,061	92,749	250,738	14,234	70,773	0	800
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë ProCredit Bank				26,472										
Shpenzime për pagesën e kartës së kreditit të subjektit pranë BKT Bank					119,422	838,974	413,748	540,292	515,934		40,122	10,240	12,881	
Shpenzime për pagesën e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat nga paga B.H										311,047	321,053	235,555	295,094	450,154
Shpenzime për rinovimin e apartamentit 89,82 m ² dhe 133 m ² SR						400,000								1,500,000
Shpenzime mjeksore										279,440				
Shpenzime për kopshtin e djalit														48,000
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit		79,846	0	65,563	161,415	0	289,429	283,172	322,239	652,492	199,098	532,418	630,437	386,872
Balanca e fondeve (D-C-E)	1,313,014	457,714	1,662,879	577,993	1,335,802	1,923,791	551,550	1,738,701	1,334,546	2,156,009	-911,239	794,119	1,877,290	835,343